Sharl
BODLER



Lulet e së keqes

Plejad

LULET E SË KEQES

Akti i parë i lindjes
se poezisë moderne


SHARL BODLER

Shqipëroi:
Dritan Thomollari

QEMAL STAFA
SHKOLLA

Plejad

3rj0n1xx -Mundësoi Librin-



Titulli në origjinal: Les Fleurs du Mal

Përktheu nga origjinali: Dritan Thomollari

Arti Grafik: Kleida MALUKA

Botimi i parë, 1997
Botimi i shtatë "Plejad" 2004

© PLEJAD 2004

ISBN 99927-746-1-4

POETIT TË MREKULLUESHËM

Magjistarit të përkryer të letërsisë franceze
mësuesit dhe mikut tim
më të dashur dhe më të nderuar

TEOFIL GOTIE

Me ndjenjat
e respektit më të thellë
unë i dhuroj

LULET E SË KEQES

C.B



Sharl Bodler: Jeta dhe veprat

1821: Më 9 Prill lind në Paris Sharl Pier Bodler, fëmija i një borgjezi të pasur dhe me interesa të gjëra kulturore e artistike që, i ve e në moshë të thyer (kish lindur më 1759), ishte martuar pak a shumë prej dy vitesh me Caroline Archenbaut Defays, nëna e poetit, 26 vjeç.

1827: Vdekja e të jatit. Në muajt e parë Sharli do të banojë me nënën (që pas një viti do të martohet me komandantin Jacques Aupick) në Neuilly.

1831/1836: Aupick, i dërguar me shërbim në Lion, thërret familjen, kështu që Sharli vjen të mësojë në Kolegjin lokal mbretëror. Një emërim i ri e sjell më 1936 Aupick në Paris, ku Bodleri do të frekuentojë liceun e famshëm Luis-le-Grand.

1839/1842: Sharli hyn për pak kohë në Fakultetin e drejtësisë, por është tërësisht i tërhequr pas letërsisë, sidomos pasi është njohur me artistë të tillë si Balzak e Nerval. Spikat e fortë dëshira për një jetë të ç'rregullt, dëshirë kjo që e detyron familjen ta nisë për një udhëtim të gjatë turistik në Indi. Bodleri, pasi qëndron pak kohë në ishullin Maurice, e ndërpret rrufeshëm udhëtimin dhe kthehet në Bordo. Në Francë hyn në zotërim të trashëgimnisë së të jatit e lidhet në artisten mulate Jeanne Duval. Bukuria ekzotike, sensualiteti epshëror, magjia turbulluese, janë tema të shumë lirikave të pjesës së parë të librit.

1845/1846 : Debuton si kritik arti me dy vepra (Sallone të 1845 dhe Sallone të 1846); ndërkaq vazhdon të bëjë një jetë të shthurrur e me mjaft shpenzime, duke eksperimentuar së bashku me miqtë e tij artistë, rebelë si vetë ai, efektet e hashishit dhe pasioneve më të shfrenuara të ndjenjave. Fillojnë të shfaqen vargjet e para në shtypin e përditshëm, së bashku me studime e artikuj te temave të ndryshme.

1847: Boton me mbiemrin e nënës novelën "Fanfarlo" që përbën një lloj autoportreti ironik dhe përkthen poemën e famshme "Korbi" të

shkrimtarit amerikan E.A.Poe, me të cilin ndjen një afëri të theksuar e për të cilin do të shkruajë ese mjaft të bukura e analitike.Suksesi i saj i madh do t'i jepte një shtysë akoma më të fortë pasionit të tij për poezinë. Ndërkaq, forcon një lidhje dashurie me artisten me "sy të gjelbër" Marie Daubrun, shpesh e pranishme si burim frymëzimi në pjesën qëndrore të "Luleve të së keqes".

1848: Bodleri është në mes të barrikadave, i ndezur nga idealet revolucionare, që do t'i braktisë më vonë përfundimisht pas grushtit të shtetit të L.Napoleonit më 2 Dhjetor 1851.

1855: Shfaqet për herë të parë në një letër drejtuar sekretarit të revistës "Revue des Deux Mondes" titulli Lulet e së keqes, si titulli i librit që do të përmblidhte gjithë poezitë e tij të publikuara përgjatë viteve nëpër revista e gazeta të ndryshme.

1857: Pas vdekjes së Aupick, e ëma e poetit kthehet në Honfleur, ku Bodleri do të shkojë shpeshherë për tu shplodhur e qetësuar. Botimit të parë të paralajmëruar të "Luleve të së keqes" gjykata i përgjigjet me një gjobë prej 300 frangash, për krimin e përdhosjes së moralit të shoqërisë, duke i hequr gjithashtu botimit gjashtë poezi. Në këtë kohë perëndon edhe ylli i artistes M.Sabatier të frekuentuar prej 5 vjetësh e fortësisht të idealizuar nga Bodleri, deri në atë pikë sa shumë biografë besojnë se kjo mund të ketë qënë shkaku i thyerjes së raportit të tyre.Dëshmi të shkrimtarëve bashkëkohorë qëvizitonin të njëjtin sallon me poetin, e përshkruajnë atë si një grua me një inteligjencë të jashtëzakonshme e një bukuri të rrallë.

1859/1860: Pas Salloneve të vitit 1859, shfaqen nëpër revista një sërë studimesh e esesh me titullin "Parajsat artificiale".Bodleri interesohet në këtë kohë edhe për veprën e Wagnerit.

1861: Del në shtyp botimi i dytë i "Luleve të së keqes", së bashku me botimin e nëntë poemave në prozë në "La Revue fantaisiste", përveç 14 të tjerave në "La presse".

1863: Edhe pse i ndjekur nga shëndeti i keq, i përfshirë në falimentimin e botuesit të tij, i ndrydhur prej borxheve, gjithnjë e më i kërcënuar nga sifilizi i marrë që në rini prej abuzimit me alkolin dhe opiumin, Bodleri vazhdon të shkruajë.

Botohen edhe nëntë *"petits poemes"*.

1864/1865: Gjashtë poema të vogla në prozë shfaqen në "Le Figaro"nën titullin "Le spleen de Paris", ndjekur nga dy në "La Vie parisienne", tre në "L'Artiste" dhe gjashtë të tjera në "Revue de Paris". Në Belgjikë, ku shkon për tu kuruar, një revistë i publikon poemën në prozë "Qentë e mirë".

1866: Botohen 23 poezi të reja nën titullin "Epaves" (Mbeturinat). Më vonë ato do të përfshihen në botimin e tretë të "Luleve të së keqes", pas vdekjes së poetit. Në fund të marsit Bodleri goditet nga një paralizë që i heq mundësinë për të folur.

1867: Pas transportit nga Belgjika, në një shtëpi mjekimi në Paris, Bodleri nuk jep shpresa për përmirësim dhe vdes më 31 Gusht.

E ëma do të vdesë 4 vjet pas tij në Honfleur.

PARNASSIANËT

Drejt viteve 1860, në Francë filloi të shfaqej një reagim i fortë ndaj lirizmit të kënaqësisë dhe shpërthimeve romantike që në disa autorë kishin arritur edhe kulme. Një reagim i tillë u konkretizua me shkollën poetike të parnassianëve (Teodor de Banvij, Fransua Kope, Zhoze Maria de Heredia);

Është ky një grupim poetësh që në brëndësi të programit të tyre kanë një afëri të madhe me atë konstante të përherëshme të kulturës dhe artit francez, d.m.th të asaj që është përcaktuar si *l'esprit de clarte,* nevojës për qartësinë dhe racionalitetin. Kështu, këta poetë e identifikojnë "qëllimin e artit të tyre në përfaqësimin në mënyrën më objektive dhe të përsosur - nëpërmjet vargjesh të përpunuar deri në imtësi - të ngjarjeve historike apo fenomeneve të natyrës".

Rikthehet kështu, ashtu si dhe në epoka të tjera në kulturën evropiane, dëshira për klasiken, si një leksion i përjetshëm i rregullit, i ekuilibrit të brëndshëm, i shkëlqimit estetik të një forme poetike të pastër. Poeti parnassian nuk lë kurrë diçka të papërcaktuar e të vënë në dukje rëmbimthi, por me një ndërmarje që ka në thellësi diçka religjioze dhe heroike - besnik i konceptit horacian të limae labor - shkon në mënyrë të ndërgjegjshme në kërkim të gjetjes së shprehjes më të saktë e më me vënd që do ti jepte "imazhit spikatjen e një mozaiku". Poezia dhe një herë e gjen vetveten, ngjitet edhe një herë në atë Parnass prej të cilit romantiku Lamartin krenohej se e kish rrëzuar.

Në të vërtetë, flamuri i antikonformizmit i ngritur lart prej këtij brezi poetësh, ka dhe ai një origjinë romantike. Kish qënë romantizmi ai që në fillim të shekullit e kish pasuruar tipologjinë letrare me një mit të ri human: rebelin, që në letërsi të vendeve të ndryshme u quajt Ortis, Werther, Obermann. Në atë kohë rebelimi romantik përfaqësonte momentin e marshimit të borgjezisë që luftonte kundër Restauracionit, e që artisti me poezinë e tij e lidhte edhe me beteja politike konkrete (si në rastin e Viktor Hygosë).

Por tashmë gjithçka kish ndryshuar.Kjo klasë e ndjente veten të gërryer nga ideja e hidhur e Komunës së Parisit (janë vitet e Republikës së tretë të ashtëquajtur "Republikës pa republikanë") dhe gjendej kështu e zhytur në një pasivitet mbrojtës. Aspak solidar me këtë qëndrim, artisti nuk gjen më as bazën e vet sociale, por njëkohësisht nuk gjen dot as edhe lidhje të reja ku të mbështetet.

Më 1866 do të dalë përmbledhja e parë *Parnasse Contemporain,* që do të bashkonte në një vëllim të vetëm poetët parnassianë të botuar më parë në ciklet e revistave dhe gazetave. Mes bashkëpunëtorëve të një përmbledhjeje të tillë figuronte edhe Sharl Bodler, por që në fakt në atë kohë përfaqësonte themeluesin e shkollës së poezisë moderne evropiane. Ish ai i pari, i ndjekur më pas në mënyrën e vet origjinale nga Artur Rembo, që shënjoi njëherë e përgjthmonë rrugën nëpër të cilën duhet të ecte arti për ti shpëtuar amullisë së civilizimit të kohës.

"ENNUI" DHE "IDEAL"

Vetëm në një pikë mund të bashkohet Bodleri me Parnassianët: Në kultin për përsosmërinë e formës, në përbuzjen kategorike ndaj vargut të thjeshtë e të përafërt. Në gjithçka tjetër hendeku është i pamasë.I përballur me një jetë të stuhishme e të çrregullt, shpeshherë të simuluar vetë, duke dashur të realizojë një egzistencë të dedikuar ndaj kultit të Artit dhe të së Bukurës, Bodleri refuzon objektivizmin e mermertë e disi të akullt të parnassianëve e synon në krijimin e një poezie që zë fill nga njeriu, nga dramat e rrënimit të tij dhe nga përpjekja e dëshpëruar për tu ngritur, nga sublimja dhe banalja që e shoqërojnë gjatë gjithë udhës së jetës, nga ai shilarës ku ai s'pushon kurrë së u tunduri mes Ennui_së dhe Idealit, mes vullnetit të çlirimit, të shpëtimit dhe dëshirës së ndaluar të shkatërimit përmes kënaqësive ekstreme, nga përçmimi i vetvetes, nga mërzia, simbiozë e egzistencës së çdo brezi të njerëzimit nga njëra anë dhe aspiratave më të larta të idealit nga ana tjetër, duke lënë që të gjitha këto në poezinë e tij të jenë njëkohësisht kronika dhe eposi, të jenë analiza e pamëshirmshme dhe kremtimi i dhimbshëm e ngashërues. *Spleen* është një fjalë angleze që në atë kohë përcaktonte një gjëndje të caktuar shpirtrore - Bodleri e përdor shpesh me termin ennui - që ka të bëjë me një "dëshpërim pa rrugëdalje,

të pasjellë nga ndonjë shkak konkret... Ajo është frika paralizuese, paniku për mashtrimin e pashmangshëm që sfidon jetën tonë, rënies së dhimbshme e totale në kurthin e kësaj gjëndjeje".

Për këtë temë, që do të jetë njëra nga motivet bazë të letërsisë së mëvonshme, Bodleri ka shkruar disa lirika, mes të cilave spikat për forcën e saj të ethshme dramatike të një përshkrimi mizor e lakuriqësisht realist, lirika e mëposhtme:

Kur qielli i plumbtë, i ulur e i rënduar si një mbulesë
Mbi shpirtin vajtonjës, pre të ngashërimeve të gjata,
Gjithë vijën e horizontit puth e përqafon me dënesë,
Duke shpërndarë ditë të zeza më të trishta se nata;

Kur toka ka kyçur gojën brënda një të lagshte qeli,
Kur shpresa si t'ish lakuriq nate, dhimbshëm qan,
Krahët e ndruajtur pas murit i përplas gjithë fuqi
E kokën thyen tërë zhurmë mbi të kalburin tavan;

Kur shiu me rrëketë e tij nëpër hapësira të shtrira,
Sikur imiton kangjella hekuri të një burgu të paanë;
Një popull i tërë memec merimangash të pështira,
Vjen të thurrë cergat e tij në thellësi të truve tanë,

- Funeralë të mëdhenj, pa tamburë e pa muzikë,
Mbi trurin tim fillojnë të marshojnë me ngadalsi,
Shpresa fitimtare kullon në lot e Ankthi despotik,
Mizor, mbi kafkën time ngul flamurin e tij të zi.

Por përballë spleen, ennui, dhimbjes, ngrihet në tërë madhështinë e vet si një alternativë e momentit, Ideali, i vetmi që arrin t'i çlirojë krahët e shpresës nga burgu i paanë i jetës. Kjo është aspirata e zjarrtë e poetit , ky është urimi që ai i bën vetvetes. E për tu hedhur në ndërmarjen e këtij çlirimi shpirtëror Bodleri ka nevojë të lëkundet si një pendul në lavjerrësin e humbjeve e të fitoreve të jetës, duke përdorur herë herë si instrumente të këtij qëllimi dashurinë dhe ëndrrën, dehjen dhe udhëtimin drejt së panjohurës.

Mbi dete, mbi re, maleve e pyjeve,
Përmbi këneta, përmbi lugina vrik,
Përtej diellit, përtej, gjer në zenit,
E përtej sinorëve të të gjithë yjeve,

Sulu, ti shpirti im, sulu me aq shkathtësi,
Si notari i mirë që me dallgët zbavitet e heq,
E me një epsh të parrëfyer e të keq,
Hareshëm përshko të thellën pafundësi.

Ik, arratisu, nga këto errëra të ndyra, të njelmta,
Shko e pastrohu, diku larg, në një ajër superior,
E pi, si një verë të mbrujtur me bekimin hyjnor,
Zjarrin e qartë që mbush hapësirat e kthjellta.

Në gjithë këtë luftë vigane kundër Ennui, pas Artit dashuria zë për të një vend të veçantë e të preferuar.Në jetë, ai arriti të njihte pa mundur dot t'i shkrijë në nji, të dyja format plotësuese të dashurisë njerëzore: pasionin sensual për Jeanne Duval, një balerinë mulate, me vrullet e dashurisë shpirtërore për Madame Sabatier. Më shumë se sa një dëshirim ai shikon tek dashuria për Duval një formë të arratisjes, të shpëtimit, që kalon përmes erotizmit apo kënaqësisë estetike.

Sa më pëlqen nën ritmin përtacor,
Trupi yt që rrezëllit,
E dashur, si një stof i butë vallëzor,
Lëkura të çliron dritë.

Mbi kurorën e flokëve të dendur,
Prehet i athti parfum,
Det aromfortë e i kudogjendur,
Valëzim i kaltër e brun.

Po kur të shoh tek hapin shpejton,
Truplëshuara hirshumë,
Më ngjan një gjarpër që vallëzon,
Gjer lart sa një bastun.

Por shpejt poeti arrin të provojë pakënaqësi ndaj një eksperience të dhimbshme dashurie, që ai e analizon përsëri në mënyrën e vet origjinale, në atë dualitet të dashurisë me urrejtjen që lidh raportin me një grua të dashur, ndërgjegjësimin e skllavërisë dhe të pamundësisë për t'u çliruar prej saj. Prej këtu lind një tjetër motiv i poezisë Bodleriane - ai i gruas vampir, i asaj grüaje rrënim dhe mallkim satanik- që do të ketë jehonë në artin e mëvonshëm

T'më ndihte jetën pa shpresë,
Iu përgjërova shpatës-vetëtimë;
E iu luta helmit të pabesë,
Të ma kthente përsëri lirinë.

Po shpata dhe helmi ashtu qetë,
Oh, medet!Plot përbuzje më thanë:
"Ndarja s'mund t'i jap dinjitet,
Skllavërisë së mallkuar ku të mban!

Budalla!- Sikur me gjithë mënd,
Të të ndanim prej saj njëherë e mirë,
Ti prapë kufomën e vampirit tënd,
Do ta ngjallje duke e puthur e lëpirë!"

I ndarë në dysh nga dëshira për t'u lartuar dhe nga nevoja e shijimit të likereve më të fortë të mëkatit, duke i afruar këto aspirata pak nga pak apo duke i shtyrë drejt ekstremeve, Bodleri gjendet kështu pre e një dualiteti të tmershëm afektiv.

Ky konflikt i kaluar gjatë gjithë metamorfozës së ndjenjave dhe ideve është mjaft i pranishëm edhe në vargjet e atyre poezive lirike të një pasurie kulmore poetike e të një ndjeshmërie të mrekullueshme, që ai i ka kushtuar Zonjës Sabatier, i vlerësuar nga Bodleri si realizimi perfekt i Idealit të tij.

Mbi të tuat këpucë-satin,
Mbi të tuat këmbë-mëndafsh,
Unë shtroj fatin tim dhe gjeninë
Bashkë me gazin, tërë afsh;

E k'të shpirt që ma shëron,
Ti, plot dritë dhe ngjyrime!
O i nxehti eksplozion
I së zezës Siberisë sime!

Ose përsëri, me tone të larta idealizuese në një tjetër lirikë.

O metamorfozë e një krijimi mistik,
Ku të gjitha ndjenjat kam shkrirë unë!
Se është frymimi yt që bëhet muzikë,
Ashtu si zëri yt që bëhet parfum!"

E megjithatë ideali për autorin ka format e veta të zhvillimit. Trupi i bukur i një femre mund të të zgjojë një botë më vete ndjenjash sensuale e imazhesh solarë, mund ta shtegtojë nëpër "klima magjike e të rrezikshme", por ai mund edhe të dekompozohet e të kundërmojë një erë që të mbyt, e përsëri s'mund t'ia thyejë dot poetit ndjenjën e tij të hollë e sublime për konceptin e së bukurës, siç arrin ajo majat e një përsosmërie të rrallë në të famshmen "Një qelbësirë".

- E megjithatë ti do ti ngjash diçkaje të ndyrë,
Një të tmershmi infeksion,
Ti o ylli i syve të mi, o diell i simes Natyrë,
Ti, ëngjëlli im, ti pasion!

Po!E tillë do mbetesh, e të gjitha hireve mbretëreshë,
Ritin e fundit duke mbaruar,
Kur nën një copë toke mbytur në bar e lule do t'jesh,
Edhe eshtrat për të kalbëzuar.

Aherë thuaju krimbave, o e bukura ime!Pa u ndruajtur,
Atyre që me puthje do të të bëjnë thërrime,
Se të gjitha format e aromën hyjnore ta kam ruajtur,
Përgjatë dekompozimit të dashurisë sime.

E në fundin e këtij eksplorimi të dyfishtë shpirtëror, duke shtegtuar me imagjinatën e tij të ethshme pranë brigjeve të ishullit të Siterës, tokës ku Afërdita, hyjnesha e dashurisë kryente ritet e saj dashurore, ai arrin në konstatimin e hidhur që për të qëndron në themel të çdo dashurie.

Qielli ish një magji e plotë, deti një sirenë e paanë;
Po për mua gjithçka ish gjak i kulluar ndaj një sfondi të zi,
Që ma bënte shpirtin të tërin të varrosur në këtë alegori,
E medet! Mbështjellë nën një të trashë e të ashpër savan.

Në ishullin tënd Afërditë!E bukura gjer në përgjërim,
Gjeta veç një trekëmbësh simbolik ku varej imazhi im ...
-Ah! Zot! Të lutem, dhuromë forcë dhe guxim,
Për ta parë trupin dhe shpirtin tim, pa përçmim!

PËRTEJ KUFIJVE TË SHQISAVE

Pikënisja e të gjitha qëndrimeve të poetit, udha ku lëvizin të gjitha idetë e tij është ajo vetëdija e të "mërguarit në këtë tokë", e "ëngjëllit të rrëzuar" e kështu të huaj në botën ku jeton. Në fakt, ky kontrast midis artistit dhe shoqërisë e ka origjinën të paktën që nga Romantiçizmi. Kështu, Alfred de Vigny në dramën e tij CHATTERTON përshkruan luftën mes Chattertonit, përfaqësues tipik i poetit dhe lordit Beckford, mishërim i urryer i ambientit materialist, i mbyllur brënda gjithçkaje që është llogari dhe fitim. Edhe parnassiani Lecont de Lisle, poetin e kish portretizuar në veprimet dhe zakonet e kondorit, këtij zogu vetmitar, duke theksuar izolimin krenar që atij i përshtatet aq mirë. Ndërsa Bodleri, në të famshmen "Albatrosi" e krahason artistin me këtë shpend gjigand të detrave. E reja e tij qëndron pikërisht në atë dimension të dhimbshëm që ai i jep motivit. Ndjesia e të ndryshmes dhe të huajit ndaj realitetit këtu kthehet në një mërgim plot vuajtje midis njërzve, në ndërgjegjësimin e rënies dhe dramës së moskuptimit.

Kështu është dhe poeti, si ky princ resh,
Që me harkëtarët qesh e mes stuhive vërvitet,
Po i mërguar në tokë, me thumbimin i rënë ndesh,
Ashtu penguar nga krahët e gjatë, mezi çapitet.

Plagët nga të cilat ai u mundua të mërgojë (fëmijëria e trazuar dhe imazhi i nënës, besimi katolik me të cilin u edukua, realizimi i një ideali të qëndrueshëm dhe dëshira për të jetuar intensivisht) janë të mëdha e të pashlyera, kështu që atij s'i ngelen veç ëndrrat për *parajsat artificiale* (citim i vetë Bodlerit) që t'i shpaguajnë ato për të cilat ai ndihet i arratisur nga jeta. E kështu shfaqen parajsat artifi-ciale të drogës e të çdo lloji tjetër eksitimi që e lejon të kridhet në ndjesi të reja të ngjyrave, muzikës e parfumeve, apo duke ndjekur rrugën tjetër, atë të udhëtimit të vet intelektual gjithnjë "Përpara, Përpara!", duke u zhytur ...

Në fund të humnerës, Parajsë a Ferr qoftë, ka rëndësi?
Në thellësi të së Panjohurës, për të gjetur të *renë*!

Veçanërisht ndaj magjisë së muzikës Bodleri ishte mjaft i ndjeshëm. Ai ia besonte muzikës fuqinë e paraqitjes së asaj pjese jo të shprehshme të ndjenjës që fjala, sado pozitive, mund të arrijë.

Këto sugjestione e këto akorde, ky shkatërim i gardhit të kufijve të pesë shqisave, ku një tingull mund të evokojë një ngyrë apo një parfum mund të evokojë një pejsazh, kanë gjetur - dhe ky koncept në kohën e sotme është mëse i pranuar - një kornizë estetike e poetike madhështore në sonetin gjenial "Korrespondencat", që vërtet mund të konsiderohet si akti i parë i lindjes së një ndjeshmërie të re, akti i fitimit në favor të poezisë të atij sundimi mbi zona më parë të paeksplorueshme të shpirtit.

Ka parfume të freskët, si mish i butë fëmije,
Si tingull i ëmbël oboe, si luadhe që gjelbërimet i mbulojnë,
-Ka dhe të tjerë, ngadhnjimtarë, të korruptuar, plot pasuri,

Që gjërat e pafundme dëshirojnë të zaptojnë,
Si rrëshira erëkëndshme, si ai qelibar, ai myshk e temjan,
Që këndojnë dalldisjen e ndjenjave dhe të shpirtërave tanë.

QEMAL STAFA SHKOLLA

Modernitet i egër

"Libër i egër" është për "Lulet e së keqes" një përkufizim i dhënë nga vetë Bodleri, në një letër shkruar prej tij një vit përpara se të goditej nga paraliza që më pas do ta shpinte në vdekje. Ç'ngjyrim fin me të "zezë" (kështu është etimologjia e fjalës "i egër") i solli fati, duke i hequr mundësinë e të folurit pikërisht atij që me fjalë, me zërin e poezisë, kish mbruajtur më të gjallën, më pasionalen dhe më të dëshpëruarën prej të gjitha historive të veta të dashurisë. "Në këtë libër të egër, kam vënë gjithë mendimin tim, gjithë zemrën time, gjithë besimin tim, gjithë urrejtjen time..."

Mendimi i paraprin zemrës, vërtet, dhe kjo mund të nënkuptojë se poeti i ka dhënë formë me anë të vargjeve, një mendimi abstrakt e

sistematik, brënda të cilit, të lidhura në mënyrë logjike, mund të ravijëzohet një filozofi e veçantë për natyrën, për historinë, një etikë, një metafizikë, e kështu me rradhë.Pararendës, në disa aspekte, i Egzistencializmit (po për ç'fenomen të kulturës moderne ai mund të quhet i huaj?) Bodleri, megjithatë, ishte mëse i bindur se filozofi të tilla nuk kanë të bëjnë fare me gjëndjen e qënieve njerëzore, me egzistencën reale të secilit person, me provokacionet me të cilat

arsyeja është e detyruar në çdo çast t'i nënshtrohet jetës.

Por pikërisht, mosdëshira për të heshtur e për të maskuar kontraditat e jetës, mohimi i ngushëllimeve sentimentale, përçmimi për çdo lloj patetizmi, të gjitha këto, përbëjnë atë "mendim" për të cilin flet Bodleri ose më mirë, kthjelltësinë, ndërgjegjien e përgjegjësinë morale. Le ta dijë lexuesi që ai i dredhon, që i flet nën një vello, me anë të një kamuflimi, si në një shfaqje pelivanësh, si një njeri që ka përçmimin narçizist dhe urrejtjen e mërzitur, në vënd të mëshirës kristiane apo nevojës egzistenciale për të komunikuar, mënyrën me anë të së cilës ai rregullon raportin e poetit me "masën" e qënieve njerëzore me të cilët ai është i detyruar të ndajë Kohën e Dobishme.

Antiteza njeri-masë, në "lëmshin e raporteve të tyre të panumurt" (citim i vetë Bodlerit) "nuk ka të bëjë as me një çështje klase, as edhe

me një kolektiv njerëzish të strukturuar më së miri...Kjo turmë, së cilës Bodleri s'ia harronte egzistencën, kurrë nuk arriti t'i shërbente si model. Ajo hynte në krijimet e tij si një figurë sekrete... ajo është turma e padukshme e fjalëve, e vagjeve, me të cilën poeti përleshet fushave të braktisura, në luftën e tij për kapjen nga brirët të "gjahut" poetik.

Së fundi, *"Lulet e së keqes"* është një "libër i egër" edhe për vetë përkthyesin, për të cilin shfaqet gjithnjë reale pamundësia e riprodhimit të kompleksitetit të një impianti poetik krejtësisht të veçantë. Zgjedhja është bërë mbi kriterin e kombinimit të afërisë më të madhe të mundshme me tekstin e origjinalit dhe gjetjen e një tingëllimi besnik ndaj rimave dhe asonancave, që në poezinë e Bodlerit kapin majat më të larta.

Dritan Thomollari

Lexuesit *

Budallallëku dhe kurnacëria, mëkati dhe gabimi,
Shpirtrat tanë na zaptojnë e trupat tanë na sfilisin,
Me to sëmbimeve tona t'ëmbla u gatuhet ushqimi,
Si barbonët zhelet e tyre morrave ua lënë ti cimbisin.

Po sa kryeneçe mëkatet, sëmbimet sa shpejt mbarojnë!
Ne fajin shtrenjtë e paguajmë, në dhimbje duke e ngjyer,
E në udhën tonë, përmes llumit, kthehemi të gëzojmë,
Me besimin se dënesa burracake çdo njollë turpi ka shlyer.

Tri herë m'i fortë Satanai** në jastëkun e së keqes rehatuar,
Shpirtin tonë të magjepsur prej një kohe të gjatë nanuris,
Të atij vullnetit tonë, tërë atë metal të çmuar,
Në avull e kemi shndërruar, prej dhuntisë së alkimisë.

Është Djalli vetë, ai që si kukulla na hedh e na përdredh!
Mes gjithë kësaj krupe e neverie ne shohim veç të mirën;
E secili prej nesh, ditë për ditë, një hap drejt Ferrit hedh,
Aspak i tmerruar, duke shkarë mes reve që qelbin errësirën.

Si epsharaku i shkretë që s'rri dot pa puthur e copëtuar
Gjoksin e martirizuar të një të putane të regjur e plakë,
Ne tinëz rrëmbejmë në fluturim një kënaqësi të ndaluar,
E si portokalle e shtrydhim gjersa duart të na bëhen gjak.

Si një milion helminite të ngjeshura fort, gëlon e gumëzhin,
Një popull i tërë Djajsh që në trutë tanë hedh valle e pi verë,
E në çdo çast që frymojmë, Vdekja na e përshkon mushkërinë,
Si një lumë i padukshëm, me gulçime të mbushura me vrer.

Edhe pse helmi, zjarri, thika, dinjiteti i poshtëruar,
Atë tabllonë banale të të dhembshurit fatit tonë,

Me ato ngjyrat e tyre të ndezura, ende se kanë sajuar,
Ky shpirti ynë, o Zot! Akoma s'gjen forcë e s'guxon.

Po në kafazin e dreqosur të të gjithë veseve të tij,
Mes çakejve, hutëve, majmunëve dhe bushtërave,
Akrepave, riqebujve, hienave dhe gjarpërinjve te zi.
Mostrave angullitëse, zvarritëse, tigrave e panterave,

Mostra më e ndyrë, më e keqe, më e pështirë!
Edhe pse kurrë s'bën xheste të mëdha e fort nuk kuis,
Po për qejf, k'të glob mund ta kthejë në tokë të nxirë,
E shpejt e shpejt, me një gogësimë të vetme ta gëlltis;

Është Mërzia***!-Plot lot të pavullnetshëm e sjell ligështinë,
Podiume ekzekutimi ëndërron tek thith hukën**** e saj,
Po ti, o lexues, kësaj mostre delikate ia njeh mirë fuqinë,
- Lexues hipokrit, - o vëllai im, - unë ty aq shumë të ngjaj!

SPLEEN DHE IDEALI

Bekim *

Kur, me një dekret të fuqive supreme,
Poeti u shfaq në këtë botë të mërzitur,
E ëma e lemerisur, tërë mllefe blasfeme,
Grushtat i drejtoi zotit, mëshirë duke bërtitur:

"Ah, një droçkë nepërkash si s'linda më mirë,
Se sa t'i japë sisë kësaj qënie në përçmim!
Mallkuar kënaqësia jetpakë e natës së pështirë,
Që më bëri të ngjizja vuajtjen e dënimit tim!

Po gjersa ti mes gjithë grave më ke zgjedhur
Të jem tërë neveria e një burri mjerisht të trishtë,
E jo si një copë bilete dashurie në zjarr hedhur,
Më është dashur ta flak këtë mostër të brishtë,

Unë do di ta vërvis urrejtjen që po ma shterr fuqinë
Mbi instrumentet e mallkuara të planit tënd vulgar,
E do ta përdredh mirë këtë të përbuzurën bimë,
Që kurrë më, mos t'i çel të molepsurit lastarë!"

Kështu, me fytin ngucur prej të urrejtjes shkumë,
E, duke mos kuptuar asgjë rreth fateve hyjnore,
Ajo thellë xhenemit të saj, përditë e më shumë,
Përgatit turrën e druve, blatuar për krimet amënore.

Por një ëngjëll i padukshëm që gjithnjë pranë i rri,
Vogëlushin-herezi me diell e deh pak nga pak,
E në çdo kafshatë që kafshon, në çdo pije që pi,
Ai shijon e thith ambrozën dhe nektarin ngjyrë gjak.
Me erën buzëqesh e lodron, me retë qesh e flet,
E duke kënduar udhën e kryqit, dehet i lumturuar;
Po shpirti që pas e ndjek në pelegrinazhin e vet,

Qan tek e sheh, si një zog të lirë pylli, të gëzuar.

Ata që ai do të dashurojë, e kundrojnë me frikë,
Ose, me guximin ndezur, kur e shohin i qetë të ec,
Grinden, kush ta shkreh i pari në një vajtim të lig,
E me egërsinë e tyre, kush ta shënjojë si dordolec.

Në bukën dhe verën që i takon gojës së vet,
Ata hedhin pështyma të ndyra përzierë me hi;
Vervisin përtej, si hipokritë, gjithçka që ai prek,
E shajnë kur i ndjejnë pranë tyre hapat e tij.

E dashura shkon e i llomotit shesheve publikë:
"Nëse i dukem e bukur, aq sa të më adhuroj,
Do të di t'ua vjedh zanatin atyre idhujve antikë,
E më shumë ar për të më stolisur do t'i kërkoj;

Do të dehem e tëra me nard, me temjan e me mirrë,
Me lodra, dëfrime e me verë, me lutje e përgjërime,
Që ta di, se një zemër që më do me aq dëshirë,
Unë mund ta pushtoj e të tallem me hyjnoret nderime!

Kur Mërzia të bjerë gjithandej në farsa plot prapësi,
Dorën time të brishtë e të fortë, mbi të do ta ul,
Thonjtë njesoj si thonjtë e mprehtë që ka një harpí,
Duke i hapur një shteg drejt zemrës, fort do t'ia ngul.

Si një zog i porsalindur që lëkundet i dridhëruar,
Do t'ia shqyej prej gjoksit zemrën e përgjakur,
E për të ushqyer bishën time më të adhuruar,
Tërë përbuzje, përtokë kam për ta flakur!"

Po në qiell, ku syri sheh një fron të magjishëm,
Poeti qetë-qetë larton krahët e vet të bekuar,
Shkëndijat-vetëtima të shpirtit të shndritshëm,
Ia davarisin shikimin e njërëzve të tërbuar:

"Qofsh i bekuar, o Zot, që retë e vojtjes shpërhap,
Si ai hyjnori balsam për atë tonën fëlliqësi,
E si aroma më e mirë, më e ëmbël vjen përqark,
Për tu dhënë të fortëve dëshirën për mirësi!

Në një nga rreshtat fatlume të të shenjtit legjion,
Unë e di se ti Poetit i ke ruajtur një vënd të hijshëm,
E që përherë në atë festën e përjetëshme e fton,
Të Froneve, Vyrtyteve e Sundimit të gjithfuqishëm.

Unë e di se dhimbja është e vetmja fisnike,
Që as toka dhe as ferri kurrë s'mund ta bluajnë,
Ndaj unë dua për të thurrur kurorën time mistike,
Që të gjitha kohrat e universet haraç të paguajnë.

As margaritarët e humbur të Palmirës** antike,
Të panjohurit metalë të çmuar, perlat që deti mbart,
S'do mjaftonin, veç nëse me to duart e tua besnike,
Do vinin një diademë të bukur, verbonjëse e të qartë;

Që do të jetë mbrujtur me një dritë qelibar,
Ngjyruar në zjarrin e shenjtë të një dielli foshnjëror,
Për të cilin janë pasqyra të errëta, në lot larë,
Në gjithë shkëlqimin e tyre, ata sytë njërëzorë!"

Albatrosi

Shpesh, marinarët për tu zbavitur kapin,
Albatrosët, k'ta zogj viganë që mes kthetrave,
Moskokëçarës u ngjiten anijeve që shkasin,
Përmes thellësive të hidhura të detrave.
Ky sovran i kaltërsisë, pas kuvertës ngjitur,
Si i zënë ngushtë nga pamundësia e tij,
Mjerisht, krahët e bardhë, i lë të zvarritur,

Si një çift rremash të vozitura me ngadalsi.
K'tij udhëtari të plogët, ngordhalaq, qesharak!
Të shëmtuar, po dikur aq të bukur në k'të bot'!
Një marinar sqepin me çibuk ia përflak,
Tjetri shpotinë i jep sakatit që s'fluturon dot.

Kështu është dhe poeti, si ky princ resh,
Që me harkëtarët qesh e mes stuhive vërvitet,
Po i mërguar në tokë, me thumbimin i rënë ndesh,
Ashtu penguar nga krahët e gjatë, mezi çapitet.

Lartësim

Mbi dete, mbi re, maleve e pyjeve,
Përmbi këneta, përmbi lugina vrik,
Përtej diellit, përtej, gjer në zenit,
E përtej sinorëve të të gjithë yjeve,

Ti, shpirti im, lëviz me aq shkathtësi,
Notar i mirë që me dallgët zbavitet e heq,
E me një epsh të parrëfyer e të keq,
Hareshëm përshko të thellën pafundësi.

Ik, arratisu, nga këto errëra të ndyra, të mjelmta,
Shko e pastrohu, diku larg, në një ajër superior,
E pi, si një pije të mbrujtur me bekimin hyjnor,
Zjarrin e qartë që mbush hapësirat e kthjellta.

Lëshoje pas mërzinë e rënkimet e dhimbshme,
Që aq shumë rëndojnë mbi egzistencat e pajeta,
Fatlum është ai që fushave vezulluse e të qeta
Di të fluturojë, duke valëvitur flatrat e fuqishme;

Është ai që në qiellin e mëngjesit, mes vrulleve,
Ngrihet me mendimet si lauresha në të fluturuar,
-Mbi jetën duke shkarë e lehtësisht duke kuptuar,
Të gjitha gjërat memece dhe gjuhën e luleve*!

V.

Sa shumë epokave lakuriqe ua dashuroj kujtimin,
Aherë kur Febi* zbavitej statujave t'u jepte prarimin.
Kur meshkujt dhe femrat, të shkathët e në shpengim,
I jepeshin kënaqësisë pa asnjë ankth e mashtrim,
E, me përkëdheljet e qiellit dashamirës mbi shpinë,
Provonin mrekullinë e fisnikës së tyre makinë.
Aherë kur Cibelës**, ushqyeses pjellore dhe bujare,
Bara e rëndë e shumë fëmijëve s'i rendej fare,
Po ulkonjë, me zemrën me ëmbëlsi mbushur shumë,
Gjithë botës i jepte ushqim me gjinjtë e saj brunë.
Aherë kur njeriu, elegant, i fortë e gjithë madhështi,
Kish të drejtën të mburrej se ish mbret për çdo bukuri;
E fruta të pastër nga çdo njollë e krejtësisht të pacënuar,
Të ndillnin në çdo kafshatë me tulin e butë e të lëmuar.

Kur sot Poeti, dergjet e lëngon që të imagjinojë
Ato madhështi hyjnore, e në mëndje t'i shikojë,
Ato vënde, ato burra e ato gra në lakuriqësi,
Një i ftohtë i zymtë ndjen t'i veshë shpirtin e tij,
Ja, përpara kësaj tablloje që llahtarisht të sëmbon,
O monstruozitet, që atë veshje përgjëron!
O kraharorë që me maskat ngjani!O gjokse qesharakë!
O trupa të shtrembër, të flashkët, barkalecë a mishpakë!
Që zoti i të Dobishmes, qetësisht mizorinë duke ndjellë,
Që fëmijë, në pelena prej bronxi ju ka mbështjellë!
E ju o femra, medet!Si dylle qirijsh të zbardhëlluara,
Prej vetë Shthurjes, të gërryera e të ushqyera;
E ju, virgjëresha, që merrni prej trashëgimnisë,
Vesin amënor dhe gjithë shëmtimet e shtatzanisë!

Vërtet, ne e dimë se kemi kombe të korruptuara,
E për popujt antikë, bukuri të panjohura:
Fytyra të brejtura prej të zemrave kancer,
Që fare mirë mund të quhen "bukuri në vrer";
Po kurrë jo, sajesat e muzave tona të vonuara,
S'mundet t'i ndalojnë këto racat e sëmurura,
T'i dhurojnë asaj rinie homazhin më të rrallë,
-Asaj së shenjtës, së thjeshtës, me të bukurin ballë,
Me syrin e qartë e të kulluar, si një e rjedhshme rrëke,
Që e shkujdesur derdh mbi gjithçka në këtë dhe,
Si zogjtë dhe si lulet dhe si ajo e qiellit kaltërsi,
Parfumet e saj, këngët dhe të ëmblën ngrohtësi.

Korrespondenca*

Natyra është një tempull ku kolona të gjalla,
Lënë ngandonjëherë fjalë pa kuptim t'u shpëtojnë;
Njeriu ndjen sy familjarë që ngultas e vështrojnë,
Kur kalon nëpër këto pyje simbolesh të rralla.

Njësoj si jehonat e përzgjatura që përngjizen,
Në një bashkësi të thellë e të errët, diku në largësi,
Si nata dhe drita e ditës, të pamasa gjer në pafundësi,
Parfumet, ngjyrat dhe tingujt përgjigjen.

Ka parfume të freskët, si mish i butë fëmije,
Si tingull i ëmbël oboe, si luadhe që gjelbërimet i mbulojnë,
-Ka dhe të tjerë, ngadhnjimtarë, të korruptuar, plot pasuri,

Që gjërat e pafundme dëshirojnë të zaptojnë,
Si rrëshira erëkëndshme, si ai qelibar, ai myshk e temjan,
Që këndojnë dalldisjen e ndjenjave dhe të shpirtërave tanë.

Fanarët

Rubens, lumë harrimi, kopsht tërë plogështi,
Jastëk mishi ku askush dashurin s'mund ta sjell,
Po ku jeta mbrrin dhe vërtit flatrat gjithë furi,
Si deti brënda detit dhe si ajri nëpër qiell;

Da Vinçi, pasqyrë e thellë dhe e vagëlluar,
Ku ëngjëj nurplot që qeshin ëmbël gjen,
E me misterin krahmbarsur shfaqen të hijëzuar,
Nga akullnajat e pishat që horizontin ngërthejnë;

Rembrandt, spital i trishtuar zërash të brishtë,
Vetëm me një kryq të madh në majë i stolisur,
Ku rrezet e mekura të dimrit turren egërsisht;
E mes pisllëkut, lutje e ngashërime të janë stisur;

Mikelanxhelo, vend i mjegulluar ku ngatërrohen
Krishtë me Herkulë, e trupat e drejtë lart ngjisin,
Fantazma hijerënda që perëndimeve zgjohen,
Gishtat duke ruajtur ndërsa qefinët e tyre grisin;

Paturpësi faunash, luftra boksierësh ndezur flakë,
Ti dite të bashkosh, fshatar i bukur plot dritë,
Zemër e gufuar krenarie, njeri i sëmurë e hollak,
Puzhe, i të detyruarëve sovrani melankolik;

Watto, festë karnavalesh ku çdo zemër e shquar,
Është si një flutur e bukur që lozonjare flakërin,
Dekor i freskët, i lehtë, nga llampadarët qartësuar,
Që mbi vorbullën e ballos hedhin marrëzinë;

Goya, i gjërave të panjohura makth i paparë,
I fetusëve që bëjnë zjarr mes të shtrigave tubim,
I plakusheve që s'rreshtin pasqyrave duke u parë,
E vogëlusheve që djajt tundojnë me lakuriqësinë;

Delakrua, liqen i kuq gjaku ku ëngjëj mavi banojnë,
Që nga një pyll gjithnjë i gjelbër bredhash hije gjen:
Ku, nën një qiell plumb, fanfara të çuditshme kalojnë
E si ajo pështërimë e mbytur e Weberit fishkëllejnë;

Tërë këto mallkime, këto blasfemi, këto vajtime,
Këto lot dhimbjesh, ofshama, ekstaza, ky *Te Deum,*
Janë jehona që mijra labirinte kanë për burime,
Janë për zemrat mortore më hyjnori opium!

Janë sokëllima të përsëritura prej mijra rojeve,
Urdhra prej mijra kasnecëve kudo shpërndarë,
Janë fanarë të ndezur prej mijra kështjellave,
Klithma ndihme në pyll prej të humburve gjahtarë!

Se vërtet, është prova më e mirë, im Zot,
Që ky dinjiteti ynë mund të të dhurojë me çiltërsi,
Kjo psherëtimë e zjarrtë rrokullisur epok' për epok',
Që vjen të shuhet në pragun e tëndes përjetësi!

Muza e sëmurë

Medet, muza ime e shkretë!Ky mëngjes po të mundon?
Në sytë e tu si shpella imazhet e natës janë ngjeshur,
Ndërsa në mishin tënd shoh se si rradhë-rradhë pasqyron,
Marrosjen dhe tmerrin, ashtu të akullt e të heshtur.

Mos vallë shejtani ngjyrëpurpur dhe skllavi fytyrëpajetë,
Për ty, urnat i kanë ngjyer me frikë dhe dashuri?
Ankthi, si një grusht despotik, i rëndë dhe i drejtpërdrejtë,
Mos të ka degdisur thellësive të një gjoli të zi?
Sa do doja që trupi yt i shëndetshëm e në kundërmim,
Veç mendime të mëdha të mirëpriste pa frikë,
Ndërsa gjaku kristian të kullonte plot shkulme ritmik,

Si tingulli i rimave të moçme, gjithë harmoni e kumbim,
Në at' kohë kur mbretëronin të këngës baballarë,
Një nga një, Febi dhe i madhi Pan*, fisnikët shpëtimtarë.

Muza e shitur

O muzë e zemrës sime, pas pallateve e dashuruar,
A do të kesh, kur Janari bunacat e veta t'i dëbojë,
Gjatë mërzisë së plumbtë mbrëmjeve borëmbuluar,
Një urë zjarri që këmbët ngjyrëvjollcë t'i ngrojë?

A do të shkrifen netve shpatullat e tua në mermer,
Duke mbledhur vrimave të errësirës rrezet e akullta?
E me kuletën bosh, si një pallat me mure në erë,
Vallë do grumbullosh ar prej tavaneve qiell-hapura?

Duhet patjetër që bukën e gojës per ditë ta fitosh,
Ndaj edhe pse indiferent me të, *Te Deum* do këndosh,
E si shërbëtor temjanicën do shpërndash në kishë,

Ose, si paljaçoja i urritur, talentin tënd ke për ta ndarë,
E vajtimin duke fashitur, të buzëqeshësh do arrish,
Që të mund të ndihet i dëfryer tërë ai publik vulgar.

Murgu i keq

Në manastirët e lashtë faqe tabllove të mëdha hijerënda,
Që anash mureve shpjegonin të shënjtën Vërtetësi,
Me at' pak ngrohtësi që devotshmëria ndizte përbrënda,
Arritej të zbutej ftohtësia e atyre kostumeve sterrë të zi.
Në atë kohë pra, kur fara e Krishtit kudo kish lulëzuar,
Duke marrë për studio një fushë varreze të qetë,
Me famën tashmë të humbur të një murgu të shquar ,
Thjesht, natyrshëm, filloi t'i thurrte lavde, Vdekjes vetë.

- Shpirti im është njësoj me një varr, o frat i panderë,
Që prej përjetësisë unë e përshkoj e më është bërë banim;
Manastir i urryer, asgjë mureve të tua s'i sjell zbukurim!

Murg kohëvrasës!Vallë do kesh mundësi ndonjëherë,
T'ma kthesh spektakël të gjallë mizerien e trishtimit të zi,
Veprën e duarve të mia dhe dashurinë e syve të mi?

Armiku

Rinia ime s'qe veç një stuhi në errësirë stisur,
Prej diejsh rrezëllues, aty-këtu e çarë;
Shiu dhe bubullimat aq keq e kanë katandisur,
Sa në kopshtin tim ka veç fruta të krimbur a të tharë.

Në vjeshtën e ideve, ja se ku jam zhytur:
Lopatës dhe grabujës nevoja i është nënshtruar
Për ta rivënë në rregull këtë tokë të përmbytur,
Që uji me vrima të thella si varre e ka shpuar.

E pyes veten: Lulet e reja, ç'ëndrra do të gjejnë tani,
Mos vallë ushqimin mistik që të mbush gjithë fuqi,
Në këtë troll si një zallishte prej lumit të gërryer?

- O ç'dhimbje! O ç'dhimbje!Koha me jetën ushqehet,
E Armiku fytyrëngrysur që zemrën na e ka shqyer,
Me gjakun tonë që kullon, i fortë rritet e dëfrehet!

Prapësia*

Sizif, na duhet vullneti yt për hajmali,
Për të lehtësuar një peshë kaq të rëndë,
Që pasioni ynë punës t'i ngul dhëmbë!
Se e gjatë rrug' e Artit, Koha me sa tepri**.

Tambur i përzishëm e dhembura zemër,
Larg varreve të njerëzve të shquar,
Shkon ngadalë drejt një varreze të veçuar,
Duke luajtur marshet e saj funebër,

- Aq shumë xhevahirë vihen në gjumë,
Varrosen në errësirë dhe në harrim,
Nga beli dhe lopata, pa marrë ndihmë.

E si sekreti i një zemre, i ëmbli parfum,
Në mes të asaj vetmie të gjatë,
Tërë mallëngjim prej luleve ngrihet lart.

Jeta e përparme

Kam jetuar për një kohë të gjatë nën stelat e pamata,
Më këmbët e tyre të drejta, gjigande prej së larti,
Që nata i bënte të ngjanin me shpella prej bazalti,
E diejt detarë i ngjyrosnin me mijra shkëndija të zjarrta.

Dallgëzimet refleksin e qiejve rrokullisnin e pështjellonin,
Duke u trazuar nëpër forma solemne me tone mistikë,
Melodiozë, si akordet e një të madhërishmeje muzikë,
Më ngjanin dritat e perëndimeve që sytë e mi pasqyronin.

Në mes kaltërsisë, rrezatimeve, valëzimit të butë,
Mes skllevërve lakuriq, me një mori errërash në trup;
Ja pra, si rrojta, në qetësinë aq shumë të dëshiruar,

E nën pëllëmbët e tyre të mëdha që ballin e trishtë
ma freskonin, me të vetmen kujdesje për të kuptuar,
Sekretin e dhimbshëm që po më treste aq ligsht.

Ciganët në udhë

Dje, fisi i profetëve me bebëza të flakëritura,
U nis për udhë, prej vocrrakëve shpina rënduar,
Thesari gjithnjë i gatshëm i gjinjëve të lëshuar,
I shqitur më në fund prej gojëve të urritura.

Burrat ecin në këmbë me armë nëpër duar,
Brënda qerreve familjet struken të kruspulluara,
Me mallëngjimin e hidhur për ëndrrat e harruara,
Bredhin gjatë nëpër qiell shikimin e shqetësuar.

Bulkthi, nga fundi i strofkës së vet prej rëre i ka shquar
E këngës i ka dhënë më shumë fuqi, shkujdesje,
Ndërkaq Cibela e dashur, i ka rrethuar me përkujdesje,

E para tërë këtyre udhëtarëve për të ndërtuar
Mbretërinë familjare të të ardhmeve qiellnxirë,
Gurin ka pikuar, shkretëtirën në lulëzim ka përpirë.

Njeriu dhe deti

Njeri i lirë, ti detin ke për ta dashuruar përherë!
Se ai është për ty një pasqyrë; Aty zemrën ti sheh,
Në rrokullisjen e pafund të dallgëve tek rreh;
Dhe shpirtin, jo më pak të hidhur se ajo e detit humnerë.
Me duar e me sy e puth e me përqafime e mbush,
Se të pëlqen aq shumë të notosh në imazhin tënd;
E zemrën shkujdes kur ai gjëmon në ndonjë vënd,
Në një vajtim të egër, të pazbutur nga askush.

Po ju jeni të dy njësoj, të çiltër e misterioz:
Njeri, askush s'zbriti në humnerën tënde sublime;
Det, askush s'ti njohu ndonjëherë xhevahiret intime;
Ju o dashnorë të zjarrtë sekretesh, o gardianë xhelozë!

Megjithatë, prej shekujsh të panumurt, që në lindje,
Pa asnjë mëshirë e sëmbim, bashkë dyluftoni,
E vdekjen, rrënimin, kërdinë aq tmerësisht dashuroni,
Luftëtarë të përjetshëm, vëllezër mizorë gjer në dhimbje!

Don Zhuani në ferr*

Kur Don Zhuani zbriti në të ferrit lumë,
Kacidhen e hakut i pagoi Karontit varkëtar,
Me krahët e hakmarrjes rremat m'shoi shumë,
Një lypës i mjerë, po si Antisteni sykrenar.

Duke treguar gjinjtë e varur e veshjet e hapura,
Femrat trupat përdridhnin nën firmamentin e zi,
E, si një turmë e madhe viktimash të dhurruara,
Një psallje të gjatë si vajtim, lëshonin prapa tij.

Sganarelo pengjet i kërkonte të paguante më parë,
E qeshte, ndërsa Don Luigji me gisht të dridhëruar,
U tregonte të vdekurve, ndan brigjeve shtegtarë,
Birin guximtar shpotitur prej flokëve të zbardhëlluar.

Rrënqethej në zi, hyjnorja dhe thatimja Elvirë,
Pranë burrit të vet të pabesë, dashnori i saj dikur,
Duke iu lutur për një buzëqeshje të fundit, të dlirë,
Ku ëmbëlsia e betimit të parë të shndriste plot nur.

Një gjigand prej guri, në armaturën e vet mbetur,
Shtrëngonte timonin, dallgën e zezë për të çarë,
Po heroi rrinte qetë, mbi shpatën e gjat' mbështetur,
Asgjë tjetër veç rrymën prapa varkës duke parë.

Ndëshkimi i krenarisë*

Në atë kohë të mrekullushme, gjithë teologji,
Kur ajo lulëzonte me aq shumë limfë e energji,
Tregojnë se njëri prej më të mëdhenjve doktor,
-Pasi kish shpëtuar prej humnerave aq të gjorë;
U kish dhënë aq zemrave moskokëçarëse fuqi;
Pasi shtigje të çuditshme, të panjohura nga vetë ai,
Kish kapërcyer, lavdinë qiellore për të mbrritur,
Atë që vetëm Shpirtrat e papërlyer e kanë arritur,
- Si një njeri i ngjitur shumë lart, i zënë në panik,
Ulëriti i krenuar nga një frymëzim satanik:
"Krisht, o i vogli Krisht, sa shumë të kam lartuar!
Po nëse në pikën më të dobët do të kisha sulmuar,
Lavdinë tënde me turpin do ta barazoja për merak,
E ti s'do të ishe asgjë tjetër, veç një fetus qesharak!"

Fuqia e arsyes përnjëherë iu largua.
Shkëlqimi i diellit nga një vello iu mjegullua,
Një Kaos i tërë u rrokullis n'inteligjencën e tij,
Tempull i gjallë, plot rregull e plot madhështi,
Nën tavanin e të cilit ai mbretronte gjith salltanet.
Heshtja dhe nata në të gjetën strehimin e qetë,
Si në një kantinë të ftohtë që çelsin ia kanë humbur.
E prej atëherë jeta iu bë si ajo e një qeni të përhumbur,
Që nuk sheh asgjë, asgjë, fushave duke kaluar,
As dallimin mes verës e dimrit duke mos kuptuar,
I pistë, i shëmtuar, i kotë, si send për t'u hedhur,
Që i bën fëmijët të qeshin, duke u përdredhur.

Bukuria

Jam e bukur qënie të vdekshme, si ëndërr e mermertë!
N'gjoksin tim, e kush s'është plagosur duke u ndeshur?
Siç është vetë materia, e përjetshme dhe e heshtur,
Ai është bërë të frymëzojë dashuri tek çdo poet.

Froni im është në qiell, si sfinks i paepur, i paanë;
Një zemërborë me një bardhësi mjellme bashkoj;
I urrej lëvizjet e linjat s'më pëlqen t'i turbulloj,
Jam si ajo që kurrë s'qesh e kurrë s'qan!

Poetët, ballë xhesteve e zakoneve të mia krenare,
Që duken të kopjojnë monumentët më madhështorë,
Ditët shkatërojnë në studime të thella a mëkatare;

Se për të magjepsur tërë këta të ëmblit dashnorë
Që të shkruajnë më bukur, unë kam pasqyra-kthjelltësi:
Kam ata të mëdhenjtit, përjetësisht të qartit sytë e mi!

Idealja*

Jo, s'munden këto karikatura të dashurisë, për fare,
K'to produkte të mangët të një shekulli shkataraq,
Këmbë të hajthme për çizme, gishta për çapare,
Ti japin k'saj zemrës sime kënaqësi dhe paqë.

Po ia lë Gavarnit, poetit të mikeshave fytyrëpajetë,
Grigjën e tij llafazane të bukurosheve për spitale,
Jo, s'mund ta gjej mes këtyre trëndafilave të zbehtë,
Një lule që të ngjaj me të kuqen time ideale.
Se në thellësinë e humnerës së zemrës sime, e zgjedhur,
Je ti, ledi Makbeth, shpirt i ethshëm prej krimit ndezur,
Ëndërr e Eskilit, nga klimat tona çelur pakëz në këtë jetë;

Ose ti, e madhja Natë**, që bijë e Mikelanxhelos më ngjan,
Ti që përdredh me një pozë të çuditshme, qetë-qetë,
Joshje e llokma të sajuara ushqimi për të kënaqur çdo Titan!

Gjigandja*

Asaj kohe kur Natyra në dellin e saj të tërbuar,
Ngjizte për ditë mostra fëmijësh të pështirë,
Pranë një vajze të re, gjigande, do të kisha jetuar,
Si në gjunjë të një mbretëreshe, një mace me dëshirë.

Do doja trup e shpirt t'ia shihja të vërvitura lart,
Përmes lojrave të saj të frikshme, lirshmërisht;
E të shquaja nëse zemrën t'ia ngrohte një zjarr dritpak,
Që mjegulla të lagështa në sy t'i lundronin qetësisht;

Do doja t'ia përshkoja me epsh kurbat e magjishme;
Të kacaviresha në gjunjët e saj të pakufishme,
E ngandonjëherë, kur ca diej verorë, hirpak,

Në mes të fushës do ta bënin të dergjej pa frymë,
Si kasollëz e qetë në këmbë të një mali të lartë,
I shkujdesur nën hijen e gjinjve të saj do bija në gjumë.

Maska*

STATUJË ALEGORIKE
SIPAS STILIT TË RILINDJES

për Ernest Christophe
skulptor

Le të kundrojmë hijeshinë e një thesari fiorentin;
Nëpër linjat e valëzuara të atij trupi muskuloz,
Si motra hyjnore, Forca dhe Eleganca bashkë rrinë.
Kjo grua, kjo mrekulli e një krijimi harmonjoz,
Hyjnore, e zhdërvjellët për t'u adhuruar vërtet,
Është ngjizur për të mbretëruar mbi shtratet përrallore,
E për të dalldisur me magji një papë apo një mbret.

-Po më tej; Ajo buzëqeshje epshndjellëse dhe ëngjëllore
Që Vetëkënaqësi në ekstazat e veta, kudo çliron;
Ato shikime të zgjatura, të ligshta, tallëse e tinzare;
Ajo fytyrë lozonjare që të gjithën një vello e mbulon,
Në çdo copë të saj na thotë me një pamje krenare:
"Dëshira më thërret e Dashuria më kurorëzon!"
Shikoni, kësaj qënieje të mbrujtur plot madhështi,
Se ç'nur të një magjije eksituese dashamirësia i dhurron!
Le të afrohemi, pra, që ta shijojmë sa më mirë k'të bukuri.

O mallkim i artit! O surpriza më fatale në k'të botë!
Gruaja me trupin-hyjni, ajo lumturi premtuese,
Përnjëherësh u shndërrua në një mostër me dy kokë!
-Por jo!S'është veç një maskë, një sajesë mashtruese,
Ajo fytyrë e zbukuruar nga një e hijshme ngjyrë,
Se ja, vështrojeni me kujdes, tmerësisht të ndukur,
Kokën e vërtetë dhe të sinqertën fytyrë,
Nën petkun e fytyrës që gënjen, të strukur.
E madhja bukuri e mjerë! N'zemrën time plot zymti,
Më vërshon lumi i mrekullueshëm i tëndit vajtim;
Mashtrimi yt më deh, e shpirti im nis të pi,
Në sytë e tu që Dhimbja i ka kthyer në burim!

-Po përse qan vallë?Asaj, së përkryerës bukuri,
Që racën njerëzore para saj mund ta shoh të dërmuar,
Ç'e keqe misterioze ia gërryen trupin prej atleti të ri?

-Oh, ajo qan si e marrë, vetëm pse ka jetuar!
E se jeton!Po ajo që e bën më shumë të vajtojë,
E që nga koka tek këmbët e fut të tërën në ethe,
Është se dhe nesër, oh Zot, do t'i duhet të jetojë!
Nesër, pasnesër e përgjithmonë!- Njësoj si ne!

Himn bukurisë

Bie prej qiellit a ngrihesh prej humnerës së thellë,
O Bukuri? Shikimi yt hyjnor dhe i djallëzuar,
Krimin me mirësinë ngatërruar, përherë na e ndjell,
Duke i ngjarë aq shumë shijes së verës së bekuar.

Sytë e tu strehojnë çdo perëndim dhe aurorë;
E si një natë e stuhishme parfume shpërndajnë;
Puthjet e tua janë melhem, goja jote një amforë,
Që i bën trima vogëlushët e heronjtë të qajnë.

Gurgullon honeve të zi a yjeve të zjarrtë digjesh?
Fati i magjepsur të ngjitet pas fundeve si një qen;
Ti gjithçka në botë sundon e askujt s'i përgjigjesh,
E kudo, rastësisht, gjëmën dhe harenë shpërthen.

Bukuri, ti marshon mes kufomave që ke përçmuar;
Nga xhevahirët e tu, Tmerri nuk ka më pak magji,
E Krimi, mes gjithë stringëllave të tua më i çmuar,
Mbi barkun tënd, krenarisht vallëzon plot dashuri.

Flutura e natës e verbuar pas teje, të vjen afër, qiri,
Fërfëllin, ndizet e thotë: I bekuar qofsh pishtar!
I dashuruari ethshëm përkulet mbi të dashurën e tij,
Si ai i plagosuri për vdekje përkëdhel të tijin varr.

S'ka rëndësi nëse Parajsën apo Ferrin ke për nënë,
O Bukuri!Mostër e frikshme, e paanë, e lindur e lirë!
Vallë buzëqeshja jote, syri yt, këmba, hapur ma lënë
portën, për atë pafundësi kurrë të njohur aq mirë?

S'ka rëndësi je Djall apo Zot! Ëngjëll a Sirenë të jesh,
S'ka rëndësi nëse zanë me sy kadife që xixëllojnë butë,
O parfum, ritëm, kthjelltësi, o e vetmja ime mbretëreshë!
-Bën universin më pak të shpifur, më pak të rëndë çdo minut'.

Parfum ekzotik

Kur frymoj aromën e gjinjve të tu të ngjeshur në zjarrmi
Symbyllur, në ngrohtësinë e një nate vjeshte i mpleksur,
Shoh para meje plazhe të lumtur, çmendurisht të feksur,
Të dergjura nën një diell që ndriçon gjithë monotoni.

Shoh një ishull të flashkët, ku natyra mrekullohet,
Në pejsazhe pemësh të rralla e frutash plot shije;
Ku syri i femrës, për të qënë i sinqertë në dalldisje bie
E ku trupi i djaloshit, i fortë e i shkathët lartësohet,

I prirë prej aromës tënde drejt k'tyre pejsazheve magjikë,
Ja tek po shoh një port, grumbuj velash, direkë,
Plot njërëz të dërmuar nga lufta e gjatë në det,

Ndërkaq, parfumi i tamarindave plot jeshillik,
Që në ajër pluskon, flegëzat e hundës m'i ka çarë,
E në shpirt më përzihet me këngët që këndon çdo marinar.

Flokët

O floknajë që mbi qafë përdridhesh pak nga pak!
O kurorë kaçurelash!O parfum plot kryelartësi!
Ekstaza! Që sonte të popullohet ky i errti shtrat,
Prej kujtimeve që flenë mbuluar nga flokët e gjatë,
Unë do t'ju tund fort në erë si furtuna një shami!

E ligështuara Azi dhe ajo e përvëluara Afrikë,
Gjithë ajo botë e largët, e përhumbur, gati e vdekur,
Jeton fshehur në thellësitë e tua, o pyll aromatik!
E si ca shpirtra të tjerë që për vel kanë një muzik,
Ky imi, e dashur, do lundroj në parfumin tënd i tretur!

Për të shkuar atje, ku pema dhe njeriu prej limfës bulon,
Prej kohësh i mpakur në të klimës magji dhe zjarr;
Gërsheta të gjata, jeni ju dallga që më gllabëron!
Je ti, det ebaniti, që një ëndërr verbuese më dhurron,
Me vela, flamuj të valëvitur, direkë e remtarë:

Me një port shurdhonjës, ku mund të pijë shpirti im,
Parfumin në grahma të mëdha, në tinguj e ngjyra i larë,
Ku anijet shkasin në ar e në të mëndafshin shkëlqim,
Duke shqyer krahët e pamasë për të përqafuar lavdinë,
Nxehtësisë së përjetëshme që vibron në qiellin qelibar.

Do ta kredh kokën time me dehjen rënë në dashuri,
Në atë oqean të zi, që edhe një tjetër nxë brënda;
E shpirti im që tresosë së anijes i jep përkëdheli,
Pafundësisht do dijë të provojë, o pjellorja përtaci,
Përkundje dëfrimesh të kundërmuara siç ta ka ënda!
Krifë flokësh blu, pavijon hijesh kudo të hedhura,
Ti kupën qiellore ma bën më të shtrirë, më të paanë;
Mbi skajet e kadifejta të cullufeve të tua të shpërdredhura,
Unë do dehem me gjithë shpirt prej aromave të ndërsjellura,
Që shpërhap në ajër vaji i kokosit, ai myshk e ai katran.

Gjatë!Përgjithmonë!E kur dora ime flokët të t'i përshkoj,
Do mbjell nëpër to coprat e perlës, zafirit e rubinit,
Që qënia jote dëshirën time kurrë mos ta përballoj!
Pse vallë, nuk je ti ajo enë dhe ai oaz ku unë ëndërroj
Të rrufis në gllënjka të mëdha verën e kujtimit!

XXIV

Unë të adhuroj, siç adhuroj shëtitjen në mesnatë,
O vazo e trishtimit, o e madhërishmja fjalëpak,
E të dua akoma më shumë, kur edhe pse ironikisht,
Prej meje ikën, o e bukura ime, o e netve të mia stoli,

E legë për legë fluturon, duke dashur të arish,
Atë copë që ndan blunë e pamasë nga krahët e mi.

Unë mbledh gjithë fuqitë e mia e hidhem në sulm,
Si një droçkë krimbash rreth një kufome grumbulluar,
Gjersa kjo ftohtësi, o bishë mizore, e egër tërë ngulm,
Të bëjë tek unë, akoma më të bukur, akoma më të çmuar!

XXV*

Femër e ndyrë!Shpirt i qelbëzuar me egërsi prej mërzisë.
Për të skërmitur dhëmbët në lojën tënde të kënaqësisë,
Në rrugicën tënde, një zemër ti do doje të gëlltisje për natë,
Në atë rrugicë ku mund te strehohet edhe universi i pamatë.
Sytë e tu, si dyqane të shndritshëm, zbukuruar për merak,
Apo si shandanë të ndezur në ditë festash, në çdo prag,
Të paciptë përdorin një fuqi kushedi se ku të huazuar,
Se asnjëherë ligjin e bukurisë së tyre se kanë kuptuar.
Makinë shurdhe, qorre, aq shumë pjellore në mizori!
Instrument i dobishëm, që botës i thith gjakun në gji!
Oh ç'tmerr!Po ti, si nuk dergjesh prej turpit fytyrënxirë,
Si nuk sheh hirin e joshjes tënde gjithkund të fshirë?
Ti, që e ke njohur aq mirë tërë këtë të keqe pambarim,
Si vallë frika e saj s'të ka çuar ndonjëherë në rrugëkthim,
Edhe atëherë kur Natyra, kjo e madhërishmja sekretxheshë,
Të përdori aq keq, o femër, o e mëkateve mbretëreshë,
-Po, të përdori, kafshë frikacake,- si e si të lindte një gjeni?

O fisnikëri në llucë zhgryer! O sublimja shëmti!

Sed non satiata*

Brune si vetë nata, hyjni plot trille të serta,
Ngjizur me parfumin e myshkut dhe havanës,

Vepër e ndonjë hobi a Fausti të Savanës,
Shtrigë ije ebaniti, bijë e mesnatave të errta.

Eliksirin e buzëve ku dashuria krekoset si pallua,
Unë pëlqej nga nata, hashashi a vera më e rrallë,
Se kur drejt teje niset karvani i dëshirave tërë mall,
Sytë e tu janë çisterna që mërzinë ma shuajnë mua.

Po prej atyre syve të zi, dritare të shpirtit përherë,
Mos dirdh aq shumë zjarr, o djalli im zemërvrer,
Se Stiks nuk jam për të shtrënguar nëntë herë në gji!

Se s'mundet as Megera** epsharake që të lë pa mënd,
Medet!Ta rraskapisë kurajon e të heqë çdo mundësi,
Për ty kthyer Proserpinë*** në ferrin e shtratit tënd!

XXVII

Me atë veshjen dallgëzuese e dritëartë,
Ti sikur vallëzon, edhe kur ecën qetësisht,
Si xhonglerët e shenjtë gjarprinjtë e gjatë,
Në majë të shkopinjve tundin ritmikisht.

Si rëra e zymtë dhe e shkretëtirave kaltërsi,
Aq të pandjeshme për dhimbjen njerëzore,
Si valët e një deti shtrirë gjer në pafundësi,
Ti rrugëve derdhesh me mospërfilljen për dore.

Sytë e tu janë mbrujtur me metale të shndritshëm,
E mes k'saj natyre kaq të çuditshme e simbolike,
Ku përzihet ëngjëlli i papërlyer me sfinkset antike,

Ku gjithçka është ar, diamant, çelik, dritë puerile,
Rishkëlqen përgjthnji, si një yll i padobishëm,
Madhështia e akullt e femrës sterile.

Gjarpri që vallëzon

Sa më pëlqen nën ritmin përtacor,
Trupi yt që rrezëllit,
E dashur, si një stof i butë vallëzor,
Lëkura të çliron dritë.

Mbi kurorën e flokëve të dendur,
Prehet i athti parfum,
Det aromfortë e i kudogjendur,
Valëzim i kaltër e brun.

Si një anije që velat ka ngritur,
N'erën që agimi sjell,
Shpirti im ëndrrimtar rri gatitur,
Për më të largtin qiell.

Vërtet, nga sytë e tu, asgjë s'nxjerr,
As të ëmbël e të thartë,
Dy xhevahirë të ftohtë ku sheh përzierë,
Gjënë e hekurt me të artë.

Po kur të shoh tek hapin shpejton,
Truplëshuara hirshumë,
Më ngjan një gjarpër që vallëzon,
Gjer lart sa një bastun.

Nën peshën e rëndë të plogështisë,
Koka jote si një fëmi,
Përdridhet me ritmin e ligështisë
së një elefanti të ri.

Kurmi yt thyhet e tendoset prapë,
Si një anijezë, pa bujë,
Që shket duke zhytur e ngritur lart,
Trupin e drunjtë në ujë.

Si një rrëke e gufuar sa një det,
Prej akullnajave hijerëndë,
Kur pështyma jote ngjitet leht'
gjer në dhëmbë,

Më duket se një verë Boheme po pi,
Të hidhur, ngadhnjimtare,
Qiellin kristalin, që më sterpik në gji,
Fara yjesh dhe zjarre!

Një qelbësirë*

A e mban mënd, shpirti im, ç'pamë atë ditë të bukur,
Atë ditë vere të ëmbël, të qetë,
Një qelbësirë mbi një shtrojë guralecësh ndukur,
Aty ku udha ndronte shteg,

Me këmbët lart në ajër, si një femër tërë afsh,
Gjithë zjarm, djersë vrer,
Ngrinte dhe tregonte, ashtu cinike dhe e avashtë,
Barkun q'i kundërmonte erë.

Për ta shkrumbuar kalbësirën me të vetën mënyrë,
E përcëllonte dielli rezear,
Po ajo qindfish ia kthente të pamasës Natyrë,
Atë që i kish dhënë më parë,

E qiellin niste të kundronte skeleti krenar,
Si një lule e përzhitur,
Kaq e pështirosur shpërhapej era nëpër bar,
Sa të bije përtokë i zvenitur.

Një turmë mizash kish mbi atë bark të qelbëzuar,
Legjione të zi larvash të buta

dilnin, e si një lëng i trashë rridhnin harbuar,
Mbi zhelet sipër pjesëve të tulta.

Gjithçka i përdridhej si një dallgë që ngjitet e zbret,
Në një gjallëri të flakëruar;
Duke ia bërë trupin dridhur nga një fërgëllimë e lehtë
Ti ndihej i shumëfishuar.

Kjo botë e ethshme ia kthente me të çuditshmen muzikë,
Të ujit që shket e erës që tërsëllit,
Kur shirësi në enë përmes peshtjellimit të vet ritmik,
Vërvit si rrëke shiu, grurin që shoshit.
Linjat, të humbura tashmë, ravijëzoheshin aq pak,
Aq sa piktori s'mundej të vazhdonte,
Duke hedhur telajon tej, ai vetëm në imagjinatë,
Portretin e saj mund ta mbaronte,

Pas ca shkëmbenjve fshehur, bushtra e paduruar,
Në mes hidhërimit zënë,
Përgjonte çastin kur skeletit kish për t'i gllabëruar,
Kafshatën e gojës, diku lënë;

-E megjithatë ti do ti ngjash diçkaje të ndyrë,
Një të tmershmi infeksion,
Ti o ylli i syve të mi, o diell i simes Natyrë,
Ti, ëngjëlli im, ti pasion!

Po!E tillë do mbetesh, e të gjitha hireve mbretëreshë,
Ritin e fundit duke mbaruar,
Kur nën një copë toke mbytur në bar e lule do të jesh,
Edhe eshtrat për të kalbëzuar.

Aherë thuaju krimbave, o e bukura ime!Pa u ndruajtur,
Atyre që me puthje do të të bëjnë thërrime,
Se të gjitha format e aromën hyjnore ta kam ruajtur,
Përgjatë dekompozimit të dashurisë sime.

De profundis clamavi

Thellë humnerës së tertë ku zemra ime është varrosur
Ti je e vetmja që unë dua e prej teje po lyp mëshirë.
Është nën një horizont të plumbtë bota e përpirë,
Ku netve zhurmojnë zëra blasfemë prej tmerrit marrosur.

Shpërthen për gjashtë muaj një diell pa ngrohtësi,
E për gjashtë muaj të tjerë nata tokën mbulon,
-Pa asnjë kafshë, luadh, pyll, lum që gurgullon!
Ajo ngjan më e zhveshur se një truall në Siberi;

Nuk mund të ketë në botë dhimbje më shtazarake,
Se sa mizoria e acartë e këtij dielli kallkan,
E kjo natë e pafundme që aq shumë Kaosit i ngjan;

I jam xheloz fatit të bishave më frikacake,
Që në aq ëndrra budallaqe mund të kridhen fare lehtë,
Se ndërkaq lëmshi i kohës me ngadalë shpështillet!

Vampiri

Ti që, si një thikë që shkëlqen,
K'të zemrën time vajtonjëse ke shpuar,
Ti që, si një grumbull djajsh vjen,
E fortë, e marrë, plot nur e zbukuruar,

Me të vetmen dëshirë që të cyt,
T'ma bësh shtrat zemrën e poshtëruar;
-Oh, se tek ty dhe tek çnderimi yt,
Si një hallkë zinxhiri jam shtrënguar,

Si pas lojës lojtari kokëfortë,
Si pas shishes pijaneci i bërë shosh,

Si krimbat pas një kufome të ndot,
-Ndaj e mallkuar, e mallkuar ti qofsh!

T'më ndihte jetën pa shpresë,
Iu përgjërova shpatës-vetëtimë;
E iu luta helmit të pabesë,
Të ma kthente përsëri lirinë.
Po shpata dhe helmi ashtu qetë,
Oh, medet!Plot përbuzje më thanë:
"Ndarja s'mund t'i jap dinjitet,
Skllavërisë së mallkuar ku të mban!

Budalla!- Sikur me gjithë mënd,
Të të ndanim prej saj njëherë e mirë,
Ti prapë kufomën e vampirit tënd,
Do ta ngjallje duke e puthur e lëpirë!"

XXXII*

Një natë kur me një çifute të neveritshme i shtrirë,
Si një kufomë përgjatë një kufome qëndroja,
Pranë trupit të saj të shitur nisa të ëndërroja,
Për bukurinë e trishtë që i mohohej simes dëshirë .

Solla nëpër mënd madhështinë e saj natyrore,
Shikimin e saj me forcën e hijeshinë të armatosur,
Flokët që i krijonin një përkrenare të parfumosur,
E që kujtimin e dashurisë e ngjallnin prore.

Trupin fisnik do t'ia kisha puthur tërë zjarr,
Me plot përkëdheli do ja boshatisja çdo thesar,
Që nga majat e këmbëve deri tek gërshetat e zi,

Sikur veç një natë, një të qarë të lirshme të çlironte,
E t'arrinte, ajo mbretëreshë e zonja për çdo mizori,
Atyre bebëzave të ftohta shkëlqimin t'ua errësonte!

Sëmbim i postmortum

Thellë një monumenti të ndërtuar prej mermeri të zi,
Kur ti të flesh, e bukura ime, që fshehtësi ndjell,
E shtrat me perde a dhomë në një kështjellë,
Do të kesh një zgavër të errët apo një gropë plot shi;

Kur ijet e hijshme do të t'i shkrydh një e plogët magji,
E rasa do të rëndojë mbi të brishtin kraharor,
Vrull dhe dëshirë duke i mohuar zemrës së gjorë,
E këmbëve përcëllitjen e gjithë aventurave në dashuri;

Aherë varri, besniku që ëndrrën e pambaruar ma mban,
(Se varri gjithmonë do të dijë ta kuptojë një poet),
Netve të gjata ku pagjumësia të shpon si thikë e mpreht',

Do thotë: "Ç'dobi pate, që atë për të cilën i vdekuri qan,
Ti s'arrite ta njohësh kurrë, o kurtizane pa shkëlqim?"
- E krimbi lëkurën do të ta grijë, si zemrën një sëmbim.

Macja

Hop, macja ime e bukur, mbi zemrën e dashuruar,
Vetëm thonjtë, kujdes pak,
Lermë të mbytem i tëri në sytë e tu të kulluar,
Të metaltë e ngjyrë gjak.

Kur dora ime kokën nis e ta përkëdhel shtruar,
bashkë me shpinën elastike,
E dehet nga kënaqësia me gishta duke përshkruar
At' trup plot vibrime elektrike,

Të dashurën shoh në shpirt.Shikimi i saj më ngjan,
Si i yti, kafshë e dashur dhe e qetë,
I ftohtë e i thellë, gati për të plagosur si shigjetë,

Si krimbat pas një kufome të ndot,
-Ndaj e mallkuar, e mallkuar ti qofsh!

T'më ndihte jetën pa shpresë,
Iu përgjërova shpatës-vetëtimë;
E iu luta helmit të pabesë,
Të ma kthente përsëri lirinë.
Po shpata dhe helmi ashtu qetë,
Oh, medet!Plot përbuzje më thanë:
"Ndarja s'mund t'i jap dinjitet,
Skllavërisë së mallkuar ku të mban!

Budalla!- Sikur me gjithë mënd,
Të të ndanim prej saj njëherë e mirë,
Ti prapë kufomën e vampirit tënd,
Do ta ngjallje duke e puthur e lëpirë!"

XXXII*

Një natë kur me një çifute të neveritshme i shtrirë,
Si një kufomë përgjatë një kufome qëndroja,
Pranë trupit të saj të shitur nisa të ëndërroja,
Për bukurinë e trishtë që i mohohej simes dëshirë .

Solla nëpër mënd madhështinë e saj natyrore,
Shikimin e saj me forcën e hijeshinë të armatosur,
Flokët që i krijonin një përkrenare të parfumosur,
E që kujtimin e dashurisë e ngjallnin prore.

Trupin fisnik do t'ia kisha puthur tërë zjarr,
Me plot përkëdheli do ja boshatisja çdo thesar,
Që nga majat e këmbëve deri tek gërshetat e zi,

Sikur veç një natë, një të qarë të lirshme të çlironte,
E t'arrinte, ajo mbretëreshë e zonja për çdo mizori,
Atyre bebëzave të ftohta shkëlqimin t'ua errësonte!

Sëmbim i postmortum

Thellë një monumenti të ndërtuar prej mermeri të zi,
Kur ti të flesh, e bukura ime, që fsheht ësi ndjell,
E shtrat me perde a dhomë në një kësh tjellë,
Do të kesh një zgavër të errët apo një gropë plot shi;

Kur ijet e hijshme do të t'i shkrydh një e plogët magji,
E rasa do të rëndojë mbi të brishtin kr aharor,
Vrull dhe dëshirë duke i mohuar zemrës së gjorë,
E këmbëve përcëllitjen e gjithë aventur ave në dashuri;

Aherë varri, besniku që ëndrrën e pamb aruar ma mban,
(Se varri gjithmonë do të dijë ta kupto një poet),
Netve të gjata ku pagjumësia të shpon si thikë e mpreht',

Do thotë: "Ç'dobi pate, që atë për të c ilën i vdekuri qan,
Ti s'arrite ta njohësh kurrë, o kurtizane pa shkëlqim?"
- E krimbi lëkurën do të ta grijë, si zemrën një sëmbim.

Macja

Hop, macja ime e bukur, mbi zemrën e dashuruar,
Vetëm thonjtë, kujdes pak,
Lermë të mbytem i tëri në sytë e tu të kulluar,
Të metaltë e ngjyrë gjak.

Kur dora ime kokën nis e ta përkëdhel shtruar,
bashkë me shpinën elastike,
E dehet nga kënaqësia me gishta duke përshkruar
At' trup plot vibrime elektrike,

Të dashurën shoh në shpirt.Shikimi i saj më ngjan,
Si i yti, kafshë e dashur dhe e qetë,
I ftohtë e i thellë, gati për të plagosur si shigjetë,

Si krimbat pas një kufome të ndot,
-Ndaj e mallkuar, e mallkuar ti qofsh!

T'më ndihte jetën pa shpresë,
Iu përgjërova shpatës-vetëtimë;
E iu luta helmit të pabesë,
Të ma kthente përsëri lirinë.
Po shpata dhe helmi ashtu qetë,
Oh, medet!Plot përbuzje më thanë:
"Ndarja s'mund t'i jap dinjitet,
Skllavërisë së mallkuar ku të mban!

Budalla!- Sikur me gjithë mënd,
Të të ndanim prej saj njëherë e mirë,
Ti prapë kufomën e vampirit tënd,
Do ta ngjallje duke e puthur e lëpirë!"

XXXII*

Një natë kur me një çifute të neveritshme i shtrirë,
Si një kufomë përgjatë një kufome qëndroja,
Pranë trupit të saj të shitur nisa të ëndërroja,
Për bukurinë e trishtë që i mohohej simes dëshirë .

Solla nëpër mënd madhështinë e saj natyrore,
Shikimin e saj me forcën e hijeshinë të armatosur,
Flokët që i krijonin një përkrenare të parfumosur,
E që kujtimin e dashurisë e ngjallnin prore.

Trupin fisnik do t'ia kisha puthur tërë zjarr,
Me plot përkëdheli do ja boshatisja çdo thesar,
Që nga majat e këmbëve deri tek gërshetat e zi,

Sikur veç një natë, një të qarë të lirshme të çlironte,
E t'arrinte, ajo mbretëreshë e zonja për çdo mizori,
Atyre bebëzave të ftohta shkëlqimin t'ua errësonte!

Sëmbim i postmortum

Thellë një monumenti të ndërtuar prej mermeri të zi,
Kur ti të flesh, e bukura ime, që fshehtësi ndjell,
E shtrat me perde a dhomë në një kështjellë,
Do të kesh një zgavër të errët apo një gropë plot shi;

Kur ijet e hijshme do të t'i shkrydh një e plogët magji,
E rasa do të rëndojë mbi të brishtin kraharor,
Vrull dhe dëshirë duke i mohuar zemrës së gjorë,
E këmbëve përcëllitjen e gjithë aventurave në dashuri;

Aherë varri, besniku që ëndrrën e pambaruar ma mban,
(Se varri gjithmonë do të dijë ta kuptojë një poet),
Netve të gjata ku pagjumësia të shpon si thikë e mpreht',

Do thotë: "Ç'dobi pate, që atë për të cilën i vdekuri qan,
Ti s'arrite ta njohësh kurrë, o kurtizane pa shkëlqim?"
- E krimbi lëkurën do të ta grijë, si zemrën një sëmbim.

Macja

Hop, macja ime e bukur, mbi zemrën e dashuruar,
Vetëm thonjtë, kujdes pak,
Lermë të mbytem i tëri në sytë e tu të kulluar,
Të metaltë e ngjyrë gjak.

Kur dora ime kokën nis e ta përkëdhel shtruar,
bashkë me shpinën elastike,
E dehet nga kënaqësia me gishta duke përshkruar
At' trup plot vibrime elektrike,

Të dashurën shoh në shpirt.Shikimi i saj më ngjan,
Si i yti, kafshë e dashur dhe e qetë,
I ftohtë e i thellë, gati për të plagosur si shigjetë,

E, nga koka gjer tek këmbët në revan,
Një aromë e ndjeshme, një i rrezikshëm parfum,
Nis të shpërhapet reth trupit të saj brun.

Duellum*

Dy luftëtarë kanë hyrë një nga një në mejdan;
Ajrin duke çikëluar me shkrepëtima armësh dhe me gjak.
Ato lëvizje, ato tringëllima hekuri, zhurma janë,
Të një rinie që për një dashuri të porsalindur ndizet flakë.

Oh, shpatat u thyen, e dashur!Si vetë ajo e jona rini!
Po do dinë shpejt thonjtë e mprehtë e dhëmbët e thërmuar,
Ta shpagojnë atë të kamës dhe të shpatës tradhti.
O tërbim i zemrave të rregjura prej dashurisë së ulçërzuar!

Në prroskën e xhindosur ku mace e gatopardë gjejnë strehim,
Heronjtë tanë në përleshje u rrokullisën dorë për dore,
E mishi i tyre, mbi atë tokë shterpë do të sjell lulëzim.

Le të rrokullisemi aty dhe ne, pa sëmbime, amazona çnjerëzore,
Zjarrin e kësaj urrejtjeje që po na grin për ta përjetësur!
-Se ai hon tani është vetë ferri, prej miqve tanë i populluar!

Ballkoni*

O nënë e kujtimeve, o dashnore e dashnoreve!
Ti kulm i kënaqësive të mia!Ti kulm i detyrimeve të mia!
Patjetër që i kujton magjitë e përkëdheljeve,
Ëmbëlsinë e zjarrit dhe ato mbrëmjet ku prehej magjia,
O nënë e kujtimeve, o dashnore e dashnoreve!

Ato mbrëmjet e ndriçuara prej të karbonit nxehtësi,
E ato ndër ballkone, mbuluar me vello avujsh trëndafili.
Kur m'ish i ëmbël gjoksi yt!Zemra jote tërë mirësi!
E kur fjalë të përjetshme buzët na pështërisnin gjithnji,
N'ato mbrëmjet e ndriçuara prej të karbonit nxehtësi.

Oh, mbrëmjeve të ngrohta, diejt sa të bukur janë!
Sa e pamasë hapësira!Zemra, sa e burrëruar aq shumë!
Kur mbi ty përulesha, hyjni që n'adhurim të mban,
Më dukej sikur gjakut tënd i thithja, të njomin parfum.
Oh, mbrëmjeve të ngrohta, diejt sa të bukur janë!

Nata retë dendësonte e ngjante me një barrierë,
Sytë e mi dhe bebëzat e tua nëpër erësirë kërkoheshin,
Oh, kur unë frymën ta pija, me ç'ëmbëlsi e me ç'vrer!
E këmbët e tua të përgjumura në duart e mia lëshoheshin.
Nata retë dendësonte e ngjante me një barrierë.

E njoh mirë artin si ta ngjall për një çast lumturinë!
Të shkuarën kular në gjunjët e tu, pashë në sytë e mi.
Po pse ta kërkoj gjetkë atë të ligështuarën bukurinë,
E jo veç në trupin tënd të dashur e n'atë zemër-ëmbëlsi?
E njoh mirë artin si ta ngjall për një çast lumturinë!

Ato premtime, parfume, ai lumë puthjesh i pashteruar,
Gurgullon prej fundit të një shpelle që askush se ka parë,
Po si vallë ngjiten drejt qiellit diejt përsëri të rinuar,
Pasi në humnerat e deteve më të thellë, aq gjatë janë larë?
-O premtime!O parfume! O lumë puthjesh i pashteruar!

Xhindosja

Dielli është zënë nga një tyl mjegulle që s'rresht,
Si ai, o Hënë e jetës sime!Unë me hije do të të vesh;
Ti e tëra në humnerën e Mërzisë hidhu ndesh,
E fli ose tymos, si ta kesh qejfin; Ngrysu ose hesht;

K'shtu të dua!Megjithëse si e dalë nga ajo gjysmëhije
e një ylli të eklipsuar, ti sot po më ngjan me përsosmëri,
E mbi vendet ku Marrëzia mbretëron, e krekosur rri,
Ashtu qofsh përherë! Shkit prej mhillit, kamë magjije!
Flakë për bebëzat e tua merr prej llampadarëve!
Dëshira plot zjarr ndiz nëpër sytë e vulgarëve!
Ti, që e gjitha më je kënaqësi, e butë apo frerëlëshuar,

Ji ajo që do të jesh, natë e zezë apo agim i kuq për mua;
Pse, nuk të duket gjithë fuqi ky trupi im i dridhëruar,
Që nuk ulëret: *Oh, i adhuruari im, unë të dua!*

NJË FANTAZME

1.Errësira*

Thellë shpellave të një trishtimi të padëgjuar,
Ku Fati im tashmë më ka lënë të syrgjynosur;
Me të vetmen mikeshë, Natën e vrazhdë, të marrosur,
Aty ku kurrë s'përvidhet një rreze dielli e gëzuar;

Unë i ngjaj një piktori nga kushedi ç'zot përqeshur,
I dënuar për të pikturuar, oh medet, veç mbi terr!
Që i shtyrë nga një oreks funebër, si një guzhinier,
Zemrën time gatuaj, kafshatë gojës për t'ia ngjeshur;

Atëherë papritur shkëlqen duke u përzgjatur,
Një fantazëm, mbrujtur në hir mirësie e shkëlqim,
E tek e shoh aq orientale, ëndërimtare, të përflakur,

Në çastin kur trupin e bukur tërësisht e shtrin,
Vizitoren time misterioze unë njoh: Po, është Ajo!
E zezë, por e shndritshme nga një zjarr që të ngroh.

Parfumi

Lexues, ndonjëherë a të është dhënë,
Më thuaj, plot etje, të shijosh ngadalë,
Aromën e temjanit të derdhet valë-valë,
A të myshkut në qese, që rrënjë ka zënë ?

K'shtu ti hedh, joshje e thellë, e magjishme,
Në të tashmen, të shkuarën e rindërtuar!
Si ai i dashuruari përmbi trupin e adhuruar
të kujtimit, këput një lule të hijshme.

Prej masës së flokëve, të rëndë e elastike,
E shtratit temjanicë, qese e gjallë aromatike,
Çlirohet hovshëm një aromë plot egërsi,

E prej veshjes së kadifejt e byhrunxhuk,
Njomur në çdo pore prej qelibares rinore freski,
Shpërthen kudo parfumi i një gëzofi të butë.

Korniza

Si kornizë e bukur shtuar në një pikturë,
Edhe pse krijesë e një peneli tërë kreni,
Unë s'e kuptoj se ç'gjë e çuditshme e magji,
Është ta veçosh nga e pamasa Natyrë;

Çdo xhevahir, çdo stoli, çdo metal e prarim,
Aq shumë i shkon asaj së rralle bukuri;
Asgjë s'ia turbullon të përkryerën qartësi,
E gjithçka i shërben si një përvijim.

Ndaj ndonjëherë më duket se ajo beson,
Se secili prej njërëzve të k'saj bote e dashuron;
E lakuriqësinë derdh me dëshirë n'ëndërrime,

Në puthjet e mëndafshit a të veshjeve intime,
Dhe e shkathët apo e avashtë, në çdo veprim,
Shfaq të një majmuni naiven mirësinë.

Portreti**

Kjo sëmundje dhe kjo Vdekje po e bën hi,
Tërë atë zjarr që ne na kish përzhitur.
Po prej atyre syve të ndezur, tërë butësi,
Po prej asaj goje ku zemra ime ish përmbytur,

E ngazëllimeve më të forta se rrezet e ethshme
Po prej puthjeve pasionale, balsam në k'të jetë,
Thuamë, ç'mbeti vallë? Shpirti im, sa e tmershme!
Asgjë, veç një pasteli trengjyrësh, fare të zbehtë,

Që, si unë shkrihet, brënda një vetmie të shkretë,
E Koha, kjo plakushkë që të fyen e s'të lë të flasësh,
Me krahun e saj barbar, ditë për ditë e godet...

Po kurrë i kënaqur, i Artit dhe i Jetës, vrasës i zi,
S'do t'jesh, kur edhe në kujtime të ma vrasësh,
Atë që për mua qe e vetmja kënaqësi dhe lavdi!

XXXIX

Po të dhuroj këtë tufë vargjesh, gjersa zëri im prore,
Lumturisht të zbarkojë në të largtën epokë,
E si një anije e shtyrë nga një bunacë e fortë,

Një mbrëmje të bëj që t'ëndërroj mëndja njerëzore,
Kujtimin tënd, njësoj me një përrallë të paqartë fare,
Që lexuesin si shungullimë daulleje e kapit,
E si hallka e një zinxhiri vëllazëror e mistik,
Rri shpesh e varrur mbi të gjitha rimat e mia krenare;

Qënie e mallkuar, së cilës prej honit të thellë-det,
Gjer në të lartin qiell, askush veç meje, përgjigjie s'të jep!
-Oh ti, që si një hije lë një gjurmë fare të brishtë,

Tek shkel këmbëlehtë e u hedh një shikim të fildishtë,
Budallenjve që ju duke e trishtuar, oh statujë larë në ar,
E një ëngjëlli ballëbronx, me sy të zi shkëlqimtarë!

Semper eadem

"Prej nga vjen, më thoje, ky i çuditshëm trishtim,
Që bie mbi të ziun shkëmb të zhveshur, si deti me tërbim?"
-Kur zemrat tona në k'të jetë janë vjelë njëherë,
Të jetosh është veç një fatkeqësi. E ky s'është një mister,

Është një dhimbje e thjeshtë, elementare, nën zë,
Është si gëzimi yt, për çdo njeri, manifest i qart' sa s'ka më.
Ndaj prapsu e bukura ime, kureshtare aspak mos ji!
Edhe pse zëri yt është aq i bukur, aq kumbues, ti bëj qetësi!

Sus edhe ti, injorant!Shpirt i një ekstaze që kurrë s'prehet!
Gojë e së qeshurës fëmijërore!Se më shumë se kjo Jeta jonë,
Shpesh vetë Vdekja në fijet e saj të buta na shtrëngon.

Lëre, lëre këtë zemrën time në një *gënjeshtër* të dehet,
Si në një ëndërr të bukur, thellë në sytë e tu të kridhet rehat,
E nën hijen e qerpikëve të dremisë për një kohë të gjatë!

Nji e tërë

Djalli, në dhomën time të lart,
K'të mëngjes erdhi të më vizitojë,
E, duke dashur të më fusë në çark,
Tha: "Më duhet mirë ta kuptoj?,

Mes gjithë atyre kurbave plot bukuri,
Që trupin ia kompozojnë magjishëm,
Prej nga krijohet tërë ajo e saja fuqi,
Nga pjesët zi e rozë të bashkuara lirshëm,

Cila është më e ëmbla?"- O shpirti im!
Ti përgjigjien plot neveri ia hedh:
"Gjersa për mua është e tëra një shërim,
Asgjë prej saj unë s'mund të zgjedh.

Kur m'është pasioni në k'të jetë,
S'dua t'ja di nga buron magjia e saj.
Ajo si Agimi dritfortë sytë ti vret,
E si Nata të ngushëllon në vaj;

Harmonia e atij trupi të hijshëm
Është sajuar deri në përsosmëri,
E çdo kërkim është i pafuqishëm,
Një qënie tjetër t'i gjej ngjashmëri.

O metamorfozë e një krijimi mistik,
Ku të gjitha ndjenjat kam shkrirë unë!
Se është frymimi yt që bëhet muzikë,
Ashtu si zëri yt që bëhet parfum!"

XLII*

Ç'do më thuash sonte, shpirti im i shkretë vetmitar,
Ç'do më thuash zemër, oh e vyshkura zemra ime ti,
Për më t'ëmblën, më të mirën, bukuri të paparë,
Që me shikimin e saj hyjnor të ka lulëzuar përsëri?

-Krenaria jonë i gjunjëzohet duke i thurrur lavdi:
Syve të saj velluar nga një qartësi dritshumë;
Fuqia e saj është e një të pafundme ëmbëlsi,
Mishi i saj shpirtëror ka të ëngjëjve parfum.

S'ka rëndësi në është natë apo ajo është në vetmi,
Përzierë mes turmës apo rrugëve nëse e kërkoni,
Si pishtar në ajër fantazma e saj do vallëzoj në qetësi.

"Jam e bukur, e për hir tim, veç Bukurinë dashuroni",
-Thotë, e shton: "Mbani vesh mirë se ç'po ju urdhëroj,
Se unë jam Muza, Madona, jam Ëngjëlli që ju mbroj".

Pishtar i gjallë*

Sy të mbrujtur me dritë, para meje kalojnë,
Prej një ëngjëlli të mençur padushim manjetizuar,
K'ta vëllezër hyjnorë, k'ta vëllezërit e mi shkojnë,
Shkrepëtima diamanti syve të mi duke lodruar.

Më gjejnë shpëtim prej çdo mëkati e në çdo pusi,
Hapat e mi i drejtojnë n'udhën e Bukurisë së rrallë:
Ato m'shërbejnë, por jo, unë jam në të tyren skllavëri;
Me tërë qënien bindur ndaj k'tij pishtari të gjallë.

Sy magjikë, të shndritshëm me një qartësi mistike,
Qirinj shkëlqimtarë, që në mes të ditës ndriçoni;
Ju dielli sa ju skuq, po s'ua shuan dot flakën fantastike.

Qirinjtë Vdekjen nderojnë, kurse ju Rizgjimin këndoni,
Po, po, ju ecni e këndoni të shpirtit tim Rizgjim,
Yje, që asnjë diell s'mund t'ju barazohet në shkëlqim!"

Prapsueshmëri

Ëngjëll plot hare, ti dhimbjen a e njeh,
Turpin, psherëtimat, sëmbimet, mërzinë,
Makthin vrasës të një nate të tmershme,
Ku zemra si gjethja në dimër merr arratin?
Ëngjëll plot hare, ti dhimbjen a e njeh?

Ëngjëll plot mirësi, ti urrejtjen a e njeh,
Grushtet e mbledhur, lotët e hidhur a i ndjen,
Kur Hakmarrja tamburit të saj skëterror i bie,
E të gjitha aftësive tona u bëhet kapiten?
Ëngjëll plot mirësi, ti urrejtjen a e njeh?

Ëngjëll plot shëndet, ethet e t'lënguarve a i njeh,
Që bri mureve të lartë të një spitali të zymtuar,
Si mërgimtarë bredhin e këmbët zvarrisin përdhe,
Me buzët mavi duke kërkuar diellin e adhuruar?
Ëngjëll plot shëndet, ethet e t'lënguarve a i njeh?

Ëngjëll plot nur e bukuri, rrudhat e thella a i njeh,
Frikën e mplakjes, të torturës së ndyrë at' kamzhik,
Për të lexuar në sytë që sytë tanë t'etur përpijnë me nge,
Sekretin tonë të tmershëm për të mbetur besnik?
Ëngjëll plot nur e bukuri, rrudhat e thella a i njeh?

Ëngjëll plot lumturi, plot gaz e plot dritë,
Davidi i lënguar do t'u kish kërkuar shëndet,
Aromrave të forta të magjisë tënde që të përtërit;
Ndërsa unë, vetëm lutje po të kërkoj në k'të jetë?
Ëngjëll plot lumturi, plot gaz e plot dritë?

Rrefim*

Një herë të vetme, grua gjer në përgjërim,
Krahun mbi tëndin pata hedhur,
(E ende, n'thellësinë e nxirrosur të shpirtit tim
Kujtimi s'është zverdhur);

Ishte shumë vonë; si medalje e sapodhurruar
Hëna e plotë shndriste,
Solemniteti i natës, si një lumë kish vërshuar,
Mbi Parisin që dremiste.

Ndan murreve, bri portave n'errësirë të futura,
Tinëzisht macet kalonin,
Veshët e ngrehur, megjithatë, si hije të bukura
Ngadalë na shoqëronin.

Papritur, çliruar në mes të një intimiteti të lirë,
Në të zbehtën kthjelltësi,
Prej teje, violinë kumbuese, që vibron zëdlirë,
E shkëlqen veç çiltërsi,

Prej teje, fanfarë e hareshme, e qartë, harmonjoze,
Në të mëngjesit dritë,
Shpëtoi një notë vajtonjëse, një notë tekanjoze,
Që me erën u puhit,

Si ai fëmija i imët, i trishtë, i shëmtuar, i dreqosur,
Që prindërit me qëllim,
Për turp të njërëzve e mbanin gjithnjë të syrgjynosur,
Fshehur në një kantinë.

Ëngjëll i mjerë, këndonte nota me një zë të vajtuar:
"Këtu poshtë s'ka siguri,
Egoizmi njerëzor, edhe pse kujdeset për t'u grimuar,
Tradhtohet nga krenaria e tij;

Është i vështirë zanati për të qënë një grua e bukur,
Dhe puna aq e pështirë
E një balerine të çmendur, mes kallkanit diku të strukur,
Që buzëqesh si për mëshirë;

Të ngresh diçka mbi zemra është e kotë; Dashuri, bukuri,
Gjithçka bëhet shosh,
Gjer kur Harimi për ti shpënë në Përjetësi,
I hedh në të tijin kosh!"

Shpesh e kam sjellë nëpër mend atë hënë të ndritur,
At' heshtje, at' ligështim,
Bashkë me atë rrëfim të tmershëm pështpëritur
Zemrës me besim.

Agimi shpirtëror*

Nëse Ideali i egër e torturonjës shoqërohet
për të shthurrurit, me agimin e bardhë e ngjyrë gjak,
Me ndihmën e një xhelati misterioz që merr hak,
Nga përgjumja e shëmtuar një ëngjëll zgjohet.

Për atë që vuan e ende ëndërron, ashtu i dërmuar,
Prej Qiejve shpirtërorë e paprekshmja kaltërsi,
Si magji humnere, hapet e shtyhet gjer në pafundësi.
Kështu, o Qënie dritë e qelibar, Hyjni e adhuruar,

Përmbi tymrat mbetur pezull nga orgjitë pa kuptim,
Kujtimi yt aq i qartë, i trëndafiltë, ndriçim i pamatë,
Në sytë e mi të zgurdulluar lodron papushim.

Dielli ua errëson qirinjve flakën e tyre të paktë:
Po ti je gjithnjë ngadhnjyes, o shpirt i ndjeshëm,
Me at' fantazmën tënde që i ngjan diellit të përjetshëm!

Harmoni mbrëmjeje

Po afron stina e ëmbël ku me kërcejt që dridhërojnë,
Lulet nisin t'avullojnë, si në kishë një pjatë me temjan;
Ç'vals melankonik, ç'trullosje që në trishtim të mban!
Tinguj e parfume në ajrin e mbrëmjes kudo vallëzojnë;

Lulet nisin t'avullojnë, si në kishë një pjatë me temjan;
Violina si një zemër që sfilitet, kumbon akorde të brishtë;
Qielli si një altar i madh është, aq i bukur dhe aq i trishtë.
Ç'vals melankonik, ç'trullosje që në trishtim të mban!

Violina si një zemër që sfilitet, kumbon akorde të brishtë;
Si një zemër e njomë, q'urren të pamasën, të zezën zbrazëti!
Dielli në çdo grumë të gjakut tënd kridhet gjithë fuqi;
Qielli si një altar i madh është, aq i bukur dhe aq i trishtë.

Një zemër e njomë, q'urren të pamasën, të zezën zbrazëti!
Mbledh nji nga nji, çdo relike të së shkuarës shkëlqimtare!
Kujtimi yt brënda meje rezëllit si një statujë krenare!
E dielli në çdo grumë të gjakut tënd kridhet gjithë fuqi...

Boca*

Ka parfume të fortë, për të cilët çdo send
është poroz.I përshkueshëm çdo xham.
Duke hapur një sunduk prej të largtit Orient,
Me menteshën që mezi i çelet e ofshan,

Ose në dollapin e një shtëpie-shkretëtirë,
Me athtësinë e kohës, të zezë e të pluhruar,
Do të gjesh një bocë të vjetër, të ruajtur mirë,
Prej ku shpërthen tërë vrull një shpirt i gjalluar.

Mijra mendime të fjetura, krizalidë të përmotshëm,
Ja tek fërgëllojnë ëmbëlsisht nën retë e zeza varr,
Krahët e tyre shkundin e nisin të fluturojnë hovshëm,
Të kaltër, shkëlqimylber, të petëzuar në ar.

Ja dhe kujtimi i dehur në ajrin e turbullt nis e fryn;
Sytë mbyllen butësisht; Marramendja prek
shpirtin ngadhnjimtar e me të dyja duart fort e shtyn,
Për në honin e fëlliqësisë njerëzore, të thellë-det;

E buzë një gremine shekullore përdhe e lëshon,
Aty ku, Llazari i djersitur shaminë shqyen me fuqi,
I shqetësuar që kufomën fantazëm s'po ia rizgjon,
Plakut dashurivjetëruar, edhe në varr plot magji.

Kështu, kur prej kujtimit të njërzve do jem shuar,
Në cep të një dollapi të mbrapshtë diku i lënë,
Atëherë bocë e vjetër, e pluhrosur, e vetmuar,
E krisur, e ndyrë, veshtullore, tërë myk e nxënë,

Tabuti yt do të jem, o murtajë e ëmbël, e dashur!
Njeriu që do të dëshmojë forcën dhe ashpërsinë,
Helm i ëmbël, që i përgatitur prej ëngjëjve vjen!
Ti lëng që më gryen, o jeta dhe vdekja e shpirtit tim!

Helmi*

Di vera si ta veshë një barakë të mjerë
Me një luks madhështor,
E ta ngrerë më lart se një portik madhështor
Në mes avujve të kuq e të nderë,
Si një diell që perëndon nën një qiell mjegullor.

Di opiumi ta zmadhojë e çdo limit t'ia flak,
Atij që vetvetes s'i vë kufi,
Kohën t'ia thellojë, t'i zgjojë çdo kënaqësi,
Dëshirat më të errëta t'ia përflak,
E shpirtin t'ia nxërë më shumë se sa ka mundësi.

Po asgjë nuk matet me ata sy jeshilë, hirplotë,
E helmin që prej tyre distilohet,
Liqej ku shpirti im dridhet e së prapthi pasqyrohet...
Humnera të hidhura ku në galop,
Ëndrrat e mia vijnë t'i shuajnë etjen ku ai kaptohet.

Po asgjë s'matet me pështymën tënde që përvëlon,
Atë të tmershmin mrekullim,
Që pa ndjerë sëmbisje po ma zhyt shpirtin në Harrim,
E me marramendjen që po i ngarkon,
Brigjeve të vdekjes e bën të përpëlitet pa shpëtim!

Qiell i shqetësuar

Shikimi yt si i veshur me avuj rri i mjegulluar;
Syri misterioz s'kuptohet ç'është (blu, jeshil, gri?)
Herë herë i ëmbël, mizor, tek rri duke ëndërruar,
Duke shëmbëllyer të flakshtën të qiellit zbehtësi.

A i mban mend ditët e bardha, mbuluar me një vel
Që shkrijnë në vaj zemrat nga dashuria drobitur,
Kur, të trazuara nga një e keqe e panjohur që i shpërvjel,
Nervat të sapozgjuara talleshin me shpirtin e dremitur.

Ngandonjëherë më ngjan me ato horizontet e mrekulluar,
Që diejt ndezin, në stinën më të zymtë në k'të botë...
Po dhe sa bukur shkëlqen, ti peizazh i lagësht e i flakëruar
Prej rrezeve që feksen tek-tuk nën një qiell replot!

O grua e rrezikshme, o klimë e magjishme!
Vallë do të ta adhuroj borën e mëngjeset e ngrirë,
E do të di të nxjerr në ditë dimri të pamëshirshme,
Se akulli e hekuri, kënaqësi më të mprehtë, më të mirë?

Macja

1.

Brënda trurit tim më shëtit,
Si të jetë në të sajën shtëpi,
Një mace e bukur, gjithë magji.
Kur mjaullin, mezi zërin e qit,

Me atë timbrin e butë e të lehtë;
Por edhe kur oshëtin apo tretet,
Ai zë, po i thellë e i plotë mbetet,
Duke mbrujtur të sajën magji e sekret.

Ky zë që i pastruar e i kulluar vjen,
Hyn n'errësirën time, gjer në thellësi,
E më mbush me aq shumë vargje e poezi,
E si një bukuri e vërtetë më ngazëllen.

Dhimbjet më mizore arrin t'i fashojë,
Hovin e gjithë ekstazave mban lart;
E për të thurrur frazën më të gjatë
Për anjë fjalë nuk ka nevojë.

Jo, s'mund të ketë harqe më ngacmuese
për zemrën time, a instrumentë të përsosur,
Që ta bëjnë regullisht e pa u sosur,
Të këndojë me kordën e vet vibruese,

Se sa zëri yt, mace misterioze,
Mace e ëmbël, mace e çuditshme,
Që gjithçka e ke aq të ndjeshme,
E si tek një ëngjëll, harmonjoze!

2.

Prej gëzofit të saj të butë, bjond e brun,
Del një profum i ëmbël që një natë,
Më la të tërin të kundërmoja aq gjatë,
Veç me një përkëdhelje, e jo më shumë.

Ajo është shpirti i familjes, anembanë;
Ajo gjykon, vendos e sjell gjallëri,
Në çdo gjë brënda të sajës mbretëri;
Po mos vallë është idhull apo zanë?

Kur sytë, n'atë mace që dashuri ndjell,
Si të tërhequra nga një manjet,
Unë hedh ëmbëlsisht dhe i qetë,
E shikimin brënda vetes zhys thellë,

Atëherë shoh si i trallisur, i trazuar,
T'atyre bebëzave atë zjarr të rrallë:
Fanarë tërë dritë, margaritarë të gjallë,
Që më kundrojnë të fiksuar.

Anija e bukur*

Dua të ti rrëfej, magjistare e ligështuar,
Tërë bukuritë që ta stolisin rininë!
Të tërën hirplot për të të pikturuar,
Me pjekurinë bashkuar me pafajësinë.

Kur fundin palëgjërë në ajër tund lehtë,
I ngjan anijes së saponisur në udhëtim,
Që edhe pse plot vela te ndehura, shket
në një ritëm t'ëmbël, ngadalë, në përtim.

Koka krenare me të çuditshmen hirësi të vet,
Ngrihet mbi qafën e gjërë dhe shpatullat e plota;
Para teje, që shpalosesh ngadhnjimtare dhe e qetë,
Vogëlushe e madhërishme, hapet tërë bota.

Dua të ti rrëfej, magjistare e ligështuar,
Tërë bukuritë që ta stolisin rininë!
Të tërën hirplot për të të pikturuar,
Me pjekurinë bashkuar me pafajësinë.

Gjoksi yt i drejtë veshjen ta gufon valë- valë,
Ai gjoks ngadhnjimtar që aq shumë do ta dëshiroja,
Është si ai dollapi me panele plot dritë e barkdalë,
Që ngërthejnë vetëtimat si të ishin mburoja;

Mburoja provokuese, kama majëtrëndafilta,
Dollape sekretëmbël, mbushur me gjëra të mira,
Verëra, parfume, lule me ngjyra të çilta,
Delirante për mëndjet dhe për zemrat e dlira!

Kur fundin palëgjërë në ajër tund lehtë,
I ngjan anijes së saponisur në udhëtim,
Që edhe pse plot vela te ndehura, shket
Në një ritëm të ëmbël, ngadalë, me përtim.

Këmbët fisnike në at' pështjellim që të ndjell,
Dëshirat më të errëta i eksitojnë e i bëjnë fli,
Si dy shtriga që brënda një kazani të thellë,
Thurrin reth e qark më të zezën magji.

Krahët, rivale të forta të boës më të frikshme
Që qeshin e bëjnë shpoti me një Herkul të ri,
E shtrëngojnë në mënyrë të magjishme
të dashurin, për ta futur thellë, thellë në gji.

Koka krenare me të çuditshmen hirësi të vet,
Ngrihet mbi qafën e gjërë dhe shpatullat e plota;
Para teje, që shpalosesh ngadhnjimtare dhe e qetë,
Vogëlushe e madhërishme, hapet tërë bota.

Ftesë për një udhëtim*

Motër, o vogëlushja ime ti,
Mendo, do t'kish aq ëmbëlsi,
Sikur të rronim bashkë diku mënjanë!
Për qejf të dashuronim,
E jetën tonë ta mbaronim
Në atë vend që ty aq shumë të ngjan!
Diejt e mjegulluar
Të qiejve të shqetësuar,
Për shpirtin tim janë plot magji,
Në det misteri larë,
Prej syve të tu tradhtar,
Edhe përmes lotëve gjithë zjarmi.

Atje, ku gjithçka është veç rregull e bukuri,
Atje ku mbretëron lluks, dëshirë e qetësi.

Orenditë e vezulluara,
Prej viteve të lëmuara,
Dhomën tonë do ta stolisnin si me ar;
Bashkë me lulet më të vyera
Aromëkëmbyera
Me kundërmimin që lëshon një qelibar,
Tavanët tërë pasuri,

Pasqyrat plot thellësi,
Gjithçka, edhe shkëlqimet përrallore,

Do i flisnin qetë
Shpirtit në sekret
Në të ëmblën gjuhën e saj amënore.

Atje, ku gjithçka është veç rregull e bukuri,
Atje ku mbretëron lluks, dëshirë e qetësi.

A i sheh në kanalet si fije,
Tek dremisin ato anije,
Që me karakterin e vagabondit përkojnë;
Ato për t'na shuar aq mirë
Më të voglën dëshirë,
Që përtej, gjer në fund të botës shkojnë.
-Diejt që perëndojnë
Fushat mbulojnë,
Kanalet, qytetin, në gjithë madhësinë e tij,
Në ar e në argjënd;
E bota rëndë-rëndë
Fle nën të mbrëmjes dritë plot ngrohtësi.

Atje, ku gjithçka është veç rregull e bukuri,
Atje ku mbretëron lluks, dëshirë e qetësi.

E pandreqshmja

A mund ta squpim k'të të vjetrin, të gjatin Sëmbimin tonë,
Që na përdredh e na cimbis,
Që me ne ushqehet, si krimbat me një kufomë,
E si vemjet me një lis?
A mund ta squpim këtë të padurushmin Sëmbimin tonë?

Në ç'verë të ëmbël, në ç'magji të zezë, në ç'të thellin pus,
Do ta mbysim të mplakurin armikut tonë,
Si një kurtizane e rregjur, epsharak dhe shkatërues,
E i duruar si një milingonë,
Në ç'verë të ëmbël?- në ç'magji të zezë?- në ç'të thellin pus?

Foli, shtriga ime e bukur, oh!Foli, nëse e kupton e nëse di se si,
K'tij shpirti që hidhërimi si thik e pret,
Që i ngjan një të plagosuri që plagët e shqyejnë gjithë fuqi,
Kur një kalë në galop, me patkonj e godet?
Foli, shtriga ime e bukur, oh!Foli, nëse e kupton e nëse di se si,

K'tij trupi që në agoni po jep shpirt e që ujku po e nuhat,
Që korbi po e përgjon nën zë,
Thuaji, këtij ushtari të sfilitur, se do t'i mohohet gjatë,
Një kryq dhe një varr për të;
Oh, ky trup që në agoni po jep shpirt e që ujku po e nuhat!

Po a mundet vallë ta flakërojmë një qielli të zi në mjegullim?
Errësirës perden t'ia bëjmë cop' e çikë,
Atë më veshtulloren se çdo rrëshirë, pa agim e perëndim,
Pa përshkënditje funebre e yje plot dritë?
Po a mundet vallë ta flakërojmë një qielli të zi në mjegullim?

Shpresa që shkëlqente mbi gjithë dritat e xhamave të Bujtinës,
Është fikur dhe e dergjur përdhe ka rënë!
Pa hënë e pa diell, po si mund ta gjejmë atë rrugë ku tinëz,
Prapsisht martirët i kanë shpënë!
Satanai i ka shuar të gjitha dritat e xhamave të Bujtinës!

Shtrigë e adhuruar, kaq shumë të pëlqejnë gjërat e dënuara?
Më thuaj, të pafalshmen a e kupton?
A di se ç'është Sëmbimi, me ato shigjetat e tij të helmuara,
Që zemrat tona na shënjon?
Shtrigë e adhuruar, kaq shumë të pëlqejnë gjërat e dënuara?

E pandreqshmja me dhëmbin e mallkuar na grryen e i bie ndesh,
Shpirtit, këtij monumenti meskin,
Duke ia sulmuar, siç bën një turmë termitesh, aq shpesh,
Themelin një ndërtese me tërbim.
E pandreqshmja me dhëmbin e mallkuar na grryen e na bie ndesh!

2.

-Diku, në një cep të një teatri banal, kam parë ndonjëherë,
Nga një orkestër kumbonjëse të ngritur prore,
Një zanë të bukur shumë, të ndezë mes një qielli skëterë,
Një aurorë madhështore;
Diku, në një cep të një teatri banal, kam parë ndonjëherë

Një qënie, mbrujtur veç me dritë, veshur në ar e në najlon,
Satanain e pamasë ta hedh përtokë;
Po njësoj kjo zemra ime, që kurrë ekstaza s'e përshkon,
Është një teatër që më kot,
Pret gjithmonë e gjithmonë, qënien prej drite e krahnajlon!

Bashkëbisedim

Ti je një qiell i bukur vjeshte, rozë e tërë çiltërsi!
Po si një det, trishtimin ngjit mbi mua duke u dridhur,
E lë pas duke rrëshqitur mbi buzët e mia mavi,
Kujtimin përvëlonjës të baltës së tij të hidhur.

-Dora jote përshkon më kot gjoksin tim që lëngon:
Mikja ime, s'është vetëm një vënd i shkrumbuar,
Prej thonjëve dhe dhëmbëve të grave, ajo që kërkon.
Ndaj mos kërko më: Zemrën bishat ma kanë gllabëruar.

Zemra ime është një pallat prej turmës i përdhosur;
Brënda saj njerëzit dehen, zihen, ngelen të sakatosur!
-Parfumi i ëmbël i qafës tënde seç po më ndjell...

A do pra, kamzhik i rëndë shpirtrash, ti Bukuri!
Me sytë e zjarrt' që shndrisin si në ditë festash një qiell,
Ato mbeturinat e lëna prej bishave ti kthesh në hi!

Këngë vjeshte

Shpejt do të mbytemi në një errësirë të ftohtë e të mjerë;
Lamtumirë qartësi plot jetë e verërave shumë të shkurtra!
Me kumbimin e këmbanave funebre, po pres të bjerë i prerë
Druri, mes zhurmës dhe tërsëllimës, ndan oborreve të gurta.

Tashmë brënda qënies time dimri ka ardhur e ka vjellë:
Inat, tmerr, urrejtje, rrënqethje, punë të rëndë e të vështirë,
E mes tërë kësaj skëterre polare ngrihet si të ish një diell,
Vetëm zemra ime, si një bllok masiv, i kuq dhe i ngrirë.

Rri e shoqëroj me një dridhërimë çdo trung të rrëzuar,
Ngritja e një podiumi trekëmbëshi më shurdhër nuk jehon,
Shpirti im i ngjan portës së një kështjelle të shkallmuar,
Nën rrahjet e një dashi të palodhur që kërcet e gjëmon.

Më ngjan, përkundur nga kjo monotoni primtive dhe e gjatë,
Të ndjej se një qivur, nuk e di se ku, të mbërthehet me nxitim.
Po për kë?-Dje ish verë; Ja tek jemi sot, nën k'të qiell vjeshtak!
Kjo zhurmë misterioze, sa shumë i ngjan asaj ikjes në mërgim.

2.

Unë ia adhuroj atyre syve të tu të mëdhenj, të gjelbrën dritë,
Bukuri e ëmbël, po sot një hidhërim i keq po më mundon,
E asgjë, as dashuria jote, as shtrati yt, asgjë tjetër s'më nxit,
E s'ma shpërblen dot diellin që mbi det rrezet e nxehta lëshon.

Po ti prapë dashuromë, zemër e njomë!Bëhu guximtare,
Bëhu mëma ime, edhe pse jam i hidhur, edhe pse jam i egërsuar;
E dashur apo motër për mua, qofsh gjithnji ëmbëlsia kalimtare
E një vjeshte të lavdishme a një dielli në të perënduar.

Detyrim i shkurtër!Varri pret; Ai është aq lakmitar!
Ah, lermë që mbi gjunjët e tua të vë kokën në heshtje,
E të shijoj, në mallëngjimin e verës së bardhë, larë në ar,
Rrezet e ëmbla e të praruara të këtij fundi vjeshte!

Një Madone*

SIPAS STILIT SPANJOLL

Dua të ndërtoj për ty, Madonë, o zonja ime,
Një altar të nëndheshëm thellë të miave dëshpërime,
E të hap në skutën më të errët të zemrës një kamare,
Nga sytë shpotitës e qejfet mondane, të largët fare,
Një kamare prej arit dhe kaltërsisë së llakuar,
Ku ti si mbreti mbi fron të rish, Statujë e mrekulluar.
Me vargjet e mia të lëmuara, me të pastrit metal,
Stërpikur zotësisht prej të bukurave rima kristal,
Unë do të farkëtoj një Kurorë madhështore;
E me Xhelozinë time për ty, o Madonë njerëzore,
Do të arrij të qep një Pallto me një model barbar,

Të ngurtë dhe të rëndë, me dyshimin për astar,
Që si një kolibë roje, të ti mbyll brënda tërë ato hirësi;
Një Pallto jo me Perla qëndisur, por me vetë lotët e mi!
Fustani yt, do të jetë Dëshira ime e dridhur lehtë,
Dëshira ime që si dallgë lodron, ngjitet lart e zbret,
Sa duke u lëkundur nëpër maja, sa në lugina duke pushuar,
Duke ta riveshur me puthje trupin bardhë e roz e t'ëmbëlsuar.
Me Respektin tim do të thurr një palë Këpucë plot hijeshi,

Prej satini të rrallë, të përkulura para këmbëve të tua hyjni,
Që duke i mbështjellë ato në burgun e një ngushtice elastike,
T'ua ruajë linjat dhe format, po njësoj si ato kallëpet besnike.
Nëse s'do mundem, me zellin e artit tim që askush s'ma ndal,
Me coprat e një Hëne të argjëndtë të formoj një Piedestal,
Atëherë Gjarprin që rropullitë e mia i kafshon i paftyrë,
Do ta lë përdhe, para teje, që ti këtë mostër të ndyrë,
Enjtur me pështyma e urrejtje, ta tallësh e ta bësh thërime,

O Mbretëreshë fitimtare, aq shumë pjellore në shpagime!
Pastaj do të shohësh Mendimet e mia, si Qirinj të kushtuar
Mbretëreshës së Virgjëreshave, mbi altarin e vet të zbukuruar,
Të ta yjëzojnë me reflekse tavanin ngjyruar me kaltërsi,
E të të kundrojnë gjatë gjithë ditës me sytë e tyre plot zjarrmi;
E derisa unë të adhuroj e përherë në zemër të kam,
Gjithçka do jetë Mirrë, Rëshirë e këndshme, Oliban e Temjan,
E papushim drejt teje, majë me borë e bardhësi, magjishëm,
Në formë avujsh do të ngjitet ky Shpirti im i Stuhishëm.

E së fundi, që ti të quhesh e plotë dhe e përsosur, Mari,
E që unë dashurinë time ta bashkoj në një barbari,
Prej shtatë Mëkateve kapitale dhe epshzezës dëshirë!
Xhelate me zemrën prej sëmbimeve të përpirë,
Shtatë kama të mprehta do bëj e si zhongler i denjë,
Dashurinë tënde më të thellë duke marrë shenjë,
Të shtata do të ti ngul në atë Zemër që rënkon,
N'atë Zemër që psherëtin, n'atë Zemër që gjak kullon!

Kënga e mbasdites

Edhe pse ata të ashprit qerpikë
Të japin një pamje të çuditshme,
Aspak të një ëngjëlli plot dritë,
Po t'një shtrige me sy të magjishme,

Ty, o i tmershmi pasioni im,
Ty, e brishta mëndjelehtësi,
Të dua me të njëjtin përkushtim
Të një prifti për idhullin e tij.

Një pyll dhe një shkretëtirë,
Gërshetët e fortë kanë në vete,
Koka si e krijuar për t'u përpirë,
Nga enigma dhe sekrete.

Shpërthen parfumi prej trupit tënd,
Si rreth një vazoje me temjan,
Nimfë e ngrohtë që të lë pa mënd,
Ti joshjes së natës i ngjan!.

Ah!Dhe magjia më e fortë,
Prapset para tëndes butësi,
Se të vdekurit i sjell në k'të botë,
Po i miklove me përkëdheli!

Beli yt, aq i dëshiruar,
Ai gjoks dhe ajo shpinë,
Jastëkët lë duke ëndërruar,
Në atë pozë e ligështim.

Ndonjëherë për t'ëmbëlsuar
Një misterioz zemërim,
Bëhesh serioze dhe e mrekullueshme,
Në çdo puthje dhe kafshim:
Më shqyen, bukuroshja brune,
Me atë të qeshurin mbresëlënës,
Pastaj më vë në zemrën fatlume,
Syrin e ëmbël si të hënës.

Mbi të tuat këpucë-satin,
Mbi të tuat këmbë-mëndafsh,

Unë shtroj fatin tim dhe gjeninë
Bashkë me gazin, tërë afsh;

E k'të shpirt që ma shëron,
Ti, plot dritë dhe ngjyrime!
O i nxehti eksplozion
I së zezës Siberisë sime!

Franciscae meae laudes*
(Lavde Françeskës sime)

Do të këndoj me një zë të ri,
O pyll që oshëtin gjithë fuqi,
Në të zemrës sime vetmi.

Kurora t'i kap flokët e gjatë,
O vazhëza e trupit delikat,
Që shlyen çdo mëkat!

Si prej Lethës plot mbarësi,
Puthje prej teje do të pi,
Që je e mbushur tërë magji.

Se kur në vese e pështjellim,
Asgjë në jet' s'kish kuptim,
Erdhe ti Hyjni-shpëtim,

Si drita e një ylli shkëlqimtar,
Për të humburit lundërtar...
E për mua u bëre një altar!

Vaskë vyrtytesh madhështore,
Burim i përjetësisë rinore,
Zë i buzëve të mjera njerëzore!

Ti ndyrësinë ma shkrumbove;
Vrazhdësinë time lëmove;
E dobësinë ma forcove,

Tavernë mes urisë së paparë,
Në natën e thellë, ylli polar,
Mbi akullin tim, i madhi zjarr.

Forcat e mia shton aq shumë,
Çiltërsi që rrjedh si lumë,
O banjo e ëmbël, o parfum!

Unazë e zemrës në shkëlqim,
Brezore hyjnore e trupit tim,
Me të purpurin ngjyrim.

Sythbuluara degëz e hijshme,
Bukë e kripur, gjellë e shijshme,
Françeskë, o verë e magjishme!

Një dame kreole

N'tokën e profumuar që dielli e ngroh me përkëdheli,
Njoha, i shplodhur nën një kube pemësh ngjyrëpurpur
e palmash të gjelbra që mbi sy pikojnë plogështi,
Një damë kreole me magjinë e një misteri të bukur.
Brune hirësiplot, me një mish aq të ngrohtë e të qartë,
Kokën duke tundur në ajër me një krenari fisnike,
Ajo kalonte si një gjahtare e shkathët dhe shtatlartë,
Me buzëqeshjen e çiltër dhe sytë pa një grimë frike.

Sikur të vije, Zonjë, në vëndin e vërtetë për Lavdi,
Mbi të gjelbrën Luarë apo mbi bregun e Senës,
Bukuri e denjë për të stolisur kështjellat plot histori,

Do bëje të shpërthenin, e mbrojtur nën hije pemësh,
Mijra e mijra vargje sonetesh n'zemër të poetëve,
Që sytë e tu i kanë bërë të bindur si fytyrat e zezakëve.

Moesta et errabunda

Thuamë Agatë, a s'të bëhet me zemrën të fluturosh,
Larg, përtej oqeanit të zi të këtij qyteti të shurdhuar,
E drejt një oqeani tjetër shkëlqimtar, sytë t'i verbosh,
Si të ishe një virgjëreshë, blu, e thellë, e kulluar?
Thuamë Agatë, a s'të bëhet me zemrën të fluturosh?

Deti, ky deti i paanë, gjithë vuajtjet tona na i ngushëllon!
Po k'tij këngëtari të ngjirur që shoqëron organon e pafund
të erërrave-furtunë, thomëni vallë ç'më i keqi demon,
Ia dhuroi vyrtytin sublim që si në djep të na përkund?
Deti, ky deti i paanë, gjithë vuajtjet tona na i ngushëllon!

Hajt, mermë me vete karvan!Largomë e shpejta fregatë!
Larg!Larg!Këtu balta është e ngjizur prej vajtimit tonë!
-Pse vallë, s'pështpërit ndonjëherë zemra jote e trisht, Agatë:
Larg, prej krimit, sëmbimit e shpirtit që prej dhimbjes rënkon,
Hajt, mermë me vete karvan!Largomë e shpejta fregatë?

Po sa larg që je, o e magjishmja parajsa ime e profumuar,
Ku nën një qiell-kaltërsi, ka vetëm dashuri dhe gëzim,
Ku gjithçka që meriton të dashurohet është e dashuruar,
E ku në një kënaqësi qelibar zemra mbytet në ngazëllim!
Po sa larg që je, o e magjishmja parajsa ime e profumuar!

Po atë parajsë të gjelbër të dashurive fëmijërore,
Buqeta lulesh me vesë, këngë, puthje, lodra, vrapime,
Violina që dridhërojnë përmes bukurisë natyrore,
Boca plot verë, mbrëmjeve, pyjeve në ëndërrime...
- Po atë parajsë të gjelbër të dashurive fëmijërore,

At' parajsë të pafajshme, mbushur me kënaqësi tinzare,
Që ndoshta më larg se Kina apo India mund të jetë;
A mundemi vallë ta thërrasim me ulërima vajtimtare,
E me kumbime të argjendta ta kthejmë prapë në k'të jetë,
At' parajsë të pafajshme, mbushur plot kënaqësi tinzare?

Lugati

Njësoj si ëngjëjt kryeneçë,
N'heshtje do rrëshqas pa të keq,
E do të afrohem tek i yti shtrat,
Bashkë me hijet e së zezës natë;

Si me ledhatime gjarpri do të kap,
E bukura ime brune, e do të jap,
Në një shpellë zvarritur brënda,
Puthje të ftohta, siç hënës ia ka ënda.

Po kur të vijë mëngjesi i mërdhirë,
Vëndin tim pranë teje do e gjesh bosh,
E gjer në mbrëmje do ndihesh si e ngrirë.

Se mbi jetën tënde dhe rininë që të josh,
Si dikush me një ëmbëlsi tërë dritë,
Unë dua të mbretëroj me frikë.

Soneti i vjeshtës

"I dashuri im i çuditshëm, ç'meritë kam për ty në k'të jetë"
Sytë e tu të qartë si kristal, sikur më shohin e më thonë:
-Bëmë të magjepsem e hesht!Zemra ime që ti po ngacmon,
Përveç ndjesisë së një kafshe antike plot sinqeritet,

Në duart e tua e përkundur dhe e ftuar në të ëmblin gjumë,
Nga sekreti i saj i skëtershëm, asgjë s'ka për të treguar,
As legjendën tënde të zezë, në gërma zjarri s'ka për ta shkruar.
Oh, se unë pasionin e urrej e shpirti më dhëmb aq shumë!

Le të duhemi ëmbëlsisht. Dashuria, një rojtare e drobitur,
Në mes të errësirës, në pusi, tendos harkun e saj fatal.
Po unë ia njoh aq mirë veglat e të vjetrit arsenal:

Krimin, tmerrin dhe marrëzinë!- O margaritë e nemitur!
Pse, njesoj si unë, një diell vjeshtak nuk je vallë ti,
Margarita ime e akullt, e imja e panjollosura bardhësi?

Trishtimi i hënës

Sonte, hëna kaq përtace po rri duke ëndërruar;
Si një grua e bukur që me dorën e saj të lehtë,
Mes shumë jastëkve përkëdhel e shpërqëndruar,
Përpara se të flerë, profilin e gjinjve të vet,

Lart mbi shpinat e atllasta të orteqeve të butë,
Pas dergjieve të pëzgjatura dorëzohet e zalisur,
Sytë e bredhin ndër vegime të bardha, që aq urtë,
Fillojnë e i ngjiten kaltërsisë si yje të stisur.

Kur mbi këtë glob, në ngashërimin e saj të trishtë,
Një lot tinzar, ajo ngandonjëherë lë të bjerë,
Një poet i mëshirshëm, që gjumin shpirtit ia ka nxjerr,
Atë cirkë të bardhë në zvagrën e dorës e vë lirisht,
Me tërë reflekset e arta të një cope guri të çmuar,
E diku në zemër, larg rrezeve të diellit e mban mbuluar.

Macet*

Në moshën e tyre të pjekurisë, njësoj dashurojnë,
Të mënçurit e heshtur e të dashuruarit plot zjarmi,
Macet e ëmbla dhe të forta, të shtëpive krenari,
Që po si ata, mërdhakë e gjithnjë ndenjur qëndrojnë.

Qetësinë dhe tmerrin ato kërkojnë nëpër errësirë;
Mikesha të shkencës e të kënaqësive më të hijshme,
Herebi kish për t'i mbajtur si shtegtare të përzishme,
Sikur ato sjelljet e tyre kokroçe të zbuteshin me të mirë.

Ëndërrojnë në heshtje të kenë zakonet fisnike të sërës
së sfinksëve gjigandë, që thellë vetmisë gjejnë fushim,
E ashtu të menduara, sikur flenë në një ëndërr pambarim;

Piklime të lara në ar, si ato kokrizat e imta të rërës,
Andej-këtej stërpiken prej atyre bebëzave mistike,
Ndërsa prej ijeve pjellore shpërthejnë shkëndija magjike.

Bufërit

Bufërit në rradhë për një vihen vrik,
Mbi vjerdullët e zinj, mysafirë të qetë,
Me sy të kuq e shikimin si shigjetë,
Si të ishin idhuj të çuditshëm egzotik.

Ata meditojnë e rrinë si të ngrirë,
Gjer kur ora melankonike të bjerë,
E nata mantelin e saj të nxjerrë,
Rrezet e diellit duke përpirë.
Një sjellje e tillë të mënçurit i mëson,
Se nga çdo turmë apo konfuzion,
Ne duhet të ruhemi me gjithë mënd;

E se njeriu i dehur prej një hijeje që kalon,
Gjithnjë ka për ta shpaguar at' deluzion
Të dëshirës që pati për të ndërruar vënd.

Llulla*

Jam llulla që shkrimtari mban;
E ta shohësh me qartësi,
Me llullën e një të madhi duhanxhi,
Prej formës kafride a abisine ngjan.

Kur ai nga dhimbja rri sfilitur,
Unë tymos si furra gjith shtëpinë,
Që gjellën duke gatuar në guzhinë,
Mezi pret punëtorin e rraskapitur.

E di shpirtin t'ia ngjiz e t'ia kap,
Në të kaltrën e pluskusen rrjetë,
Që tirret prej gojës sime të nxehtë,

Di balsamin aromfortë t'i jap,
Që zemrën me magji t'ia përshkoj,
E shpirtin e munduar t'ia shëroj.

Muzika

Shpesh si një det muzika trupin ma merr!
Drejt yllit tim të zbehtë,
Nën qiellin e mjegullt a të pamasin eter,
Unë lundrimin nis i qetë;
Me kraharorin përpara e mushkëritë e gufuara,
Si një velë fort e ndehur,
Kapërcej kreshtat e dallgëve të pakapërcyera,
Që nata m'i mban fshehur;

Ndjej në të gjithë trupin të më vibrojë ai pasion
I një anijeje në stërmundim;
Era e mbarë, stuhia dhe pështjellimi i saj më çon,

në një humnerë pambarim,
e më përkund.Herë tjetër, më bën të shoh të shëmbëlluar,
Në detin vaj, shpresën time të rrënuar!

Varrim

Nëse në një natë prej territ rënduar,
Një kristian i mirë si për mëshirë,
Pas ndonjë rrënoje të vjetërruar,
Do varros trupin tënd të bërë firë,

Në çastin kur yjeve dritë-purpur,
Sytë gjumi rëndë do t'ua pllakosë,
Merimanga cergën e saj do të thurr,
Ndërsa nepërka vezët do të vendos;

E gjith vitin do dëgjosh si të trokitura,
Mbi kokën tënde të dënuar,
Ulërimën e ujqërve duke vajtuar,

Sokëllimën e shtrigave të urritura,
Orgjitë e epsharakeve plakë,
E kompllotet e hajdutëve sy-gjak.

Gravurë fantastike

Lugatit të pazakontë, për të vetmen veshje e stoli,
Groteske i qëndron mbi ballin e tij prej skeleti,
Veç një kurorë e frikshme, e denjë për karnaval.
Pa mamuz, pa kamzhik, ai bën të dihasë një kalë,

Po kaq të fantaksur sa ai, gërdall apokaliptik,
Që prej hojzave kullon jargë si një epileptik.

Hapësirën ata kalërojnë, të dy bashkë të pandarë,
Duke shkallmuar pafundësinë me një galop guximtar.
Kavaljeri, një kordhë që shkrepëtin, fort rrotullon,
Mbi gjurmët anonime që thundra e kalit thërmon,

E, shkon si një princ që mbikqyr kështjellën e tij,
Mes përmes varrezës së paanë, të akullt, plot zymti,
Ku nën një diell të bardhë, me rreze të marrta drite,
Prehen popujt e historisë moderne dhe antike.

Vdekja e hareshme

Në një copë vëndi të shkretë me kërmij mbuluar,
Një gropë të thellë unë dua të rrëmij si një hienë,
Të rrehatoj për qejf çdo eshtrën time të vjetëruar,
E të fle në harrim si mbi dallgët një peshkaqen.

Varret dhe testamentet i kam urryer gjithnjë;
As botës s'dua ti lutem për mua të derdh lotë,
Më mirë do të doja, për së gjalli, korbave tu lë,
Mundësinë për ta bërë fërtele trupin tim të kotë.

O krimba!Miqtë e mi të zinj pa sy e pa veshë,
Filozofë qefllinj, bij lindur e rritur në kalbësirë;
-Kur të shihni t'ju vijë një kufomë e gëzuar, e lirë,

E pa sëmbim, mbi mbeturinat e saj të bini ndesh,
Tregomëni ju lutem, se ç'torturë tjetër e pret,
K'të trup plak, të vdekur mes të vdekurve në k'të jetë!

Buti i urrejtjes*

Urrejtja është buti i Danaideve** fytyrëhequra;
Hakmarrja me krahë të fortë dhe të kuq, më kot,
Në fund të errësirave të saj bosh e të ndenjura,
Hedh kova të mëdha plot gjak e prej të vdekurish lot,

Vetë Satanai në ato humnera sajon truket e tij,
I rrekur dhe i djersitur, prej mijra vitesh i arratisur;
Po nëse do të mundej viktimat t'i ngjallte përsëri,
Ajo më shumë do t'ua shtrydhte trupat e sapostisur!

Urrejtja është një pijanec në fund të tavernës,
Që gjithnjë prej pijes ndjen etjen t'i ndizet zjarr,
E ti shumëfishohet si trupi i hidrës*** së Lernës.

- Po e njohin mirë fitimtarin të hareshmit pijetarë,
Ndaj ajo është e dënuar me fatin e saj të mjerë,
Që kurrë nën tavolinë të mos flerë ndonjëherë.

Këmbana e plasaritur

Netve të dimrit, është mjalt' e ëmbël, e hidhur zeher,
Të dëgjosh pranë druve që kërcëllijnë e tymojnë,
Të largtat kujtime të ngrihen dalngadalë nëpër terr,
Nën jehonën e këmbanave që n'mugëtirë këndojnë.

E bekuar qofsh këmbanë me atë buçimën fisnike,
Që edhe pse e plakur, prapë e zellshme ngulmon,
Besimin të shpërhapësh me britmën tënde besnike,
Si një ushtar i vjetër që nën tendë rri e vigjëlon.
Oh, unë, unë shpirtin e kam të plasaritur, prej mërzisë prekur!
Po ai përsëri, do ftohtësinë e natës për ta populluar
me këngët e tij, edhe pse shpesh do t'i ndodhë që zëri i mekur,

T'i ngjajë grahmës së zvargur të atij të plagosuri të harruar,
Ndanë një liqeni gjaku, nën një pirg trupash pa jetë,
Që mes përpjekjesh të pamasa, s'bën dot lëvizjen më të lehtë.

Spleen * (I)

Me shiun gjer në palcë, inatin tërë qytetit ia ndez,
Prej urnave të saj fjollë-fjollë një errësirë të ftohtë,
Derdh mbi banorët verdhacukë të së afërmes varrezë,
E rrethinave plot mjegull bën të mbizotërojë mort.

Macja ime mbi gjerbë për një shtrojë duke bredhur,
Pa paqë e turfullon atë trup zgjebarak dhe thatim,
Shpirti i një poeti të plakur në një ulluk hedhur,
Tingëllon i trishtë, si një fantazëm me dridhërimë.

Këmbanorja ofshan vajtushëm, cungu që tymon,
Zëmprehtë lavjerrësin plot rrufë shoqëron,
Kur në një dorë letrash të pista, në të hidhurin ilaç,

Trashgimni fatale e një plakusheje hidropike**,
Fanti i bukur kup dhe çupa maç,
Gjykojnë ogurzinj dashuritë tashmë tragjike.

Spleen (II)

Kam më shumë kujtime se një njëmijëvjeçar.

Një dollap i stërmadh me aq shumë sirtarë,
Plot vargje, romanca, letra dashurie, proçese, llogari,
Gërshetë të gjatë mbështjellë në deftesa borxhi,
Fsheh më shumë sekrete se sa truri im i trishtë;
Ai është një piramidë, një gropë e pafundme, e ligsht,
Që ka më shumë të vdekur se një varr i thjeshtë brënda tij.

-Unë vetë jam një varrezë, edhe nga hëna parë më neveri,
Ku si sëmbime të hidhura krimba të gjatë zvarriten gjithnji,
Duke ndjekur nga pas më të dashurit e të vdekurve të mi.
Unë i ngjaj plot trëndafila të vyshkur, një të vjetri sallon,
Që vetëm gjëra të dala mode në veten e vet grumbullon,
Ku tabllo të zbehta të Busherit dhe pastele patetikë,
Të vetmuara, thithin aromën e një boce të hapur vrik.

Asgjë s'barazohet me plogështinë e ditëve çalamane,
Kur netve t'akullta nën flokët e rëndë të borës mjerane,
Mërzia, ky fryt i trishtë i një moskokëçarje të pamasë,
Së përjetshmes i rrëmben çdo formë e çdo përmasë.
-Ndaj, që sot e tutje, ti do të jesh, o materie e gjallë!
Veç një shkëmb graniti rrethuar nga një lemeri e rrallë,
Në fund të një Sahare të mjegullt për të fjetur i përzënë;
Një sfinks i vjetër nga një botë e shkujdesur n'mohim lënë,
Edhe në hartë harruar, humori i egër i të cilit këndon,
Vetëm nën rrezet e mpakura të diellit që perëndon.

Spleen (III)

Unë i ngjaj mbretit të një vëndi rrahur nga shiu aq gjatë,
I pasur, por i pafuqishëm, i ri, e megjithatë shumë plak,
Që duke përbuzur nderimet e mësuesve plot temena,
Me qentë, si me kafshët e tjera, mërzitet sa më s'ka.
As gjahu, as fajkojtë, jo, asgjë më se gëzon,
As populli i vet që vdes para të tijit ballkon.
I zgjedhur prej baladave groteske, paljaçoja i gjorë,
S'mundet t'ia freskojë dot ballin të dergjurit mizor;
Shtrati i tij zambakplot kthehet në një varr të paanë,
E damat përreth, të cilave u duket i bukur çdo sovran,
S'dinë ç'gjë të turpshme të guxojnë, të zëna në siklet,
Si e si t'i nxjerrin një buzëqeshje më të riut skelet.
S'ka mundur dot as shkencëtari i mënçur arprodhues,
Ta shkulë prej qënies së tij elementin korruptues,

E nëpër banjot e gjakut që prej romakëve i trashëgojmë,
Tek të cilat të fuqishmit ditët e pleqërisë shpesh kalojnë,
Nuk ka ditur këtë kufomë të trallisur ta ngrohë pak,
Që në deje ndjen t'i rrjedh uji i gjelbër i Letës, e jo gjak.

Spleen (IV)

Kur qielli i plumbtë, i ulur e i rënduar si një mbulesë,
Mbi shpirtin vajtonjës, pre të ngashërimeve të gjata,
Gjithë vijën e horizontit puth e përqafon me dënesë,
Duke shpërndarë ditë të zeza më të trishta se nata;

Kur toka ka kyçur gojën brënda një të lagshte qeli,
Kur shpresa si t'ish lakuriq nate, dhimbshëm qan,
Krahët e ndruajtur pas murit i përplas gjithë fuqi,
E kokën thyen tërë zhurmë mbi të kalburin tavan;

Kur shiu me rrëketë e tij nëpër hapësira të shtrira,
Sikur imiton kangjellat e hekurit të një burgu të paanë,
Një popull i tërë memec merimangash të pështira,
Vjen të thurrë cergat e tij në thellësi të truve tanë,

Papritur, prej këmbanave shpërthen tërbimshëm,
E drejt qiejve nis e turret, një i tmershëm vajtim,
Si një shpirt pa atdhe, si endacak i rëmbimshëm,
Që plot pasion e durim gjëmon me ulërimë.

-Funeralë aq të gjatë, pa tamburë e pa muzikë,
Në shpirtin tim fillojnë të marshojnë me ngadalsi;
Shpresa fitimtare kullon në lot e Ankthi despotik,
Mizor, mbi kafkën time ngul flamurin e tij të zi.

Fiksim

Ju dua, pyje të mëdhenj, se më joshni si katedralet mistike;
Tingullmprehta si një organo, në zemrat tona të mallkuara,
Dhoma të zisë së përjetshme ku vibrojnë regëtima antike,
Bëni të jehojnë *De Profundiset* tuaja, thellësive të lëshuara.

Të urrej Oqean! Se në shkulmimin dhe gjëmimin tënd,
Gjej shpirtin tim; se të qeshurën e hidhur që ia përkund
buzët një fitimtari, që vetëm shan e psherëtin anë e kënd,
Unë ndjej e dëgjoj në atë të detit hokatje të pafund.

Sa do të doja, o natë!Pa yjet e dritën e tyre të zjarrtë,
Që flasin një gjuhë të panjohur për njerinë!
Se zbrazësinë unë kërkoj, të zezën dhe lakuriqësinë!

Madje dhe qielli n'errësirë si tabllo më ngjan atje lart,
Tabllo, ku sytë e mi kanë ngritur si kurorë,
Mijëra qënie tashmë të zhdukura nga shikimi njerëzor.

Shije për asgjë

Shpresa që të ngucte me mamuz për të të ngarë,
Shpirt i ngrysur, aq shpesh nëpër luftra i rregjur,
S'do të të kalërojë më!Po mos ki turp tek rri dergjur,
Ti, o kaluc plakush që këmbët ngatërron në çdo ugar,

Dorëzohu, zemra ime; fli ndër ëndrra të këqija e vrarë.

Dashuria nuk ka më shije, as debati e as sherri,
Për ty shpirt fitimtar, i sfilitur! O qerata i dëgjuar;
Kënaqësi, mjaft tundove një shpirt të dëshpëruar!
Lamtumirë këngë flauti në zemrën e një të mjeri!

Pranverës së adhuruar parfumet ia ka shtegtuar vreri!
Koha me çapa të mëdha më gëlltit minut për minut,
Si bora e parreshtur një trup të brishtë e të paktë;
Unë nga lart e kundroj këtë glob të rrumbullaktë,
Po se lus të më gjej një vënd ku kokën të fut.

Ortek, a do t'më vërvisësh dhe mua në ndonjë skutë?

Alkimia e dhimbjes

Kush të vesh me zinë e vet, natyrë!
Kush të shkrepëtin me të tijin zjarr,
Ti njërit thuaji me bindje:Varr!
Tjetrit: Jetë, Dritë dhe Ngjyrë!

Gjithnjë më ke bërë të ligsht,
Hermes i panjohur që më shoqëron,
Se ti Midën me mua barazon,
Mes alkimistëve më të trishtë;

Arin me hekur ta kam përngjitur,
Parajsën me Ferrin e përzhitur;
Për ty, nga ajo e reve shami,

Një kufomë të dashur zbuloj,
E në sinoret e qiellit-kaltërsi,
Sarkofagë madhështorë krijoj.

Tmerr simpatik*

Tërë ky qiell kapriçoz e meit,
I bërë çika-çika si ky fati jonë,
Në zemrën e zbrazur ç'po të nxit,
O njeri? Përgjigjmu, ç'mendon!

-Kurrë i nginjur, gjithnjë lakmitar
Për çdo gjë të pasigurtë, të mjegulluar,
Unë s'do të epem si Ovidi duke qarë,
Prej Edenit roman të zbuar.

Qiej të shkrumbuar si një djerinë,
Mbi ballin tuaj unë thyej krenarinë;
Retë tuaja të pamasa në zi e pikëllim,

Janë karroca funebre të ëndrrave të mia,
E përshkënditja juaj, i Ferrit shëmbëllim,
Ku kjo zemra ime prehet nga kënaqësia.

Heauton Timuroumenos*

Pa urrejtje, si mishin një kasap,
unë do të godas, dhe pa mëri,
Si Mozeu shkëmbin me purtekën e tij!
Po, me bebëzat e tua udhën do të hap,

Saharën time për të ç'zhuritur,
Duke vërshuar lumin e lëngesës.
E dëshira ime me flatrat e shpresës,
Si anije mbi lotët e tu të kripur,

Nën një erë të mbarë do lundrojë;
Pastaj zemra e dehur gjer në mort,
Si një tambur i rrahur aq fort,
Psherëtimën e ëmbël do ta jehojë!

Mos vallë jam një akord i mbrapsht,
Në harmonjozen hyjnore simfoni,
Për shkak të kësaj makuteje Ironi,
Që më kafshon pa më lënë gjëkafsh'?
Ajo në gjakun tim, helm veprimleht!

Ajo brënda zemrës sime fort cihat!
E unë jam pasqyra ku gjithë mëkat,
Shtriga vjen të shoh fytyrën e vet.

Unë jam shuplaka dhe faqja e kthyer!
Unë jam kama e mishi që ajo shpon!
Rrota dhe gjymtyra që ajo sakaton,
Jam viktima dhe xhelati i urryer!

Unë jam i zemrës sime, vampiri i zi!
-Një nga ata të mëdhenjtë e harruar,
Që ngaqë buzëqeshja i është mohuar,
Koha e dënon të qeshë përgjithnji!

E pandryshueshmja

Një Qënie, një Formë, një Ide,
Mbi një Stiks tërë baltë e pa dritë,
Nën një qiell që asnjë shikim s'qit,
Prej kaltërsisë së pamasë bie;

Një Ëngjëll, kokëkrisur udhëtar,
Që dashurinë e mbrapshtë ka provuar,
Thellësive të një tmerri të pambaruar,
Krahët përplas shpejt si një notar,

E egër dylufton, oh ç'ankth funebër!
Ndaj një ajne gjigande, të paparë,
Që qesh e ngërdheshet si e marrë,
Tek përdridhet në një errësirë makabër!

Një viktimë e magjisë së verbimit,
Prej një strofke reptilësh për tu arratisur,
Në bredhje të kota, perjetë katandisur,
Kërkon dritën dhe udhën e shpëtimit;

Një i dënuar që zbret pa fener,
Buzë një honi që prej myshkut ndjell,
Ndjesinë e një lagështire të thellë,
Mes shkallëve të përjetshme në erë,

Ku rrinë zgjuar mostra veshtullore,
Me ata sytë e fosfortë e të shqyer,
Natën më të zezë për ta ngjyer,
Që vëtëm veten të shfaqin prore;

Një anije në pol ngecur në akullnajë,
Si t'ish brënda një çarku në kristal,
Kërkon n'udhën e vet atë shtegun fatal,
Që si në birrucë po e bën të ofshajë;

-Emblema të qarta, tabllo në përsosmëri,
Për idenë e një fati të pandreqshëm më,
Për asyen e të menduarit se çdo gjë,
Djalli e bën aq mirë e me saktësi!

2.

Bisedë kokë më kokë, e zymtë, e kulluar,
E një zemre që vetvetes i bëhet pasqyrë!
Pus i qartë i së Vërtetës me të zezën ngjyrë,
E me një yll të zbehtë, lart duke fërgëlluar!

Një far ironik, i skëtershëm aq shumë,
Pishtar hirësish me flakët e djallëzisë,
Burim i vetëm i ngushëllimit e lavdisë,
- Ndërgjegjia e të rrojturit në llum!

Ora

Ora!Idhull i mbrapshtë, kobndjellës, i patundur,
Me gisht na kërcënon: Mos harroni duke na thënë!
Të gjitha dhimbjet si shigjeta n'shënjë kanë për të rënë,
Në zemrat tuaja plot lemeri, nga hidhërimi shkundur;

Kënaqësia e avulluar ngrihet e horizontin davarit,
Si zanë që diku në një cep të skenës, e heshtur rri;
Gjatë gjithë kohës me çdonjërin nga ne bie në ujdi,
E një copë mishi të mirë, çdo çast trupit na shqit.

3600 herë në orë, Sekonda rri duke na pështëritur,
Mos harroni!-E shpejt të Sotmes zëmprehtë si insekt,
I thotë: Unë jam po ajo që dikur, gjakun e nxehtë
dhe jetën, me thumbin tim të ndyrë ta kam thithur!

(Të gjitha gjuhët i flet fyti im metalik e i tharë)
Remember! Souviens-toi! Esto memor! Papushim!
Minutat, të shkujdesurat mortore, kokriza pambarim
janë, të një rrëre nga e cila s'duhet lënë pa nxjerrë ar!

Mos harroni se Koha është si ai lojtari tamaqar:
Të fitojë çdo dorë, pa hile! Ja ky është ligji i tij.
Klepsidra zbrazet; Humnera thotë: Dua të pi!
Dita shkurtohet, nata zgjatet e nxin si varr!

Shpejt do të të vijë të kumbojë ora ku Rasti hyjnor,
Ku gruaja jote ende e virgjër, vyrtyti që të madhështon,
Ku vetë Pendimi (oh!I fundmi që të merr e të strehon)
Ku gjithçka do thotë:Është aq vonë!Vdis, o burracak i gjorë!

TABLLO PARIZIANE

Pejsazh

Unë dua, që kur të thurr këngën time hyjnore,
Të fle si astrologët, në mënyrë madhështore,
Pranë një këmbane, për të dëgjuar në revan,
Himnet solemne që kudo në ajër ajo shpërndan.
Me mjekrën ngulur mbi duar, nga e larta imja çati,
Do të shoh punishten që gumëzhin plot gjallëri;
Qyngjet, këmbanoret, k'to antena që ajrin shpojnë,
E ata qiej që t'përjetshmen na bëjnë të ëndërrojmë.

Është aq ëmbël përmes brymës të ulesh e të rrish,
Për të parë një dritë në dritare, një yll mes kaltërsish,
Lumenjtë e karbonit tek i ngjiten qiellit aq qetë ,
Hënën tek derdh shiun e magjisë së saj të zbehtë.
Do të shoh pejsazhe pranvere, vere dhe vjeshte;
E kur të vij dëbora monotone e dimrit në heshtje,
Do mbyll nga të gjitha anët çdo portë e kanatë,
Që pallatet e mi magjikë ti ngre natës së gjatë.
Pastaj do ëndërroj kopshte, horizonte blu, të pastër,
Puthje, currila uji prej shatërvaneve në alabastër,
Zogj pingërues mbrëmjeve e puhizave mëngjezore,
E gjithçka që një Idil ka më shumë fëmijërore.
Poterja, xhamin duke ma fshikëlluar gjithë sqimë,
S'do të mund të m'i ngrejë sytë nga një lexim;

Se do të jem i kredhur i tëri në këtë kënaqësi,
Që Pranverën ta sjell me dëshirën gjithë zjarrmi,
Prej zemrës sime të gjallëruar një diell të nxjerr,
E prej mendimeve të ndezura të ngrohtën atmosferë.

Dielli

Përgjatë periferisë me të mbyllurat kanate,
Strehimit të vjetër të sekreteve epsharake,
Kur dielli godet mizorisht e rrezet e tija i dyfishon,
E mbi qytet e fusha, mbi çati e ara me grurë i lëshon,
Unë më vete stërvitem për fantastikun tim dyluftim,
Duke nuhatur në çdo cep më të goditurën rimë,
Duke u penguar tek fjalët si në një të lartë trotuar,
E duke u plasur me vargjet e ëndërruar gjatë më parë.

Ky babai ynë i adoptuar, armik për çdo kloroz,
Zgjon fushave si krimbat ashtu dhe trëndafilat rozë,
Bën ngashërimet të avullojnë e si re të lehta i çon,
E si hojet me mjaltë, trutë tanë me mendime i rëndon.
Është ai që plakun me paterica me të shplarin pellush,
E kthen të ëmbël, të ri e plot hare si një vogëlush;
Që urdhëron kallëzën e grurit të mbushet e piqet,
Në zemrën e pavdekshme që gjithnjë çel e rritet.

Kur, si një poet, rrugët dhe shtëpitë e qytetit çik,
Edhe gjërave më burracake u jep një fat fisnik ,
E si një mbret hyn, pa zallahi dhe pa karvane pas,
Si pallateve të bukura ashtu dhe azileve plot maraz.

Lypëses flokëkuqe

Flokëkuqe, e bardhë si dëborë e panjollosur,
Vogëlushe, ai fund plot vrima e i zhubrosur,
Ta nxjerr më në pah varfërinë
Dhe bukurinë,

Për mua, poet që s'ka shumë rëndësi,
Ai trupi yt i sëmurë, i hajthëm dhe i ri,

Me pulla të kuqe tek-tuk mbuluar,
Është aq i ëmbëlsuar.

Ti e mbushur plot nur e mirësi mban,
Më shumë se një të kadifejtë fustan,
Të një mbretëreshe në romane
Ato të rëndat nallane.

Përballë zheles tënde të shkurtër fare,
Dikush një fustan oborri vesh krenare,
E të zvarrit pala të gjata fëshfëritse,
Para këmbëve mahnitse;

Që në vënd të asaj çorapeje të shpuar,
Për kënaqësi të atyre syve t'epshëruar,
Një pinjall i artë akoma të shndrij,
Në kërcirin plot purpuri;

Që nyjet e fustanit të zgjidhen pak nga pak,
E të zbulojnë për të shpënë këdo në mëkat,
Ato gjinjtë e tu të butë e të bukur,
Si sy me diellin brënda futur;

Që rrobat prej trupit të të shkëputen,
Krahët të palosen sikur duan të luten,
E të dinë të dëbojnë syguximtarë,
Gishtërinjtë lakmitarë,

Perlat e ujit më të kthjellët e të qetë,
Të mjeshtrit Bello, më t'bukurit sonet,
T'jepen prej t'ethshme të përvëluar,
Që ti ke torturuar,

Ata poetucë të këqinj që të dhurrojnë,
Të fundmet vargje që për ty krijojnë,
Mos pulpat të kundrojnë vallë
Fshehur nën shkallë?

Më shumë se një aventurë në errësirë,
Më shumë se një Ronsar a zotëri i mirë,
Ata do donin ta spiunonin me nge,
Atë të freskëtën fole!

E ti mund të numëroje vetëm për pak,
Në shtrat, më shumë puthje se zambak,
E si Valua mund të vije në vënd
Ligjin tënd!

-Megjithatë, ti vazhdon e lyp zëdredhur,
Ndonjë lëmoshë të vjetër diku hedhur,
Mbi pragun e një Vefuri q'ulërin
Në një kryqëzim;

E ata sytë e tu tinëzisht i vë përposh,
Drejt nji xhevahiri që s'vlen dy grosh
Oh!më fal!Se s'mundem të ta jap,
Si për dhurratë.

Po ti shko, shko, pa në trup një brilant,
Pa një parfum, pa një perlë a diamant,
Veç me lakuriqësinë thatime,
O e bukura ime!

Mjellma*

Viktor Hygos

Andromakë, për ty po mendoj!Ai i shkurtër lumë,
Pasqyrë e shkretë dhe e trishtë e asaj kohe të shkuar,
Ku madhështia e zisë tënde të ndriste aq shumë;
E ajo Simoentë gënjeshtare prej vajit tënd harbuar,

Kujtesën time ma ka shtrirë më të pamasë se deti,
Ja, papritur, tek po kaloja ndan një Karuzeli të ri.
Parisi i vjetër s'është më (medet, forma e një qyteti
që ndryshon më shpejt se sa zemra tek një njeri);

K'të fushë barakash mund ta shoh veç në shpirtin tim.
Trungje kolonash në pirg, aty-këtu kapitolë të skalitur,
Llagaçeve të ujit, barishte, tufa myshqesh në gjelbërim,
E rrangullina të shpërhapura xhamave duke rrezëllitur.

Atje, ku dikur një kafaz bishash të rralla ngjallte frikë;
Atje, një mëngjes, kur nën ca qiej të ftohtë e të lartë,
Puna zgjohet e nëpër hapësirë ngrihet një uragan i lig,
Prej grumbujve të plehrave drejt ajrit zhurmëpak,

Pashë një mjellmë prej kafazit të vet arratisur,
Që lëkurën e këmbëve rripte kalldrëmit të thyer,
E puplat bardhoshe truallit gropa-gropa i linte zvarrisur.
Ndan një rrëkeje të përtharë me sqepin e shqyer,

Me krahët duke i kredhur në pluhurin tërë tërsëllimë,
Me zemrën plot me ujin e bukur të liqenit nga kish dalë,
Duke thënë:"Kur do biesh, shi!Kur do gjëmosh, bubullimë?"
Unë e kundroj atë fatkeqe - mit të çuditshëm dhe fatal -

E shoh ndonjëherë qiejve, si pasardhësi i Ovidit të ngratë,
Drej atyre qiejve ironikë e asaj së pamëshirshmes kaltërsi,
Me qafën që në përpëlitje kokën e saj lakmitare mban lart,
Si të dojë të qortojë vetë Zotin dhe vendimin e tij!

2.

Parisi ndryshon, por jo, asgjë brënda simes melankoli
S'tundet!Pallate të rinj, pirgje dheu, skela anembanë,
Lagjie të vjetra, gjithçka tek unë shndërohet në alegori,
E kujtimet e dashura më të rënda se shkëmbenjtë më janë.

Këtu, përballë Luvrit, një imazh po shtrydh shpirtin tim:
E unë mendoj mjellmën time të madhe e të shqetësuar,
Me sjellje të marra, si çdo mërgimtar, qesharak e sublim,
Nga një deshirë brejtur papushim!Pastaj ty të kam menduar,

Andromakë, në krahët e dhëndrit të shquar e rënë
Si një bishë frikacake, kur krenaria superbe e Pirros,
Të rreku të kërrusur ndaj një varri bosh të lënë;
Medet! Vejusha e Hektorit, e pastaj nusja e Helenos!

Pastaj mendoj at' vogëlushe zezake prej veremit tretur,
Që sylebetitur ecën e kërkon rrugëve, përmes llucës,
Arat e kokosit të superbes Afrikë në ndonjë cep mbetur,
Diku, përtej murit të lartë e të pafund të mjegullës;

Mendoj atë që ka humbur diçka që s'kthehet dot më,
Kurrë, kurrë!Ata që lotët e hidhur i kanë fishkur,
E Dhimbjen, si thithat e një ulkonje bujare pijnë nën zë!
Mendoj dhe ata jetimët thatanikë që si lule janë vyshkur!

Kështu, nëpër pyllin ku shpirti im është mërguar,
Një kujtim i lashtë i fryn me sa fuqi që ka brirët të tij!
Po unë mendoj akoma për ata marinarët në ishuj harruar,
Për t'burgosurit, fitimtarët!..E për aq të tjerë me dashuri.

Shtatë pleqtë*

Viktor Hygosë

Qytet që gjallon, qytet ku aq ëndrra gumëzhijnë,
Ku lugetrit në ditën për diell kalimtarët ndalojnë!
Nga të gjitha anët misteret si limfa lëvrijnë,
E gjigandit të plotfuqishëm kanalet ia përshkojnë.

Një mëngjes, kur mjegulla shtëpitë i kish zmadhuar,
Në një rrugë të trishtë dëshira për dore më morri,
Ato u ngjanin digave ngritur ndanë një lumi të gufuar,
E, një dekor i njësojtë me shpirtin e një aktori,

Një re e verdhë, e pistë pluhuri, ajrin kish ngjyruar;
Unë po ecja si ai heroi gjaknxehtë që nervat mpin,
Me shpirtin tim tashmë të lodhur duke kuvenduar,
Mes periferisë që prej qerreve të rënda kërcëllin.

Papritur, një plak me ca rrecka të zverdhura veshur,
Që imitonin ngjyrën e një qielli mbytur në shi,
Me pamjen që dorën me lëmoshë do t'ja kish ngjeshur,
Nëse në sytë e tij të mos digjej një dritë e lig mavi,

M'u shfaq para syve. Bebëzat i kish kalitur në vrer,
Shikimi i tij ngricën e bënte akoma më të gjatë,
Mjekra qimedendur që përpara i zgjatej përherë,
Ngjante ashtu e ashpër, e drejtë, si e Xhudës shpatë.

Nuk ish i përkulur, por i thyer fort, shpina e tij,
Formonte me këmbët një kënd perfekt të drejtë,
Edhe pse bastuni pamjes i jepte aq përsosmëri,
Prap çehrja e çapat i dukeshin të ngurta, pa jetë,

Si të një çifuti këmbëshqyer a katërkëmbëshi të çalë.
Përmes dëborës dhe llucës ai ecte duke u ngatërruar,
Si të shkelte kufoma me shapkat e veta, ashtu ngadalë,
Më shumë armiqësor me universin, se sa i shpenguar.

Po e njëjta mjekër, po i njëjti sy, po të njëjtat zhele,
Po ai bastun, po ajo shpinë, si prej të njëjtit ferr nxjerr,
Një binjak qindvjeçar e ndiqte pas; e të bërë fërtele,
Dy lugetrit ecnin drejt një fundi të panjohur ndonjëherë.

Në ç'kompllot të turpshëm pra, vallë u harrova,
A në ç'aventurë të paudhë shpirti im ish përgjëruar,
Pse minutë për minutë, shtatë herë e numërova,
Atë plak të mbrapshtë që m'dukej si i shumëfishuar!

Po kush do që ta shpotisë shqetësimin tim,
E rrënqethjen vëllazërore mos ta ketë të ndjeshme,
Le ta dijë mirë, se edhe të gërdhuqur e në harrim,
Ato shtatë mostra të pista kishin diçka të përjetshme!

Pa vdekur në vënd, pse vallë, s'do kisha kundruar,
Një soze të tetë, po ironik, fatal e të pashmangshëm,
Fenik të neveritshëm, bashkë me të tjerët duke kaluar?
-Por jo, unë i ktheva shpinën kortezhit të skëtershëm!

Me pezmin e një të dehuri që sheh çdo gjë dyfishuar,
Hyra dhe u mbylla në shtëpi, mes frikës dhe tmerrit,
I sëmurë dhe i ngurosur, i makthshëm dhe i trazuar,
I zhgënjyer, shpirtplagosur prej absurditetit dhe misterit!

Më kot arsyeja mundohej timonin fort ta shtëngonte,
Ai për të shmangur shtrëngatën rrotullohej me vështirësi,
E shpirti im si një barkë e vjetër, vallëzonte e vallëzonte,
Pa vel e pa direkë, në një det monstruoz e pakufi.

Plakushkat

Viktor Hygos

1.

Nëpër rrudhat plot dredha të qyteteve të vjetra tashmë,
Ku gjithçka, dhe tmerret kthehen në gjëra të mrekulluara,
Unë përgjoj, humoreve t'mia fatale duke iu bindur nën zë,
Qëniet më të çuditshme, të bukura e të shpartalluara.

Po femra ishin dikur k'to mostra të shthurrura pa fre,
Mostra jetkëputura, të shtrëmbra a të gërmuqura!
Le t'ju duam, se thellë shpirtra ju jeni, Eponin a Laide!
Nën rrobat e ftohta, në fundet e leckosura e të ndukura,

Ato rrënqethen n'rropamën e om nibusve që qarkullojnë,
Zvarriten nën një erë të prapë, t' acartë e fshikëlluese,
E si një relike të shenjtë fort pas ijeve shtrëngojnë
Një çantë të vogël të qëndisur m e lule dhe rebuse;

Rrokullisen në çdo hap e ngjajnë aq shumë me kukullza,
Çapiten rëndë-rëndë si bisha të plagosura përtokë,
Vallëzojnë, pa dashur të vallëzojn ë, oh këmbanëza
të shkreta, ku Demoni i paëshi rshëm varet fort!

Po sytë e tyre janë si turjelë e hol lë dhe e mprehtë,
Xixëllitse si ato puset me ujin që netve bie të flerë,
Janë sytë hyjnorë të vogëlushes së bukur e të qetë,
Që të shtang e për gjithçka shndr it, qesh shënd e verë.

Shumë qivure plakash - a e keni vënë re ndonjëherë? -
Janë njëlloj e po kaq të vegjël sa qivuri i një fëmije!
Vdekja mbi këta qivurë vendos e mençur si përherë,
Simbolin e një të çuditshmeje e robëruseje shije,

E kur unë mezi dalloj një fantazë m të ligështuar,
Që kalon përmes tabllosë së Paris it plot gjallëri,
Më ngjan gjithnji se ai trup i sëm urë e i dobësuar,
Ëmbëlsisht shkon në përkundjen e një djepi të ri;

Vetëm që, në labirintet e gjeomet risë duke mediuar,
Të mos pyes veten, tek shoh ato gjymtyrë plot ç'rregullsi,
Se sa herë zdrukthtari i shkretë ka për t'ia ndryshuar,
Formën asaj kutie ku trupi i saj do prehet në qetësi.

-Oh, po ato sy janë puse të mbrujtura nga miliona lot,
Shkurakë, ku edhe pse i ftohur, metali xixëllon me furfuri...
Janë sytë misteriozë të magjisë më ngadhnjyese në botë,
Të atyre që patën për nënë më mizoren Fatkeqësi!

4.

Vogëlushka plakushe, ju vazhdoni stoike e jo si mjerane,
Përmes kaosit të paanë të këtij qyteti duke jetuar,
Nëna zemërgjakosura, të shënjta apo kurtizane,
Me emrat tuaj që dikur kishin një timbër të shquar.

Oh, ju që ishit plot mirësi, oh, ju që ishit plot lavdi,
Askush s'ju njeh më!Një i dehur i prapë e endacak,
Duke ecur ju hedh shpotinë e nje qesharakeje dashuri,
Ndërsa para këmbëve ju përdridhet një djalosh burracak.

Prej vetes të turpëruara, si ato hijet e përhimshme,
Profilet e mureve duke ndjekur me t'kërusurën shpinë,
Askush s'ju përshëndet, o pjella të fateve të çuditshme!
Mbeturina të njerëzimit, po të gatshme për përjetësinë!

Ndërkaq, unë prej së largu ju përgjoj gjithë dhëmbshuri,
Sytë i fiksoj tek ato hapat tuaj të pasigurtë, hiç të qetë,
E njësoj sikur të isha babai juaj, oh e madhja mrekulli!
Shijoj thellë meje, një kënaqësi të butë e të fshehtë:

Shoh rishtazi aq shumë pasione brënda jush të lulëzuara;
Shoh ditët që keni humbur, të zymta a të lavdishme;
Gëzoj në zemër, gjithë veset tuaja të shumëfishuara!
Ndërsa gjithë vyrtytet, shpirtit më shndrisin të hijshme!

Ju gërmadha!Ju familja ime! O mëndje vetmitare!
Një lamtumirë solemne ju dhuroj çdo natë mes të ftohtit!
Po më thoni, ku vallë do të jeni nesër, o Eva 80-vjeçare,
Mbi të cilat përvëlon tmershëm gërvishtja e zotit!

Po femra ishin dikur k'to mostra të shthurrura pa fre,
Mostra jetkëputura, të shtrëmbra a të gërmuqura!
Le t'ju duam, se thellë shpirtra ju jeni, Eponin a Laide!
Nën rrobat e ftohta, në fundet e leckosura e të ndukura,

Ato rrënqethen n'rropamën e omnibusve që qarkullojnë,
Zvarriten nën një erë të prapë, t'acartë e fshikëlluese,
E si një relike të shenjtë fort pas ijeve shtrëngojnë
Një çantë të vogël të qëndisur me lule dhe rebuse;

Rrokullisen në çdo hap e ngjajnë aq shumë me kukullza,
Çapiten rëndë-rëndë si bisha të plagosura përtokë,
Vallëzojnë, pa dashur të vallëzojnë, oh këmbanëza
të shkreta, ku Demoni i pamëshirshëm varet fort!

Po sytë e tyre janë si turjelë e hollë dhe e mprehtë,
Xixëllitse si ato puset me ujin që netve bie të flerë,
Janë sytë hyjnorë të vogëlushes së bukur e të qetë,
Që të shtang e për gjithçka shndrit, qesh shënd e verë.

Shumë qivure plakash - a e keni vënë re ndonjëherë? -
Janë njëlloj e po kaq të vegjël sa qivuri i një fëmije!
Vdekja mbi këta qivurë vendos e mençur si përherë,
Simbolin e një të çuditshmeje e robëruseje shije,

E kur unë mezi dalloj një fantazëm të ligështuar,
Që kalon përmes tabllosë së Parisit plot gjallëri,
Më ngjan gjithnji se ai trup i sëmurë e i dobësuar,
Ëmbëlsisht shkon në përkundjen e një djepi të ri;

Vetëm që, në labirintet e gjeometrisë duke mediuar,
Të mos pyes veten, tek shoh ato gjymtyrë plot ç'rregullsi,
Se sa herë zdrukthtari i shkretë ka për t'ia ndryshuar,
Formën asaj kutie ku trupi i saj do prehet në qetësi.

-Oh, po ato sy janë puse të mbrujtura nga miliona lot,
Shkurakë, ku edhe pse i ftohur, metali xixëllon me furfuri...
Janë sytë misteriozë të magjisë më ngadhnjyese në botë,
Të atyre që patën për nënë më mizoren Fatkeqësi!

4.

Vogëlushka plakushe, ju vazhdoni stoike e jo si mjerane,
Përmes kaosit të paanë të këtij qyteti duke jetuar,
Nëna zemërgjakosura, të shënjta apo kurtizane,
Me emrat tuaj që dikur kishin një timbër të shquar.

Oh, ju që ishit plot mirësi, oh, ju që ishit plot lavdi,
Askush s'ju njeh më!Një i dehur i prapë e endacak,
Duke ecur ju hedh shpotinë e nje qesharakeje dashuri,
Ndërsa para këmbëve ju përdridhet një djalosh burracak.

Prej vetes të turpëruara, si ato hijet e përhimshme,
Profilet e mureve duke ndjekur me t'kërusurën shpinë,
Askush s'ju përshëndet, o pjella të fateve të çuditshme!
Mbeturina të njerëzimit, po të gatshme për përjetësinë!

Ndërkaq, unë prej së largu ju përgjoj gjithë dhëmbshuri,
Sytë i fiksoj tek ato hapat tuaj të pasigurtë, hiç të qetë,
E njësoj sikur të isha babai juaj, oh e madhja mrekulli!
Shijoj thellë meje, një kënaqësi të butë e të fshehtë:

Shoh rishtazi aq shumë pasione brënda jush të lulëzuara;
Shoh ditët që keni humbur, të zymta a të lavdishme;
Gëzoj në zemër, gjithë veset tuaja të shumëfishuara!
Ndërsa gjithë vyrtytet, shpirtit më shndrisin të hijshme!

Ju gërmadha!Ju familja ime! O mëndje vetmitare!
Një lamtumirë solemne ju dhuroj çdo natë mes të ftohtit!
Po më thoni, ku vallë do të jeni nesër, o Eva 80-vjeçare,
Mbi të cilat përvëlon tmershëm gërvishtja e zotit!

Të verbërit

Kundroji o shpirti im; Janë vërtet të neveritshëm!
U ngjajnë manekinëve; tmerësisht qesharakë;
Me globet e tyre t'errësirës që i gjesdisin aq gjatë;
Ashtu të çuditshëm si somnambulët, e të frikshëm.

Ata sy, prej ku shkëndija hyjnore është mërguar,
E që sikur shohin diku larg, në qiell rrinë ngulur,
Kurrë s'i sheh drejt kalldrëmit duke ulur,
Shpesh ashtu mendueshëm, kokën e rënduar.

K'shtu ata përshkojnë errësirën e pafund, të pajetë,
K'të vëlla të heshtjes së tyre të përjetshme.M'shiko, o qytet!
Ti që kudo përreth këndon, qesh e bën shpoti,

Duke e shpënë kënaqësinë gjer në mizori,
Më t'ethshëm se ata, tek hyj dhe unë në vorbullën që ti ndjell,
Por duke thënë: Vallë k'ta të verbër, ç'kërkojnë në qiell?

Asaj që shkoi

Rruga oshëtinte përreth me një zhurmë të përdalë.
E hollë, e gjatë, në të zeza, o ç'dhimbje përrallore,
Një grua kaloi duke ngritur dorën madhështore,
E duke përdredhur të fundit të saj, çdo cep dhe palë.

Me këmbët si statujë, e shkathët dhe fisnike, e qetë.
E unë pija i eksituar, si një i çmëndur tamam,
N'sytë e saj, qiell i zymtë që parandjen një uragan,
Ëmbëlsinë që magjeps dhe kënaqësinë që vret.

Një vetëtimë...pastaj veç natë!-O bukuri që dot s'të zë,
Që me shikimin tënd befas jetës sime i dhe gjallëri,

Mos vallë do të të shoh prapë, veç në përjetësi?
Diku gjetkë, larg!Shumë vonë!Ndoshta *kurrë më*!
Se s'më duhet se ku shkon, as ty se ku shkoj unë,
O ti që e dije, o ty që do të të doja aq shumë!

Skelet fshatari

Në të vjetrat tryeza anatomike,
Gjatë brigjeve me pluhur të vëna,
Ku pigjet e librave me kufoma t'lëna,
Flenë si të ishin mumie antike,

Skicat vizatuar me zotësinë,
Dhe mençurinë e një artisti plak,
Edhe pse sfondi ish një trishtim i gjatë,
Kudo shpërhapnin bukurinë,

I qartësonin simbolet e fjetur,
Tmerret e mistershme ua plotësonin,
E njësoj si bujqit tokën me bel, gërmonin
Imazhe skeletesh e trupash të rrjepur.

2.

Në këtë tokë që ju punoni,
Fshatarë të përzimtë e të dorëzuar,
Kur vertebrat që keqas i keni munduar,
Bashkë me muskujt i shtrëngoni,

Tregonani ç'kallinj mblidhni,
Gropës së kufomave shkulur me vrer,
E të çuditshëm, thomëni, për ç'fermer,
Tërë hov hambarëve i hidhni?

Ndoshta (të një fati pa shpëtim,
Emblema të qarta, prej frikës të drobitura!)
Doni të tregoni se dhe në varret e rrëmitura,
Gjumi nuk është i sigurti premtim;

Që edhe Asgjëja në tradhti na ka kapur,
Që vetë Vdekja na gënjen tmerësisht,
E mos ndoshta, medet, o Zot, përjetësisht,
Do t'na bjerë fati për të zgrapur,

Në ndonjë cep të panjohur, përulur,
Pëqi të një toke të fortë, bujare aq pak,
E këmbëzbathur, plot pllanga tërë gjak,
Belin thellë kemi për ta ngulur?

Muzgu i mbrëmjes

Mikeshë e kriminelit, e magjishme mbrëmja zbret;
E si një bashkëfajtore besnike, çapin e ujkut ndjek;
Qielli mbyllet si perdet e atyre shtrateve mbretërore,
Që njeriun e paduruar e kthejnë në një bishë mizore.

O mbrëmje, e bukura mbrëmje, sa të dëshiron,
Ai, krahët e të cilit pa gënjyer mund të thonë:
"Sot kemi punuar!"- Se je ti që rehati brënda ndjell,
N'ato shpirtra që dhimbja e egër i ka grryer thellë,
E mënçura këmbëngulse, që ballet t'i përulin pak,
Punëtorët shpatullkërrusur tek plandosen në krevat.
Megjithatë, në atmosferë ca demonë shpirtlig,
Zgjohen rëndë-rëndë, si ata njërëzit pasanikë,
E përplasen kanateve e parvazeve duke fluturuar.
Përmes dritëzave të zbehta prej erës torturuar,
Prostitucioni nëpër errësirë ndizet me furi;
Si një fole milingonash ai çel shtigjet e tij;

E nga çdo anë, në një udhë pa krye i shpie,
Me taktikën e armikut që pas shpine të bie;
E kacavirret në gjinjtë e qytetit me baltë përlyer,
Si ai krimbi që Njeriut bukën nga goja i ka rëmbyer.
Dëgjohen fërshëllima kusish që veshët t'i cimbisin,
Bashkë me orkestra që gërhasin dhe teatro që kuisin;
Tryeza miqsh ku kënaqësia e të luajturit vdiret,
Nisin të mbledhin ortakët e tyre, batakçinjt e laviret,
Ndërsa hajdutët që kurrë s'kanë paqë e mëshirë,
Nga ethet e punës ndjejnë gjithë trupin të përpirë,
Që arka e porta të shqyejnë ëmbëlsisht, siç u vjen dore,
Për të hedhur ca vafte e për të veshur ca dashnore.

Përmblidhu, shpirti im, në k'të çast të rëndë, ti qëndro,
E gjithë këtë potere e vrumbullimë mos e dëgjo!
Është koha kur i sëmuri më shumë nga dhimbjet rënkon!
Nata me errësirën e vet e zë prej fyti dhe e shtrëngon,
Fatin e tij duke e rrëzuar në të zakonshmen humnerë;
Spitalet vazhdojnë të popullohen me psherëtima tërë vrer.
- T'paktën nji, s'do kthehet të kërkojë supën e parfumuar,
Në mbrëmje, pranë zjarrit e pranë një shpirti të dashuruar,
Prej gjithë atyre që kurrë se kanë njohur dhe jetuar,
Të një vatre familjare ngrohtësinë e ëmbëlsuar.

Loja

Kolltuqe të rrjepura, kurtizane ndër vajtime,
Me qerpikë të zbehtë, të ngjyruar, shikim fatal,
Nazemëdha, shpërfytyruar nga veshët thatime,
Që bëjnë të tringëllojnë çdo gurë e metal;

Fytyra pa buzë me tapete të gjelbër përreth,
Nofulla pa dhëmbë, buzë pa nuancë a pa ngjyrë,
Gishtërinj të gjatë, që një ethe skëterre i dredh,
Tek bredhin në një xhep bosh a ndër gjinj të fryrë;

Nën tavane të pistë, llampadar të zbehtë, një nga një,
E projektorë gjigandë që dritëzat i hedhin aq larg,
Mbi ballet e nxirë e hijerëndë të poetve nën zë,
Vijnë e shkapërdredhin djersët e tyre gjithë gjak.

Ja ç'imazhe të zi, një natë në ëndërr parreshtur,
Kam parë të shkasin para tejkqyrësve syve të mi,
Unë i strukur, në cepin e një shpelle të heshtur,
Mbi brryla mbështetur, i ftohë, memec e plot zili,

Mbushur plot zili për të njërëzve pasione mizore,
Për të lavireve të rregjura, të përzishmin gëzim,
Që faqe meje, trimërisht, kalonin dorë për dore,
Kush me nderin sublim e kush me bukurinë!

E zemrën ndjeva të lemerisej tek më pa gjithë cmirë,
Për ata varfanjakë që drejt gojëhapurës humnerë,
Galopojnë tërë zell e prej gjakut të tyrë të pirë,
Dhimbjen a vdekjen, hiçin a ferrin kërkojnë përherë!

Valle makabre*

Ernest Christophe

Krenare, si një njeri i gjallë, me atë fisnikun shtat,
Me një tufë lulesh në duar, me dorashka e shami,
Ajo ka xheste t'shkujdesura e mospërfillse aq gjatë,
Të një kokete kockë e lëkurë, me sjellje plot çudi.

A keni parë në ndonjë ballo trup më të hollë?
Veshja e gufuar si në madhështinë mbretërore,
-Mbi këmbën thatime, ngucur nga këpuca e hollë-
E bukur si një lule, bie në mënyrë hyjnore.

Qafa që i lodron, eshtrat e kraharorit tek çik pak,
Si lumi që guralecët lëpin, kënaqësi duke ndjerë,
Mbron e ndruajtur e plot turp, prej tallësve qesharak,
Dëshirat funebre, që ajo brenda vetes do të fsherë.

Sytë e thellë i ka mbrujtur me re të zeza e zbrazësi,
E kafka, me lule nëpër flokë stolisur mrekullisht,
Mbi vertebrat e brishta i lëkundet gjithë ligështi.
O magji verbuse e hiçit të krekosur çmendurisht!

Vërtet, disa mund të të quajnë edhe karikaturë,
Ata dashnorë të dehur prej mishit, që asgjë s'dinë,
Për delikatesën pa emër të njerëzores armaturë.
Sa për mua, skelet i pamasë, ti je i bukurisë shijim!

Po mos vallë të turbullosh me ngërdheshjen fuqirrallë,
Festën e Jetës, vjen ? Apo ndonjë dëshirë prej lashtësisë,
Akoma duke ta shpuar me mamuz atë karkasë të gjallë,
Po të shtyn, moj naive, drejt Sabatit të kënaqësisë?

Në këngë të ëmbla violinash a në flakë të nxehta qirish,
Shpreson t'i çlirohesh Makthit të përqeshjes, aq të gjatë,
E duke marrë ndihmë nga lumenj të rrëmbyer orgjish,
Do ta freskosh ferrin që në zemër të është ndezur flakë?

Pus i pashtershëm për budallallëqet dhe gabimet!
I dhimbjes së stërlashtë, i përjetshmi lambik!
Kurrë të ginjur, në gropëzën e hijeve të përvidhet,
Unë ta shoh gjarprin helmues tek brinjët ti stërpik.

Në të vërtetë, ojnat dhe nazet e tua, në çdo anë,
Kam frikë se askush nuk i çmon, se askush nuk i njeh;
Kush zemër njerëzore mund ta kuptojë shakanë?
Magjia e tmerrit, asnjë tjetër veç të fortit deh!

Në sytë si shpella, në mendime të tmershme dridhur,
Marramëndja nis e shpërthen, e balërinët hijerëndë,
Shikimin shqisin shpejt me një të vjellë të hidhur,
Nga buzëqeshja e përjetshme që të lëshojnë ata dhëmbë.

Po kush vallë, në krahët e tij një skelet s'ka shtrënguar,
E kurrë ndonjëherë s'është mikluar me funebrin ushqim?
Kush vlen, parfumi, perla e artë apo veshja e zbukuruar?
Kush bën të duket e bukur një mostër për përçmim!

O bajaderë** pa hundë, që askush dot s'të reziston,
Thuaju këtyre balerinëve, që bëjnë si të pështirosur:
"Kukullëza krenare, pudra e buzëkuqi dot s'ju mbron,
Pa qelbur erë vdekjeje! Skeletra të lyer e të pispillosur,

Antinois*** të zvenitur, spitullaqë fytyrë pa qime,
Kufoma të kallajisura, Lovelace**** tashmë magjitharë,
Kudo, ritmet e përbotshme të makabreve vallëzime,
Ju rrëmbejnë e ju çojnë në vënde të panjohura më parë.

Nga brigjet akull të Senës, në të Gangut ujra të nxehtë,
Grigja njerëzore hidhet e kërcen derisa plandoset pa fuqi,
Pa vënë re se borinë në një vrimë të tavanit ëngjëlli qet,
Ashtu të shqyer kobshëm, si tyta e një dyfeku të zi.

Në çdo klimë, nën çdo diell, Vdekja të admiron,
E për fyti të përdredh; Se qesharak, me gjithë mënd,
Njerëzimi shpeshherë ty të ngjan, kur mirrë profumon,
E kur ironinë e vet përzien me budallallëkun tënd!

Dashuria e gënjeshtrës

Kur me qejf të sodis tek shkon, o e dashura ime e plogët,
Nën tingujt e muzikës që pas tavanit thyhet e vërvitur,
Duke ndërprerë atë ritmin tënd harmonjoz e të dobët,
E mërzinë e shikimit të përqëndruar duke shëtitur;

E kur të kundroj, nën flakët e gazit që me ngjyra ta feksin,
Ballin e zbehtë mbështjellë nga një vel magjije të butë,
Ku dritëzat e mbrëmjes një aurorë t'mrekullushme ndezin,
E sytë, si sytë e qartë të një portreti të mahnisin aq urtë,

I them vetes: Është e bukur! Është e freskët përçudnisht!
Kujtesa e ngjeshur, kullë e lartë mbretërore tërë krenari,
E kurorëzon, se zemra si pjeshkë e rënduar ëmbëlsisht
I është pjekur, si vetë trupi i saj për të mënçurën dashuri.

Ç'farë je vallë, frut vjeshte, shije sovrane për aq gurmaze?
Apo një vazo funebre, që të mbushesh me pika loti pret,
Parfum i freskët që të bën të ëndërrosh të largtat oaze,
Shportë lulesh apo jastëk i butë që kokën ta preh qetë?

E di që ka sy aq të ndjeshëm, aq të ëmbël e melankolikë,
Që nuk fshehin asnjë prej sekreteve të tyre më të çmuar;
Apo peshtafë të shndritshëm pa hare, medaljone pa relikë,
Më të zbrazët, më të thellë se ju vetë, o Qiej të kulluar!

Po pse, nuk mjafton dot vetëm pamja jote e bukur,
Për të gëzuar një zemër që strehon veç Vërtetësinë?
Ç'rëndësi ka mospërfillja jote, marrëzia që t'rri strukur!
Maskë a dekor, përshëndetje! Unë adhuroj bukurinë.

Mjegulla dhe shira

Fundvjeshte, dimër, përshesh me llucë ti pranverë,
O stina plogështindjellëse! Ju dua e lavde ju thurr,
Se zemrën e mëndjen ma keni mbështjellë përherë,
Me një qefin të mjegulluar e nje ngjyrëturbull qivur.

Kjo fushë kaq e madhe ku era e ftohtë qesh e lodron,
Dhe erëtreguesin bën të kërcëllijë netve pa gjumë,
Kjo kohë, më mirë se pranvera e ngrohtë, plot aromë,
Shpirtit tim krahët prej korbi ia shtrin më shumë.

Si është m'e ëmbël zemrës prej gjërave funebre përpirë,
Asaj që prej nji kohe të gjatë bora ende si është shkrirë,
Asgjë, veç mugëtirës së përhershme t'errësirës mjerane.;

O stina krejt të shplara, që klimave tona u jeni sovrane!
-T'paktën një natë pa hënë, me të dashurën për dorë,
Mos na e fashisni dhimbjen në një shtrat rastësor.

Ëndërr pariziane

Constantin Guys

Ky i tmershëm e i rrallë pejsazh,
Që kurrë syri njerëzor se ka parë,
K'të mëngjes me të largtin imazh,
Seç po më bën një ëndërrimtar.

Gjumi më përmbytet në mrekulli!
Një impuls i një ëndrre kapriçioze,
Prej vegimeve të mia përgjithnji,
Degdis vegjetalen jo harmonjoze,

Unë, piktor krenar për gjeninë e tij,
Mes gjithë kësaj tablloje, pa bujë,
Shijoja atë deliranten monotoni,
Sajuar me hekur, mermer e me ujë.

Babel i tërë me shkallë e harqe,
Ish një pallat, madhështor aq shumë,
Mbushur plot shatërvanë e parqe,
Në rrethoren e arit opak a brun;

E rrinin pezull të rëndat katarakte,
Si ato tendat e mëdha të kristalit,
Duke lëshuar shpesh regëtima flake,
Mureve gjigandë të metalit.

Jo shelgje, pellgjet e fjetur hijëzonin,
Po kollona të shumta sa më s'ka,
E ndan tyre profilin e tyre kundronin,
Najada të stërmëdha, si t'ishin gra.

Rrëkezat blu të ujit gufoheshin,
Përmes brigjeve jeshil e trëndafilí
E ndër miliona rrugëza derdheshin,
Përtej, gjer në të universit kufi;

Kish kudo xhevahirë të paparë,
Valë magjike që gjithçka rrëmbenin,
Pasqyra të pamasa të lara në ar,
Vezulluese nga ato që shëmbëllenin!

Gangë të heshtur, kokën pa e çarë,
Nëpër gjithë firmamentin gjigand,
Të urnave të tyre të madhin thesar,
Hidhnin brënda shpellave me diamant.

Arkitekt i përrallës sime të bukur,
Unë, me vullnetin tim që rrezëllonte,
Bëja një oqean të tërë të zbutur,
Në një tunel xhevahirësh të kalonte;

Dalloja çdo gjë, edhe të zezën ngjyrë,
Të lëbyrtë, të qartë, ylberngjyruar,
Ujrat, lavdinë e tyre e kishin shtyrë,
Gjer në të diellit rreze të kristalizuar.

Nuk dukej asgjë, as diell e as hënë,
As diku nëpër qiell një yll i zbehtë,
Dritë këtyrë çudirave për tu dhënë,
Që shndrisnin veç prej zjarrit të vet!

Mbi tërë k'to mrekullira të lëvizshme,
Një qetësi e përjetshme, pa një zë,

Rrinte kërcënuese (Oh ç'risi e frikshme!
Të shohësh gjithçka, të mos kuptosh asgjë!)

Hapa sytë prej flakëve të përzhitur,
Duke parë tmerrin e strofkullës sime,
E ndjeva në shpirt thellë duke m'u futur,
Thumbi i të mallkuarave ngashërime;

Lavjerrësi i orës me tone të përzishme,
Ardhjen e mesditës lajmëronte brutalisht,
Duke shpërhapur qiellit re të mërzitshme,
Mbi botën e trishtë e të mpirë tërësisht.

Agu i mëngjesit

Boria ushtonte fort oborreve të kazermave,
Ndërsa era e mëngjesit shkiste butë fanarëve.

Ishte çasti kur luzma e një ëndërrimi kusar
Adoleshentët brunë i përdridhte si në një darë;
Kur, si një sy i dridhur që ngadalë pika gjaku qit,
Drita e llambës piklonte pulla të kuqe nëpër dritë;
Kur shpirti, nën peshën e trupit të vrazhdë e gërritës,

Imitonte zënkën mes dritës së llambës dhe të ditës.
Si asaj fytyre që fashat e lotëve puhiza ia fshin,
Ajri është plot rrënqethje gjërash që marrin arratinë,
E poeti aq i lodhur së shkruari, si gruaja së dashuruari.
Shtëpitë e strukura andej-këtej nisnin së tymuari.
Flinin femrat epshndjellse me qerpikët e zverdhura,
Gojëhapura, nëpër ëndrra budallaqe të derdhura;
Lypseve me gjokset e varrura, të mardhur e thatimë,
Era mbi krahë e gishtërinj u linte një fërgëllimë.
Ishte çasti i nderë kur mes mizeries dhe ftohtësisë,

Grave u rëndoheshin dhimbjet e shtatzanisë;
Si psherëtimë, mbytur prej gjakut të shkumëzuar,
Kënga e largët e gjelit napën e brymës kish copëtuar;
Një det i pamasë mjegulle ndërtesat lante e fshinte,
E prej një të dergjuri që në një cep strehe rrinte,
Dëgjoheshin pështpërima të zvargura e rënkime plot mëri.
Të dërmuar prej bredhjeve beqarët ktheheshin në shtëpi.

Aurora veshur me të gjelbër dhe rozë, gjithë mërdhi,
Vinte e shkiste mbi Senën pa jetë e tërë ngadalësi,
E si plak punëtor, dukë lëbyrur sytë në çdo skutë,
I zymti Paris mbi orenditë e veta dorën vinte butë.

VERA

Shpirti i verës

Një mbrëmje, shpirti i verës po këndonte për merak:
"Njeri, për ty i dashuri im, prej trashgimnisë përjashtuar,
Të burgut tim të qelqtë e prej llakut tim ngjyrëgjak;
Unë po ngre një dolli me dritën e ndjenjën e vëllazëruar!

E di si zhuritesh kodrave ku dielli veç zjarrmi ka lënë,
Si djersa të rrjedh çurk, ndër vuajtje e dhimbje aq gjatë,
Për të më sjell në jetë e një shpirt për të më dhënë;
Ndaj nuk dua të të jem mospërfillës dhe i ngratë.

Se unë ëmbëlsisht provoj një gëzim të paparë,
Kur shkas në fytin e një njeriu nga lodhja plandosur,
E gjoksi i tij i ngrohtë më është më i ëmbli varr,
Se sa qindra jetët e një kantine të kallkanosur.

A doni që këngët e të djelave të mbeten për njerëzinë,
Që shpresa në gjoksin tim të përpëlitur të cicërojë?
Aherë përvishni llërët, ngulni bërrylat mbi tavolinë,
Që lavde të më thurrni e shpirti juaj t'ju gëzojë;

Se sytë e të dashurave do t'ua ndez flakërimë,
Birit tënd do t'i jap fuqinë dhe ngjyrimin që e hijeshon,
E do të jem për atë të bukurin e jetës atlet thatim,
Vaji, që muskujt luftëtarit më të madh ia forcon.

Po, tek ty dua të vdes, ushqim vegjetal për perëndinë,
Grurë i çmuar hedhur prej Mbjellësit të përjetshëm,
Që me gjithë dashurinë tonë ne ta thurrim poezinë,
E ta çelim si një lule të rrallë për Zotin e përjetshëm!

Vera e leckashitësve *

Shpesh, anash fenerëve të rrugëve me të kuq ngjyrosur,
Në gjoksin e një rrethine plakë, labirint i llangosur,
Ku njerëzimi në thërmimin e vet të stuhishëm lëvron,
Mes erës që dritat ka çakërdisur dhe xhamat torturon,

Sheh një leckashitës tek ecën kokën duke tundur lehtë,
T'i merren këmbët, të përplaset pas murit si një poet,
E pa u merakosur nga spiunët, miqtë e tij të mirë,
Nëpër ëndrra të lavdishme zemrën ta ketë shtrirë.

Mizorët ka hedhur përdhe, ka formuluar betime,
Ka ringjallur viktima, ka diktuar kudo ligje sublime,
E nën një qiell të plumbtë e të nderë si një baldakin,
Gjithë vyrtytet e veta i ka dehur me shkëlqim.

Po, k'ta njerëz që hallet i kanë thyer si qelqurina,
Brinjëthyer zvarriten nëpër pirgjet me mbeturina,
- Vjelljet konfuze të këtij Parisi të paanë -
E prej punës së bluar, nga mosha të bërë mjeranë;

Enden n'parfumet e kazanëve të plehrave, trupmardhur,
Ndjekur nga shokët prej shumë betejave flokzbardhur,
Me ato mustaqet e valëvitura si flamuj ngjyrëdalë.
Nga çdo anë gonfalonët, lulet dhe harqet triumfalë,

Drejtohen me respekt para tyre, në solemnen magji!
E përmes flakëronjëses dhe shurdhonjëses orgji,
Të burive, diejve, sokëllimës së tamburëve të zisë,
Lavdinë i thurrin k'tij populli të dehur prej dashurisë!

Njësoj, mes k'tij Qytetërimi të egër, shpirttharë,
Paktokël** përshkënditës, vera bën të rjedh ar;
Në fytet e njërëzve bëmat e veta duke kënduar,

Si mbret i vërtetë që me dhurrata rri duke mbretëruar.
Që të përkund plogështinë e të mbysë çdo rënkim,
Për të gjithë pleqtë e mallkuar që vdesin në harrim,
Zoti gjumin krijoi, në ndërgjegjie i prerë e i grirë;
Ndërsa Njeriu i shtoi verën, të Diellit të shenjtin bir!

Vera e vrasësit

Gruaja më vdiq, tani jam i lirë!
Aherë do pi e do bëhem kërçep.
Se kur vija pa një grosh në xhep,
Klithmat e saj trupin ma bënin firë.

Ajri është i pastër, qielli plot magji;
Jam si mbret i lumtur shënd e verë...
Qielli po kaq i bukur qe dhe atëherë,
Kur unë me të rashë në dashuri!

Etjes-tmerr që më ka bërë një dorë,
Për t'ju shuar do t'ia kishte ënda,
Të pinte gjithë atë verë që brenda,
Mund të nxërë varri i saj madhështor:

Në fund të një pusi të thellë e hodha,
E ca gurë të bardhë sipër i kam lënë,
Të njëjtit gur q'anës varrit i kisha vënë.
Dua ta harroj! Oh, po e ndjej se u lodha!

E në emër të një betimi të njomë,
Që askush në botë s'mund ta shprish,
Për ta kthyer historinë ashtu siç ish,
Në kohën e të zjarrtit pasionit tonë,

Ju luta një natë të më vinte në takim,
Në cepin e errësirës më të dendur,

E ajo erdhi! - Oh ç'krijesë e çmendur!
Po ne njësoj si ajo, jemi një çmëndim!
Ishte akoma një grua e bukur, vërtet,
Edhe pse aq e lodhur!Për hesap tim
Unë e doja shumë! E për k'të qëllim
i thashë: Lëre më mirë këtë jetë!

Askush s'më kupton.Vallë vetëm nji,
Prej gjithë këtyre pijanecëve idiotë,
A ka menduar ndonjëherë ashtu kot,
Të bëjë prej verës një qefin të zi?

Gjithë këta zdërhallë shpirtpajetë,
Sikur t'ishin një makinë e hekurt,
Verës së nxehtë a dimrit të mjegullt,
Kurrë s'e njohën dashurinë e vërtetë!

As magjinë e hidhur në lëngim,
Kortezhin e zi të ditve të shqetsuara,
Të lotëve lumenj e netve të helmuara,
Të zinxhirëve e të eshtrave në thërmim!

Më në fund jam i vetëm e i lirë!
Kështu që verën do ta pi me ibrik;
E pa asnjë sëmbim, pa asnjë frikë,
Përdhe do mundem të rri shtirë,

E do të fle, po njësoj si një qen,
Që qerrja me rrotat e saj të rrënda,
Mbushur me gurë e baltë brënda,
Apo treni që shkallmon gjithçka gjen,

Kokën time fajtore të ma copëtojë,
A t'ma çajë në dysh trupin që rënkon,
Se mua as për Zotin s'më bëhet vonë;
Për sofrën e shenjt' a djallin s'kam nevoj'!

Vera e vetmitarit

As shikimi i çuditshëm i një gruaje provokuse,
Që shket kundrejt nesh si rezja e bardhë verbuese
E hënës endacake që ujin e liqenit bën të dridhet,
Kur bukurinë e saj mospërfillëse lë të kridhet;

As në gishtërinjtë e lojtarit të hollat në mbarim;
As në faqen e thatimes Adelin një puthje plot guxim;
As muzika që të bën të trishtë a të përkëdhel lehtë,
E që klithmës së largët të dhimbjes njerëzore i ngjet,

Jo, asgjë nuk mund të krahasohet, o shishe e thellë!
Me ata balsamët e butë që gjithnjë barku yt pjellor,
Ruan për zemrën e shprishur të një poeti të gjorë;
Duke i dhurruar jetën, shpresën, rininë duke i sjell,
-E për më shumë krenarinë, të çdo varfanjaku thesar,
Që na bën njësoj me Zotat, të fortë e ngadhnjimtarë!

Vera e dashnorëve

Sot hapësira është kaq e gjerë!
Pa ngojëza, pa mamuz e pa frerë
Mbi kuajt e verës le të kalërojmë,
E drejt një qielli hyjnor le të shkojmë!

Si dy ëngjëj që si dy viktima janë,
Të një dalldisje t'ethshme, të paanë,
Në blunë e një mëngjesi kristalin,
Pas të largtit vegim le t'marrim arratin!

Të tundur në flatrat e buta plot ëmbëlsi,
Të një vorbulle inteligjente e të marrë,
Të kredhur në detin e një deliri të paparë,

Motra ime, dallgve duke notuar përbri,
Le t'ikim, pa u dorëzuar në pushim,
Në parajsën e ëndrrave të mia si strehim.

LULET E SË KEQES

Shkatërimi

I palodhur për anjë çast, Demoni turfullon krah meje;
Më vjen vërdallë si të ish një puhizë e pandjeshme,
Unë e kapërdij, ai gjakun ndjej të ma djeg nëpër deje,
E mushkëritë me dëshirën e fajshme, të përjetshme.

Herë-herë, tek ma njeh dashurinë e madhe për Artin,
Përvijohet në format e gruas më të bukur e joshëse,
E, me lloj-lloj sajesash hipokrite ma ndjek Fatin,
Duke i mësuar buzët e mia me puthje turpëronjëse.

Më udhëheq kështu, larg prej atij shikimi hyjnor,
E duke dihatur nga lodhja raskapitëse, dergjur më lë,
Fushave të Mërzisë pa fund, pa një hije, pa një zë,

Pastaj vërvit thellë syve të mi të zjarrtë e pështjellor,
Tesha të fëlliqura, plagë të hapura mes lëngimit,
E gjithë atë aparatin e përgjakshëm të Shkatërimit!

Femra të dënuara

Ato, si ajo grigja që shtrirë mbi rërë rri menduar,
U hedhin horizonteve të deteve shikime të dridhura,
Këmbët duke dashur t'i prekin, duart duke i afruar,
Mes ligështimave t'ëmbla e rënqethjeve të hidhura;

Ca prej tyre, zemra që kanë pritur aq gjatë një miqësi,
Belbëzojnë thellë gjethnajave ku përrenjtë gurgullojnë,
Rrokje për rrokje, dashurinë e së ndruajturës fëmijëri,

E gjethëza të reja pyjeve të gjelbër nisin e u bulojnë;
Ca të tjera, si murgesha ecin rrugës, gati duke u zvarritur,
Mes për mes shkëmbenjve mbushur plot me vegime,
Aty ku San Antonio pa si një llavë të zjarrtë vërvitur,
Gjokset lakuriq e të purpurt të të tijave tundime;

Ka nga ato, që nëpër refkleksin e rrëshirës rrëshqitëse,
Brënda boshllëkut të heshtur të pasqyrave t'vjetra pagane,
Të thërrasin për t'i ndihmuar në ethet e tyrë flakëritëse,
Ty o Baccho, që fashit sëmbimet më antike e mjerane!

Ka dhe të tjera, që gjoksi i beqarëve u sjell aq kënaqësi,
Që duke fshehur një kamzhik në palat e fundeve të gjatë,
Përziejnë në një cep pylli të zymtë a netëve plot vetmi,
Shkumën e butë të qejfit me lotët e dhimbjes së pamatë;

O virgjëresha, o djallushka, o mostra, o martirake,
O shpirtra të mëdhenj që realiteti u jep përçmimin e zi,
Kërkoni të pafundmen, herë të devotshme, herë dioniziake,
Herë në ulërima tharë, herë në dënesa të zëna në pusi!

Ju që në ferrin tuaj shpirtin ma keni shpënë e keni shqyer,
Ju dua e mëshiroj, o motërzat e mia të shkreta në k'të botë,
Për atë ngrysje të vuajtjes, për at' etje kurrë të shpërblyer,
Për ata lumenj dashurie që zëmrat e mëdha ua mbushin plot!

Dy motërza të mira*

Dy vashëza të hijshme janë Vdekja e Shthurrja e mallkuar,
Plot shëndet e plot puthje që mrekullinë ndjellin,
Me ato barqet e tyre gjithnjë të virgjër, në zhele mbuluar,
Që prej lashtësisë, pa mundur dot të pjellin.

Poetëve t'mbrapshtë, atyre që vatrën familjare mohojnë,
Dallkaukëve të ndyrë, miqve të ferrit gjithë zjarr,
Nën pjergullat e tyre prej varresh e kuplarash u zbulojnë,

Një krevat që sëmbimi askurrë se ka parë.
K'shtu Shtrati dhe Qivuri, ndehur në blasfemi pjellore,
Na shpërhapin njëri pas tjetrit, si dy motërza të mira,
Aq kënaqësi të tmershme dhe ëmbëlsi mizore.

Po kur vallë ti o Shthurrje, me ato krahët e pështira,
Do më groposësh? Dhe ti o Vdekje, rivalja tërë magji,
Kur do ti shartosh mërsinat e shpifura me qiparizët e zi?

Shatërvani i gjakut*

Ndonjëherë më ngjan se gjaku më rjedh në shkulmim;
E ndjej qartë tek kullon me një të gjatë murmurimë,
Si një shatërvan me ritmin e ethshëm të ngashërimit,
Që unë më kot mundohem ta fashis mes gurgullimit.

Ai shpërthen nëpër qytet, si në një fushë të rrethuar,
Duke i shuar etjen çdonjërit prej njërëzve të takuar,
Duke kthyer çdo cop kalldrëm në një të lartë trotuar,
E çdo cep të natyrës me ngjyrë të kuqe duke e larë.

Iu luta aq shpesh atyre verrërave më të rezikshme,
Që ti bëjnë veshët më të ndjeshëm e shikimet më të hijshme;
Që qoftë edhe për një çast t'ma dremisnin tmerrin plot hidhërime!

E në dashuri kërkova gjumin e harrimit në vetmi;
Po veç një dyshek gjilpërash paska qënë kjo dashuria ime,
Sajuar që këtyre femrave mizore t'ju japë të pi!

Alegori

Është një grua e bukur, fytyrëkrenare përherë,
Që krifën e flokëve lë të kridhet në verë.
Helmin e bollës, thonjtë e mprehtë të dashurisë,

Graniti i lëkurës së saj i zpraps lehtë e i rrokullis.
Ajo Vdekjen përqesh dhe Vesin përçmon,
Edhe mostra më mizore, që gjithçka korr e rrafshon,
Në lojën e vet të shkatërimit, dorën s'ia ka hedhur,
Në respekt të madhështisë së vrazhdë të trupit të derdhur.
Ajo ecën si një Hyjneshë e shplodhet si një Sulltan;
E shfaq për kënaqësinë një besim myslyman.
Për ta shtrënguar në krahë, mes gjinjve të plotë e të nxehtë,
Me sytë e saj kurreshtarë ajo racën njerëzore thërret,
Se beson dhe se e di mirë kjo virgjëreshë shterp,
Megjithatë e nevojshme për vazhdimsinë në k'të jetë,
Se bukuria e trupit është dhuratë sublime gjithmonë,
Që për çfarëdolloj turpi, përsëri faljen fiton.
Ajo nuk njeh e shpërfill po njësoj, Purgator dhe Ferr,
E kur të vijë çasti e të hyjë në natën e zezë sterr,
Sytë në ballë të Vdekjes do t'i mbajë me ngulmim,
Si një fëmijë i porsalindur, - pa urrejtje, pa sëmbim.

Beatriçeja

Mbi një truall të shkrumbuar, mbi një truall vullkanik,
Pa një fije bari, kur me natyrën po grindesha një ditë,
E kur mendimet e mia, që kudo binin fjollë-fjollë,
Ngadalë brënda zemrës, kamat e tyre mprihnin hollë,
Pashë në mes të ditës, kokë e këmbë t'më mbështjellë,
Një re funebre dhe gjigande, që stuhinë parandjell,
Të ngjeshur fort prej një mizërie demonësh vesves,
Të ngjashëm me ca shkurtabiq kureshtarë e të pabesë.
Ata shpejt e shpejt nisën t'më vështronin tërë ftohtësi,
E, si ai i çmënduri që i çudit kalimtarët përballë tij,
Unë dëgjova tek gajaseshin e çuçurisnin plot humor,
I shkelnin sytë njëri tjetrit e shkëmbenin shënja me dorë:

"Ja pra dhe një karikaturë për t'u kundruar me gëzim,
Me atë pozë që të duket si i një Hamleti imitim,

Shikimin mbushur me dyshime, flokët rrëmbyer në erë.
Pse, s'është e dhembshur ta shohësh k'të filozof të mjerë,
K'të aktor të keq me pushime, qerrata, lypës zemërmirë,
Që vetëm për të luajtur rolin e vet me dëshirë,
Për këngën e dhimbjeve të tij iso kërkon,
Prej shqiponjës, bulkthit, lules e rrëkesë që gurgullon;
Madje dhe prej nesh, sajuesve të k'saj të lashte rubrikë,
Do që të ulërasim fytçjerrë qortimin e vet publik?"

Po krenaria ime e lartë sa një mal, e fortë sa një hyjni,
Mund ta dëbonte renë, ngërdheshjen e djajve ta bënte hi,
E kokën time sovrane, diku gjetkë, kisha për ta shpënë,
Sikur në mes të skenës së turbullt, sytë mos më kishin zënë,
Mbretëreshën e zemrës, me një shikim të pashpjegueshëm dot,
(Oh krim, që dritën e diellit s'e shove nga kjo botë!)
Ajo mes djajve, me ngashërimin tim të zymtë lodronte,
E sa njërit tjetrit, përkëdhelje të ndyra i dhurronte.

Një udhëtim për në Siterë*

Zemra ime hidhej përpjetë, si një zog i gëzuar,
E fluturonte lirisht mbi ballamar e mbi direkë;
Anija nën një qiell të hapur shkiste e qetë,
Si një ëngjëll i dehur prej një dielli të flakëruar.

Po si quhet vallë ai ishull i zi, i trishtë e pa jetë?
- Sitera, thonë, toka aq e dashur e këngëtarëve,
Eldoradoja banale e gjithë dashnorëve e beqarëve.
Shikojeni, pas gjithë asaj lavdie, veç një tok e shkretë.

-Ishull sekretesh t'ëmbla e festash zemre gjer n'agim!
Fantazma superbe e së lashtës e hyjnores Afërditë,
Shpërhapet si aromë në detrat rreth teje, ditë për ditë,
Duke ta përmbytur shpirtin në dashuri dhe lëngim.

E nderuara e bukur e gjithë popujve botës anembanë,
Ishull mërsinash të gjelbra e lulesh të çelura pak,
Ku psherëtimat e zemrave që dashurojnë aq gjatë,
Bridhnin si mbi kopshte trëndafilash i ëmbli temjan,

Apo si ajo e pëllumbit gugatje e pambarueshme!
-Sitera tashmë i ngjante trollit të vrerosur e djerrin,
Një shkretëtire gurësh rrahur nga një e egër ulërimë.
E megjithatë, diku përvijohej diçka e pakuptueshme!

S'ish një tempull i hijëzuar nga një korije pishash,
Ku një priftëreshë e re e dashuruar pas luleve,
Ecte me trupin djegur e përvëluar prej sekreteve,
Tunikën duke valëvitur nën një fllad puhizash;

Nderkaq, duke çikur rafsh me bregun me shpejtësi,
Zogjtë duke shqetësuar, velat e bardha duke tundur,
Pamë ç'ish: Një trekëmbësh me krahë të lëkundur.
Që si një qipariz lartohej përballë qiellit, i zi.

Ca zogj mizorë, të kërcyer mbi gjahun ushqimpak,
Bënin fërtele me tërbim, të varurin tashmë skelet,
Duke ngulur si një vegël grryese të pistin sqep të vet,
Mbi atë kalbësirë që nga të gjitha anët kullonte gjak;

Sytë i kish si vrima, barkut të shqyer i kishin rrëshqitur
ashtu rëndë-rëndë mbi kofshë, të gjorat rropulli,
Ata xhelatë të ndyrë, nginjur me dëfrime tërë neveri,
E kishin kastruar krejt të mjerin, me sqep duke e çumitur.

Një kope katërkëmbëshish xhelozë nën këmbët e tij,
Me turririn lart, sa andej-këtej, endej e rrotullohej;
E bisha më e madhe brënda grupit niste të turfullohej,
Si të ish një ekzekutor me ndihmësit e vet përbri.

Banor i Siterës, bir i një qielli të bukur e të larë!
Ti vuaje në heshtje prej këtyre fyerje e sharjeve,
Dënimin e dhimbshëm të riteve të pista e mëkateve,
Që s'të lanë dot të zbrisje e të preheshe, as në varr.

I varur qesharak, dhimbjet e tua janë t'miat në çdo pore!
E ndjej, tek shoh në ajër ato të shpërdredhurat këmbë,
Si gromësimë të vjelluri, të më ngjitet nëpër dhëmbë,
Të gjatin lumë të vrerit të dhimbjes shekullore;

Ja pra, këtu para teje, djalli i shkretë, i ëmbli kujtim,
Unë dëgjova çukitjet dhe skërmitjet e nofullave,
Të korbave të zinj zëçjerrë e të gjithë panterave,
Që dikur zbaviteshin duke përtypur mishin tim.

-Qielli ish një magji e plotë, deti një sirenë e paanë;
Po për mua gjithçka ish gjak i kulluar në një sfondi të zi,
Që ma bënte shpirtin, të tërin të varrosur në këtë alegori,
E medet! Mbështjellë nën një të rëndë e të ashpër savan.

Në ishullin tënd Afërditë!E bukura gjer në përgjërim,
Gjeta veç një trekëmbësh simbolik ku varej imazhi im ...
-Ah! Zot! Të lutem, dhuromë forcë dhe guxim,
Për ta parë trupin dhe shpirtin tim, pa përçmim!

Dashuria dhe kafka

Dashuria mbi kafkën e Njerëzimit
ka rënë ndesh:
Profani mbi k'të fron mes gëzimit,
I pafytyrë, qesh.

Flluska t'rrumbullakta hareshëm nis të fryjë,
Dhe ajrit t'ia ngjit,

Si të dojë drejt botëve të largta t'i shtyjë,
Gjer thellë n'zenit.

Ky glob i hijshëm, delikat dhe tërë dritë,
Me një vrull të zjarrtë,
Shpërthen e shpirtin e tij të brishtë e qit,
Si një ëndërr të artë.

S'rresht e s'lodhet kafka t'i lutet aq gjatë,
E çdo flluske t'i rënkojë:
"Vallë i gjithë ky trill mizor dhe qesharak,
Kur do të mbarojë?"

Se gjithçka shpërhap ajo gojë në tërbim,
Dhe ajrin përflak,
Mostër vrasëse, është vetë ky truri im,
Ky mish dhe ky gjak!"

REVOLTË

Rimohimi i Shën Pjetrit

Po ç'bën vallë Zoti me këto mallkime gjithë vrer,
Që ngjiten për ditë drejt të dashurve Serafinë?
Në një zhurmë t'ëmbël, zërat që ngjizin blasfeminë,
Ai i zbut, si një tiran i nginjur me mish e me verë,

Janë si një simfoni marramendëse, pa dyshim,
Ulërimat e gjithë martirëve që derdhen lumë,
Po edhe pse dëshira e tyre kushton aq shumë,
Qiejt në gjak, akoma kërkojnë shpagim.

-Ah!Krisht, a e mban mënd Kopshtin e Ullinjve!
Kur luteshe në gjunjë, me atë thjeshtësi të rrallë,
Me gozhdat që zhelati kish ngulur në mish të gjallë,
Për atë që qeshte me dhimbjet e gishtërinjve,

Po atëherë kur shihje hyjninë tënde të blatohej,
Me pështymën e rojeve e të pjatalarësve përçmim,
E kokën tënde, ku tërë Njerëzimi gjente strehim;
Ndjeje nga gjëmbat e mprehtë thellë të shpohej,

Po kur trupi nën peshën e rëndë thyhej tmershëm,
E i zgjaste akoma më shumë krahët fort shtrënguar,
Po kur nga sytë e çdo njeriu t'i ndiheshe i shënjuar,
E gjak e djersë prej ballit të kullonte rrjedhshëm,

Po kur erdhe të provoje atë që përjetsisht ish premtuar
S'ëndërrove vallë ditët e bukura në një qiell të ndritur,
Aherë kur mbi shpinë të një gomarice të hijshme hipur,
Shkele mes rrugëve me lule e degë të blerta shtruar,

Ose, kur fshikullove gjithë afsh tregëtarët burracak,
Me zemrën e gufuar fort nga shpresa dhe guximi,
Ose, akoma më shumë mjeshtër i madh, Sëmbimi,
Nuk të shpoi në kraharor, si shtiza më e gjatë?

- Veprimi s'mund të jetë kurrë motra e një ëndrre të dlirë,
Po sa për mua, nga kjo jetë do të largohem pa lotë;
Shpatën mund ta përdor e prej saj le të vdes në k'të botë!
Shën Pjetri e rimohoi Krishtin... Dhe bëri mirë!

Abeli dhe Kaini

1.

Racë e Abelit, ha, pi dhe fli;
Zoti të buzëqesh kënaqësisht.

Racë e Kainit, me llucën në gji,
Përpëlitu e vdis varfërisht.

Racë e Abelit, i yti sakrifikim,
Hundën e Serafinit ledhaton!

Racë e Kainit, i yti mundim,
Thuamë, kur po mbaron?

Racë e Abelit, mbill, korr e shi,
E bagëtinë shto për merak;

Racë e Kainit, rropullitë i oshëti
Prej urisë, si një qen plak.

Racë e Abelit, ti barkun ngroje
Ndan vatrës patriarkale, me orë;

Racë e Kainit, trupin dridhëroje,
N'shpellën kallkan, si çakall i gjorë!

Racë e Abelit, dashuro e riprodho!
Se ti madje dhe arin shumëfishon.

Racë e Kainit, në zemër moho,
Oreksin e madh që të sëmbon.

Racë e Abelit, shartohesh e rritesh,
Si tartabiqet nëpër pyje!

Racë e Kainit, me familjen zvarritesh,
Pa shpëtim, netve pa yje.

2.

Ah, racë e Abelit, pisllëku yt i ndyrë,
Do ta tejngop tokën e tymuar!

Racë e Kainit, e jotja detyrë,
Tërësisht ende s'ka mbaruar;

Racë e Abelit, ja turpi yt në k'të botë:
Shpata është mundur prej hellit!

Racë e Kainit, Zotin për t'hedhur në tokë,
Ngjitu sa më parë drejt qiellit.

Lituanitë e Satanait

O ti, mes ëngjëjve më i mënçur e më i zbukuruar,
Zot prej lavdisë humbur dhe nga fati yt tradhëtuar,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

O Princ i lartë i mërgimit, që të goditën pa të drejtë,
Po ti fitimtar, përditë m'i fortë u ngrite në k'të jetë,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që di gjithçka , mbret i madh i botës skëterrore,
Shëronjësi i familjes për gjithë dhimbjen njerëzore,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që, dhe lebrozve, dhe të përbuzurve më të mallkuar,
Me dashuri, shijen e përkëdheljeve të parajsës u ke mësuar,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

O ti që prej Vdekjes, dashnores tënde të lashtë e të hijshme,
Ngjize Shpresën, - këtë të çmëndur të magjishme!

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që, syrgjynit një shikim krenar e të qetë i ke dhënë,
E një popull të tërë në podium t'ekzekutimit ke shtënë,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që di se nëpër ç'cepa trollesh ziliqarë,
Zoti xheloz fshehu gurë të çmuar a margaritarë,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që symprehtë, arsenalet më të thella i njeh,
Aty ku populli i madh i metaleve i varrosur fle,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!
Ti që me pëllëmbët e mëdha greminën ia fsheh,
Somnambulit që bredh andej-këtej, majë ndertesave,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që, mrekullisht, eshtrën ia mban të pathërmuar,
Një endacaku plak e të pirë, nga kuajt të rropulluar,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që, për të ngushëlluar një njeri të brishtë e të mjerë,
I ke mësuar salnitrin me squfurin të përzierë,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që vë damkën tënde, o bashkëfajtori hollak,
Mbi ballë të Krezusit, të pamëshirshëm e burracak,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Ti që syve dhe zemrave të vashëzave u ke lëshuar,
Dashurinë e rreckave dhe kultin e plagës së kulluar,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

O llampë e shpikësve, o bastun i të mërguarve,
O rrëfyes i madh i të varrurve e të përbetuarve,


O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Baba i adoptuar, i atyre që nga tërbimi i zi qorruar,
Babai Zot, prej parajsës tokësore i ka shqelmuar,

O Satana, bëj mëshirë për vojtjen time të gjatë!

Lutje

Lutje e lëvdata, Satana, në të lartin Qiell
Ku mbretëroje, apo prej Ferrit thellë,
Ku ngadhnjimtar ti ëndërron në qetësi!
Bëj që një ditë, n'shpirtin tim pranë teje të fle,
Nën Pemën e Shkencës, kur të lëshojnë gjethe
degët mbi ballin tënd, mbi këtëTempull të ri!



3rj0n1xx -Mundësoi Librin-

VDEKJA

Vdekja e të dashuruarve

Do kemi shtretër të parfumuar, të lehtë fare,
Divanë të zhytur poshtë si varre të thellë,
E lule të çuditshme të vëna nëpër sirtare,
Çelur për ne, nën më të bukurin qiell.

Me të fundmen ngrohtësi tek marrin e lëshojnë,
Zemrat do ti kemi dy pishtarë të pamatë flake,
Që vezullimet e tyre të dyfishuara shëmbëllojnë,
Në shpirtrat tanë, në këto pasqyra binjake.

Një mbrëmje në rozën e blunë mistike përpirë,
Prej syve do shkëmbejmë një të vetme vetëtimë,
Si një psherëtitje të gjatë, të rëndë si lamtumirë;

Më pas një Ëngjëll, portat do hapë me fërgëllimë,
E do t'i japë shpirt dhe jetë, besnik dhe i gëzuar,
Pasqyrës mjegullveshur e flakve të zjarrit të shuar!

Vdekja e të varfërve

Është Vdekja që na ngushëllon, që na bën të jetojmë;
O Zot! Është qëllimi i jetës, është e vetmja shpresë,
Që na jep kurajon deri në mbrëmje, rrugëve të marshojmë,
Që si një eliksir, trupat na i deh e zemrat na i ndez;

Mes stuhisë, brymës, dëborës, na mban të ngrohur,
Është ylli që dridhëron mes horizontit tonë të zi,
Është bujtina e famshme, prej të gjithëve e njohur,
Ku çdokush mund të flerë, të ushqehet e të rri;